

3 MAJITA.

Mendimi Politik / Profile Biografike



EMAJTA.

Mendimi Politik / Profile Biografike

Botues

-Friedrich-Ebert-Stiftung

Zyra e Tiranës

Rr. "Kajo Karafili" Nd-14, Hyrja 2, Kati 1, Kutia Postare 1418, Tiranë, Shqipëri

- Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

Rruga "Ibrahim Rugova", nr. 11, Tiranë, Shqipëri

Tekstet

Fatmira Nikolli

Mbi studimet e:

Prof. Dr. Ana Lalaj

Dr. Dorian Koçi

Dr. Edon Qesari

Prof. Dr. Hamit Kaba

Dr. Ilir Kalemaj

Prof. Asoc. Dr. Sonila Boçi

Ndihmuan në përgatitjen e këtij botimi

Ardita Repishti - Drejtoreshë e Mbështetjes Shkencore dhe Edukimit Qytetar, AIDSSH

Jonida Smaja - Koordinatore Programi, Friedrich-Ebert-Stiftung

Falënderojmë për kontributin:

Ornela Arapi, Ardiana Topi, Anton Dukagjini, Irma Bataj, Oralda Muço, Elizabeta Gripshi, Migena Demirxhiu, Leonard Dervishi nga AIDSSH;

- Familjarët dhe të afërmit e personaliteteve të trajtuara, që ndihmuan këtë projekt:

Arjeta Kokalari, Bibika Kokalari, Linda Kokalari, Shpëtim Qesja, Shyhrete Keçi, Arlinda Ymeraj (Keçi), Dalan Luzaj, Redon Veliu, dhe të gjithë ata që e mbështetën.

Design

Henrik Lezi

Shtëpia Botuese

Gent Grafik

© Fondacioni Friedrich Ebert dhe Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

Kërkimet shkencore dhe analizat e ndërmarra për këtë botim janë të autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të Fondacionit Friedrich Ebert. Publikimet e Fondacionit Friedrich Ebert nuk mund të përdoren për arsye komerciale pa miratim me shkrim.

Përmbajtje

6P

Parathënie

13H

Hyrje

18



Sejfulla Malëshova

40



Musine Kokalari

34



Tajar Zavalani

26



Konstandin Çekrezi

48



Isuf Luzaj

54



Skënder Luarasi

62



Petro Marko

82



Xhavid Qesja

76



Isuf Keçi

70



Zef Mala

Parathënie



**Gentiana
Sula**

Mendimi politik i së majtës shqiptare

E majta shqiptare jomonolite, me dinamikat e zhvillimit të saj në rrafshin kombëtar dhe europian, me zgjedhjet dhe vendimet për marrjen e mbajtjen e pushtetit në përfundim dhe pas Luftës së Dytë Botërore, ka qenë prej kohësh sfidë për t'u trajtuar.

Gjysmëshekulli komunist që e fshiu mendimin ndryshe, që e retushoi të shkuarën dhe emrat e përveçëm që patën ndikim në vend, u kujdes të vetëparaqitej me dorë të fortë, si e majtë e unifikuar që në fillime, e gjithëpranuar nga populli, e cila e mbajti pushtetin për popullin.

Gjendja e Shqipërisë në fillimvitet '90, e bunkerizuar anekënd, e izoluar nga e gjithë bota, e varfër deri në asht, e kolektivizuar, shpronësuar, me burgjet plot të dënuar politikë, me kampe internimi dhe vende të punës së detyruar nga veriu në jug e po ashtu, emigrimi masiv i mijëra shqiptarëve që e kërkuan jashtë vendit të ardhmen e tyre, tregon qartë se e majta komuniste shqiptare nuk e kishte kaq të gjerë bazën e trumbetuar.

“Ti e sheh se tek ne fshihet e vërteta”, i thoshte Xhavid Qesja personit që e përndiqte. “... Edhe ty ka plot gjëra që nuk të duken të drejta, por ti nuk flet... Njeriu duhet të flasë, të jetë principlial, të ketë guxim”.

Sejfulla Malëshova, Konstandin Çekrezi, Tajar Zavalani, Musine Kokalari, Isuf Keçi, Skënder Luarasi, Xhavit Qesja, Isuf Luzaj, Petro Marko, Zef Mala e të tjerë janë personalitete që u frymëzuan nga aspiratat për drejtësi shoqërore dhe punuan për ta ngritur e formësuar të majtën në vend.

Mbarimi i Luftës së Dytë Botërore dhe kalimi i pushtetit në duart e Partisë Komuniste ishte vendimtar për fatin e tyre e shumë të tjerëve, që u përndoqën, dënuan, ekzekutuan dhe anatemuan me breza. Kjo opozitë brenda së majtës, thujse e panjohur për shoqërinë e sotme shqiptare, të mbingarkuar nga narrativa e së shkuarës, frymëzoi këtë projekt, hapi i parë i studimit të së majtës në Shqipëri, përtej veprimtarisë së PKS/PPSH.

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Fondacioni Friedrich Ebert në Tiranë u bënë bashkë në një projekt serioz dhe sfidues që ndriçon këtë aspekt të historisë sonë të afërt, të lënë në hije për një pjesë të madhe të shoqërisë shqiptare. Dhjetë intelektualë të mirënjohur, filozofë, gazetarë, mendimtarë e përkthyes, shkrimtarë e njohës shumë të mirë të dinamikave në vend e jashtë tij u morën në studim nga një ekip i nivelit të lartë akademik.

4475 faqe dokumente u deklasifikuan nga AIDSSH dhe u vunë në dispozicion të gjashtë studiuesve që iu qasën në mënyrë shumëdisiplinare profileve të përzgjedhura, duke riskuar në të njëjtën kohë tablonë e mendimit politik të së majtës në Shqipëri, në kuadër të mendimit politik botëror të së majtës përgjatë shekullit XX.

Emrat e shqyrtuar në këtë vëllim të parë dhe profilet që i ofrohen lexuesit janë një përpyetje për të sjellë idetë dhe mendimet e atyre që u përpoqën të themelonin një të majtë evropiane, e cila do të vijojë me fazat e tjera. Po ashtu, ky botim është një ftesë për reflektim dhe mundësi që të rinjtë të njihen me individë me identitet politik të qartë, të përcaktuar dhe të dallueshëm, që janë pjesë e trashëgimisë historike të Shqipërisë.

Gentjana Sula

Kryetare e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

Parathënie



**Stine
Klapper**

I dashur lexues,

Po të japim në dorë këtë botim që të bën të mendosh. Ai portretizon dhjetë personalitete, disa më të njohur se të tjerët, por që të gjithë me diçka të përbashkët: ata ishin mendimtarë dhe aktorë politikë të majtë dhe, në mënyra të ndryshme, kundërshtarë të regjimit komunist. Leximi i historive të tyre jetësore na bën të kuptojmë shumë mësimë të rëndësishme që vlejné edhe sot po aq sa në periudhën e errët historike kur jetuan personat e portretizuar. Do të doja të ndaja dy prej këtyre mësimëve:

1. Ideologjitë janë fluide. Kjo vlen si për bindjet ideologjike personale, ashtu edhe për interpretimet e tyre më të gjera. Mendimi politik i majtë u zhvillua gjatë shekullit të kaluar dhe vazhdon të zhvillohet. Ai është tejet pluralist e vjen në një pafundësi formash të ndryshme, si në përkufizime, ashtu edhe në praktikë. Idetë dhe materializimi i tyre e marrin formën prej kontekstit, ndërsa u përgjigjen zhvillimeve historike, shoqërore dhe ekonomike. Të besosh se ka një të vërtetë të vetme, një përkufizim absolut dhe një përgjigje të duhur përfundimtare për kompleksitetin e shoqërisë, shtetit dhe ekonomisë, nuk është vetëm e gabuar, por edhe e rrezikshme. Ky është një perceptim që është keqpërdorur në mënyrë dramatike, veçanërisht gjatë shekullit XX në Shqipëri. Nëse ndalohen diskutimet dhe kritikrat, nëse i pritret rruga ndryshimit dhe korrigjimit të kursit politik, nëse pushteti monopolizohet, nëse ideologjia instrumentalizohet, mund të përfundojmë në regjime të frikshme, regjime që, faktikisht, janë e kundërta e asaj që ëndërruan pionierët e mendimit të majtë politik. Kjo nuk nënkupton se ideologjitë e idetë politike janë të rrezikshme në vetvete. Përkundrazi, ne jetojmë në një botë së cilës i mungojnë këto ide, këto vizione e këto diskutime programore politike. Shumëçka sillet rreth politikës së pushtetit e mendjengushtësisë teknokrate, duke dalë mbi ligjërimin dhe bindjet. Na duhet angazhim e diskutim rreth ideologjive politike, rreth kompleksitetit e dobisë së tyre si busull për orientimin e vendimmarjes politike që mundëson përparimin dhe një shoqëri më demokratike, të drejtë dhe të barabartë, jo si një e vërtetë e vetme dhe absolute.

Kthimi i vështrimit nga personalitetet e portretizuara në këtë libër mund të ushqejë me informacion debatet politike aktuale mbi normat, vlerat dhe orientimet. Disa prej personaliteteve mund të konsiderohen madje si pionierë të mendimit socialdemokrat në Shqipëri. Njohja me jetët, idetë dhe bindjet e tyre do të pasurojë diskutimin e sotëm mbi përgjigjet sociale e demokrate, si

dhe emancipuese e ndërkombëtare ndaj shumë sfidave me të cilat përballen shoqëritë tona.

2. Struktura ka rëndësi, por individët mbajnë përgjegjësi – ata kanë përgjegjësinë për të vepruar a reaguari. Historia shqiptare mori një kthesë të tmerrshme gjatë regjimit të Hoxhës. Megjithatë, jo të gjithë e ndoqën pas. Individët pranuan të merrnin përgjegjësi personale për një kauzë më të madhe, për bashkëqytetarët e tyre. Ata qëndruan, shpesh, duke e paguar shtrenjtë. Ne duam t'i nderojmë e të respektojmë kurajën e tyre. Në të njëjtën kohë, duam të tregojmë se ata jo gjithmonë ndoqën rrugën e drejtë heroike. Gjërat vështirë të jenë bardhezi. Njerëzit luftojnë jo vetëm me shtypjen e jashtme, por edhe me vetë identitetin e tyre. Disa luftuan si partizanë antifashistë dhe mbështetën ideologjinë majtiste të një elite të re politike dhe besuan në objektivin fisnik të barazisë, vetëm për kuptuar më vonë se po kjo ideologji u përdor për të shtypur shumicën e për ta grumbulluar të gjithë pushtetin në duart e një pakice. Ky është një ndërgjegjësim që mund të shkatërrojë thelbin e identitetit personal të njeriut. Jo të gjithë nxorën përfundimet e duhura. Këtë mund ta shihni nga rrugët e ndryshme që zgjedhën të përshkonin individët e portretizuar. Ata luftuan me bindjet dhe veprimet e tyre dhe janë vetë personalitete komplekse. Megjithatë, ata janë prova që dëshmon pse përgjegjësia individuale është e mundur dhe thelbësore.

Veçanërisht, ata tregojnë se kishte edhe opozitë nga e majta, e cila besonte te vlerat themelore të lirisë, drejtësisë dhe solidaritetit, duke protestuar kundër keqpërdorimit dhe zvetënimit të rrënjëve të tyre. Regjimi komunist mund ta quante veten i majtë, por punonte kundër gjithçkaje themelore që përfaqëson ideologjia e majtë.

Dëshirojmë të falënderojmë autorët për studimin e shkëlqyer dhe Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për bashkëpunimin. Kjo është një punë me vlerë të jashtëzakonshme dhe jemi të bindur se ky botim do të shërbejë si pikënisje për shumë diskutime e studime të mëtejshme.

Stine Klapper

Drejtuese e Friedrich-Ebert-Stiftung,
Zyra e Tiranës

1892

Më 31 Mars 1892
lindi në Ziçisht të Korçës, Kostë Çekrezi



1913

Më 25 nëntor 1913
lindi në Dhërmi, Petro Marko

1917

Më 1917
lindi në Tiranë, Isuf Keçi

1924

Në qershor 1924
në Shqipëri ndodhi Lëvizja e Qershorit, e mbështetur nga të gjithë të majtët shqiptarë. Qeveria që doli prej saj drejtohej nga Fan Noli.

1890

Më 1913
lindi në Kaninë, Isuf Luzaj

Më 10 shkurt 1917
lindi në Adana të Turqisë, Musine Kokalari

1919

Më 25 tetor (7 nëntor me kalendarin e ri) bolshevikët me në krye Leninin morën pushtetin

Në 2-6 mars 1919 u themelua në Moskë Internacionalja III

Më 2 mars 1890
lindi në Malëshovë, Sejfulla Malëshova

1899

Në 1899 Sami Frashëri boton në Bukuresht traktatin politik "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhet", një manifest i elitës liberale shqiptare

Më 19 janar 1900
lindi në Kolonjë, Skënder Luarasi

Më 14 prill 1915
lindi në Shkodër, Zef Mala

Më 1922 formohet shoqëria "Bashkimi", ku merr pjesë dhe Sejfulla Malëshova, Tajar Zavalani, etj

1900

1915

Më 15 gusht 1903
lindi në Korçë, Tajar Zavalani

Në fillim të vitit 1918, Partia Bolshevike u quajt Partia Komuniste

1922

1903

1918

1949

Në 1949, Zef Mala lirohet nga burgu

Më 10-23 janar 1946, arrestohen 37 anëtarë të Bashkimit Demokratik Shqiptar, mes tyre MusineKokalari

Më shkurt 1946, në Plenumin V të Komitetit Qendror, Sejfulla Malëshova u shkarkua nga funksionet në Parti

1946

Më 2 korrik 1946, Musine Kokalari u dënua me 20 vjet burgim

1945

Në 13 qershor 1945, Skënder Luarasi kthehet në atdhe

1950

Më 13 maj 1950, lirohet nga burgu Petro Marko

Më 29 shkurt 1950 arrestohet Isuf Keçi



Më 1948, në Plenumin VIII përjashtohet nga Partia Komuniste Sejfulla Malëshova

Arrestohet në pranverë të 1947 Petro Marko

Arrestohet në maj të 1947-s Zef Mala

Në shtator 1947 zhvillohet gjyqi kundër Grupit të Deputetëve

Më 2 shtator 1945 merr fund Lufta e Dytë Botërore në Europë

Në 2 dhjetor 1945 zhvillohen zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese Skënder Luarasi zgjidhet anëtar i saj

Më 5 mars 1953 vdes Stalini

1953

Në 1951, Sejfulla Malëshova internohet në Fier

1948

1947

1945

1951

Më 7 prill 1939, Shqipëria pushtohet nga Italia fashiste.



1939

Midis janar-shkurtit 1939 arrestohet Zef Mala dhe pjesëtarë të tjerë të Grupit Komunist të Shkodrës

Në 1939, Kostë Çekrezi, Sejfulla Malëshova dhe Ymer Dishnica krijojnë "Konfederatën e Shqiptarëve në mërgim", një shoqatë me pikëpamje relativisht të majta

Në vitin 1939, Tajar Zavalani u internua në Italinë e Veriut, për shkak të veprimtarisë së tij kundër regjimit pushtues italian

Më 1 shtator 1939 filloi Lufta e Dytë Botërore.

1935

Më gusht 1935 Kostë Çekrezi përfshihet në Kryengritjen e Fierit

Në 1935, Internacionalja III hodhi idenë e krijimit të Fronteve Popullore kundër rrezikut të vendosjes së diktaturave fashiste

1927

Më 28 gusht 1927 u formua Grupi Komunist Shqiptar në BS, ku do të bënin pjesë Sejfulla Malëshova, Tajar Zavalani, Lazar Fundo, Ali Kelmendi, etj

1928

Më 1 shtator 1928, Zogu u shpall Mbret i Shqipërisë

Më 25 mars 1925 u formua KONARE, me qendër në Vjenë. Po atë muaj, të majtët u grupuan në atë që u quajt Komiteti i Çlirimit Nacional

Në janar 1925, Ahmet Zogu u shpall President i Republikës së Shqipërisë

1933

Në korrik 1933, Partia Naziste u deklarua si partia e vetme e ligjshme në Gjermani

Më 12 dhjetor 1936, Skënder Luarasishkon vullnetar në Luftën Civile që zhvillohej në Spanjë

1936

Në 1937 formohet Grupi Komunist i Shkodrës

Verë 1937 Petro Marko shkon vullnetar në Luftës Civile të Spanjës

Në 1940, Tajar Zavalani vendoset në Londër dhe nga ky vit deri në vdekje punon për BBC

Nga maji 1940 deri në 1942 nis kalvari i burgosjes së Petro Markos në Itali.

1940

1941

Në verën e 1941, Xhavid Qesja pranohet në PKSH

Më 8-14 nëntor 1941 u zhvillua mbledhja themeluese e Partisë Komuniste të Shqipërisë

Zef Mala arrestohet **në fund të 1941** dhe dënohet me internim në Ventotene, Itali

Më 27-28 dhjetor 1941, Kostë Çekrezi themelon organizatën "Shqipëria e Lirë"

1944

Më 24-28 maj 1944 zhvillohet Kongresi i Përmetit, ku Sejfulla Malëshova zgjidhet anëtar i Komitetit të Përgjithshëm të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar

Më 28 nëntor 1944, Isuf Luzaj largohet nga Shqipëria

Më 8 prill 1944, Isuf Keçi pranohet sërish në radhët e Partisë Komuniste

Në qershor 1944, Skënder Luarasi lirohet nga kampi i përqendrimit në Francë

1937

Në qershor 1943, Sejfulla Malëshova kthehet në Shqipëri dhe në 4 korrik 1943 merr pjesë në Mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar.

Në verën e 1943, Zef Mala kthehet në Shqipëri

Në tetor 1943, Musine Kokalari, Isuf Luzaj, etj., formojnë Partinë Socialdemokrate

Më 28-29 qershor 1942 mbahet Konferenca e Jashtëzakonshme e PKSH-së, ku dënohen fraksionet brenda saj

Në 16 shtator 1942 u zhvillua Konferenca e Pezës, ku u vendos krijimi i Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar


Në shtator 1942, Isuf Keçi dëbohet nga Partia

Në nëntor 1942 u shpall krijimi i organizatës politike Balli Kombëtar


1944

1943

1942



1956



Në shkurt 1956 u mbajt Kongresi XX i BRSS, ku nisi kursi i "destalinizimit" (Hrushovi denoncon kultin e individit dhe krimet e kryera nga Stalini)

Më 14-19 prill 1956 u mbajt Konferenca e PPSH-së për Tiranën

1966

Në nëntor 1966, Kongresi V i PPSH-së e cilësoi luftën kundër fesë si aspekt me rëndësi të luftës klasore

Më 19 gusht 1966 vdiq Tajar Zavalani

1959

Më 10 janar 1959 vdiq Kostë Çekrezi

Zef Mala lirohet **në 1959** dhe çohet në Shkodër, më pas internohet në Zvërnec të Vlorës

Në tetor 1955

Zef Mala dënohet me 5 vjet burg në Burrel

Më 1 nëntor 1958, Xhavid Qesja u internua në Zvërnec të Vlorës

Më 8 tetor 1961 lirohet nga burgu Musine Kokalari dhe internohet në Rrëshen

Më 3 dhjetor 1961, qeveria sovjetike vendos ndërprerjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë

1955

1958

1961

1967

Më 12 qershor 1971 ndërroi jetë në spitalin e Fierit Sejfulla Malëshova

1978

Në 1978, Zef Mala u internua në Labovë të Gjirokastrës, ku vdiq më 31 dhjetor 1979

1984

Më 14 gusht 1984 vdiq Isuf Keçi

1994

Më 1994 vdiq Xhavid Qesja

1967

Më 12 shtator 1967, Xhavid Qesja u dënua me 10 vjet heqje lirie

1983

Më 14 gusht 1983 vdiq Musine Kokalari

Më 27 prill 1982 vdiq Skënder Luarasi

1982

Më 25 nëntor 2000 vdiq Isuf Luzaj

2000



Hyrje

Të majtat që nuk fituan

A ishin komunistët që morën pushtetin e vetnija alternativë e dhënë, apo pati ngjyrimë të tjera të së majtës, që humbën në bardhezinë e më se katër dekadave në Shqipëri? Kryekreje, sa të qarta ishin konturet e së majtës dhe sa njiheshin parimet e saja, së gjeri? Studime të gjashtë historianëve sjellin 10 figura të së majtës shqiptare, për të plotësuar një kuadër deri diku të panjohur (a të keqinterpretuar) të mendimit politik të viteve '30, '40 e në vijim, për aq sa mundi të dokumentohej, si mundësia e humbur e shqiptarëve për të pasur të majtën tjetër, si oponencë e ekstremit që u implementua në vend, duke përdorur si pretekst një revolucion të largët ndanë Uraleve. Si një *sapere aude* (të guxojmë të njohim) mbi mundësitë e humbura vjen ky libërth. Nga Sejfulla Malëshova te Kostandin Çekrezi, Tajar Zavalani, Musine Kokalari, Skënder Luarasi, Xhavit Qesja, Isuf Luzaj, Petro Marko, Isuf Keçi dhe Zef Mala, janë sa 10 histori njerëzore me funde të ndryshme, deri edhe fatale, po aq edhe qasje të ndryshme politike, me zanafillë tek e njëjta ëndërr, një Shqipëri më e mirë se ajo e mbretërisë. Në forma të ndryshme, ata e panë ëndrrën e tyre të shkërmoqej në mijëra copa. Disa morën mbi vete një barrë faji, disa vuajtën burgjet e internimet, të tjerë parashikuan lirinë, pasi mësuan se revolucioni po hante kokat e të bijve.

Si parathënie për profilet biografike shërben një studim pararendës i Ilir Kalemajt, që ndalet te të gjitha ngjyrat që u shuan në grinë e sistemit komunist. Ai shënon se në përpjekje për kontribuar në studimin e mendimit politik të së majtës në Shqipëri janë përzgjedhur 10 profile personazhesh që përfaqësojnë rryma të ndryshme të atij mendimi. Si kriter përzgjedhës kanë shërbyer qëndrimet publike që shfaqin identitetin politik dhe pjesëmarrja ose anëtarësia në grupimet politike të majta, që të kuptohet qartë evolucioni apo/dhe metamorfoza e mendimit politik të së majtës. 10 personazhet e kanë zhvilluar aktivitetin e tyre politik në tri periudha historike: mes dy luftërave, gjatë LIIB dhe gjatë “diktaturës së proletarietit”, duke përfaqësuar të gjitha rrymat. Është përjashtuar ai ngjyrim i së majtës që ndihmoi në instalimin e diktaturës së proletarietit dhe është përgjegjëse për represionin ndaj shqiptarëve (edhe kur ata vetë u dënuan nga i njëjti regjim që kontribuan të instalohej).

Tipare ideologjike

Që në krye të herës, Kalemaj shënon se e majta në përgjithësi, ka disa korniza ideologjike të cilat i kanë rezistuar kohës, qysh prej Komunës së Parisit dhe Revolucionit Francez. Një prej tyre është drejtësia sociale, e cila do të mbërrijë me një rishpërndarje të burimeve dhe të ardhurave. Me kërkesën ideologjike për drejtësi sociale, e majta vetëquhet progresiste dhe ka tipare internacionaliste, synon eliminimin e barrierave sociale dhe ekonomike, duke arritur në versionin e saj modern, në zvogëlimin e hendekut mes të pasurve dhe të varfërve në shoqëri. Mbi mekanizmat për të shkuar te qëllimi ka ndasi të forta, në varësi se për cilën të majtë flasim. E majta marksiste është për eliminimin e diferencimeve sociale, nëpërmjet mekanizmit “të luftës së klasave”, pra eliminimin të klasës “së privilegjuar”, për të mbërritur te faza finale, që Karl Marksi e quante “shteti politik pasrevolucionar”. Kalemaj veçon se e majta socialdemokrate e synon këtë përmes mekanizmit të zgjerimit të shtresës së mesme, taksimit progresiv dhe politikave fiskale që synojnë konsolidimin e financave të pjesës më vulnerabël të shoqërisë, si grupet e marginalizuara, punëtorët, minoritetet, etj.

Shqiptarët duket se i përqaftuan herët shumë prej parimeve të së majtës, qoftë marksiste, qoftë asaj socialdemokrate. Studimi i Kalemajt (si pararendës) dhe i historianëve të tjerë, tregon se historia e së majtës shqiptare shkon më herët në histori, qysh me idetë e Sami Frashërit dhe pa dyshim, e tejkalon të majtën komuniste, ndonëse në 47 vitet e jetuara nën një regjim totalitar të majtë të tipit stalinist, u injektua ideja se e majta nisi me themelimin e PKSH-së.

Ndonëse hulumtimet i gjejnë gjurmët e së majtës në Shqipëri që prej fundit të shekullit XIX, fillimi i viteve '20 të shek. XX shfaq qartazi në faqet e shtypit dhe në diskutimet e qarqeve intelektuale parimet themelore të së majtës, si: barazia sociale, rishpërndarja e pasurisë kombëtare, veçanërisht rregullimi i pronësisë së tokës, etj. Duke e gjetur Lëvizjen e Qershorit si përfaqësuese të së majtës liberale, me një program qeverisës me doza utopie dhe radikalizmi, Kalemaj megjithëkëtë shquan lehtë nevojën e dëshpëruar të elitës për të gjetur një alternativë politike që e shkëputte vendin nga trashëgimia osmane.

E majta në Shqipëri, ashtu si në botë, ka qenë pluraliste dhe jo monolite, vëren Kalemaj. Qysh herët u shquan të paktën pesë kategori të së majtës.

Pesë ngjyrat e së majtës në Shqipëri

E majta romantike: individë me ideologji të majtë që ushtruan veprimtarinë e tyre deri në fillim të Luftës së Parë Botërore. Kristo Frashëri i cilësoi, si “ata që nuk e njihnin thelbin as të doktrinës komuniste, madje as të platformës socialdemokrate, por vetëm anën humane, të cilën e propagandonin militantët socialistë europianë”. Një zanafillë e saj gjendet te Sami Frashëri që, me optikën e sotme përfshihet te socialdemokratët ose te socializmi jomarksist, por edhe emra si Stavro Vinjau a Dhimitër Fallo, themeluesi i së parës celulë komuniste në Korçë, në prill të vitit 1928.

E majta utopike (komuniste): me përfaqësues tipikë Qemal Stafën, Sejfulla Malëshovën, Zef Malën, Halim Xhelon, Ali Kelmendin e të tjerë, që qenë pjesë e luftës nacionalçlirimtare, por nuk jetuan ta shihnin të instaluar diktaturën e proletariatit, çka nuk e përjashton fanatizmin e tyre ideologjik me indoktrinim të fortë marksist-leninist dhe ndonjëherë sektarë të vijës së ashpër, sikundër rastet e H. Xhelos apo A. Kelmendit.

E majta trockiste: ihtarët e së cilës, si në BS, edhe në Shqipëri, u etiketuan të tillë për t’u goditur si kundërshtar politikë, anipse rrallë i njihnin idetë dhe kundërvëniet e Trockit. Në Shqipëri, trockist u etiketua Llazar (Zai) Fundo, anëtar i hershëm i Kominternit dhe Federatës Komuniste Ballkanike.

E majta socialiste: me distancë të shëndoshë ideologjike nga leninizmi, si mbivendosi e marksizmit tradicional, përfshin Gjergj Kokoshin, i pari ministër i Arsimit dhe Suad Asllanin, të dy dënuar nga gjyqi politik më 1946. Duke mbrojtur tezat e një të majte socialiste dhe kundërshtuar instalimin e regjimit totalitar, janë emrat që rrinë mirë në këtë kategori të së majtës historike.

E majta socialdemokrate: ku përfshihen Musine Kokalari, Isuf Luzaj, Skënder Muço, etj., përfaqësohej nga ideologë të spikatur që ndanin idetë bazë të së majtës progresive, si drejtësia sociale, rishpërndarja e të ardhurave, luftimi i pabarazive shoqërore, por po aq fuqimisht edhe liberalizmi politik, nevoja për sistem pluralist politik dhe ekonomia e bazuar te prona private.

E majta nacionaliste: ku mund të veçojmë Tajar Zavalanin, Kostë Çekrezin, Fan Nolin, Skënder Luarasin, etj., që bashkonin idetë e një programi ekonomik të majtë me idetë kombëtariste të një Shqipërie të bashkuar me Kosovën dhe viset e tjera amtare, çka del nga veprat e tyre të shkruara.

Kalemaj thekson se kjo është një tipologji e përgjithshme për efekte studimore, pasi ka pasur shumë individë që lehtësisht mund të klasifikohen në më shumë se një grup, fjala bie veprimtarë të Ballit Kombëtar, si: Hysni Lepenica, Skënder Muço, Isuf Luzaj e shumë të tjerë.

Alternativa e mbrapshtë

Marksizmi si doktrinë filozofike dhe rrymë politike e majtës nis në vitet 1864-’76, nën udhëheqjen e Karl Marksit, si lëvizje e klasës punëtore socialiste, ndërsa Shqipëria nuk ish Shqipëri dhe që nën Perandorinë Osmane. Më 1919, kur u mbajt Internacionalja e Tretë Socialiste që do të njihet si International Communist (a Kominterni), e fokusuar në aspektin ndërkombëtar të përhapjes së komunizmit, Shqipëria pat shpallur pavarësinë dhe luftonte për kufijtë në Lidhjen e Kombeve. Kalemaj e gjen tek organizatat e diasporës shqiptare, - si KONARE e Nolit dhe e Boshnjakut në Vjenë, dhe të rinjtë që studionin në Bashkimin Sovjetik, si Zai Fundo, Tajar Zavalani, Halim Xhelo e të tjerë, - nxitjen për të përqafuar idetë e majta në Shqipërinë e viteve ’30. Ndonëse sheh tipare primitiviteti të celulat e përqendruara kryesisht në Korçë, Elbasan, Tiranë e Shkodër, ai nuk mohon se ato ishin farat e para të kultivimit të një lëvizjeje komuniste shqiptare. Rol të spikatur në agjitacion dhe propagandë, por dhe në formësimin e celulave të para komuniste në Korçë, patën Ali Kelmendi, Koço Tashko, Miha Lako, etj. Herë si mëri ndaj politikave të Zogut e herë si nevojë e natyrshme për zhvillim, të majtët e fillesave qenë, sa socialdemokratë, po aq pragmatistë, anarkistë e idealistë, shpesh edhe me kufij të paqartë mes tyre. “Kaosi” u “riorganizua” gjatë Luftës së Dytë Botërore, duke krijuar një PKSH që adaptoi modelin stalinist, nën diktatin jugosllav, duke përdorur luftën si legjitimim për pushtetin në liri, e duke shënuar njëherësh fillesat e luftës së brendshme, që do të eliminonte gjithë grupimet që dilnin jashtë vijës së “partisë” për një të majtë të qartë, të dhunshme dhe diktatoriale. Mes dy luftërave, sistemi bolshevik formësohet qartë në Bashkimin Sovjetik dhe nis shtrirjen botërore, çka do të ishte edhe mekanizëm gjeopolitik për zgjerimin e sferës së influencës. Me themelimin e PKSH-së nën ndikimin e fortë jugosllav, do të dilnin në pah edhe nëndarjet që, si projekte të largëta prej satelitit mëmë në Moskë, në Shqipëri do të shfaqeshin mes hijeve ideologjike dhe nevojës për etiketim të armiqve. *Trockizmi* që një ndër rrymat alternative ndaj stalinizmit, referuar Trockit, që si kritik i Leninit pat parashikuar “diktaturën e proletariatit” mbi proletariatin, të Komitetit Qendror të partisë mbi vetë partinë dhe përfundimisht, të një njeriu mbi Komitetin Qendror. Çka nis të përvijohet që herët edhe tek e majta shqiptare.

Një ndër grupet më aktive para krijimit të PKSH-së ishte Grupi i të Rinjve, i krijuar më 1940, që kryesohej nga Anastas Lula dhe Sadik Premtja. Për drejtuesit e PKSH-së, grupe si ky (Të Rinjtë, Zjarri, etj.), u panë me dyshim nga emisarët jugosllavë pranë PKSH-së, u etiketuan me prirje trockiste dhe u ndoqën për spastrim. Disa rivalë që patën qenë ithtarë të së majtës komuniste, u eliminuan që gjatë luftës, si Anastas Lula, Llazar Fundo, Mustafa Gjinishi. Të tjerë, që u përkisnin grupeve komuniste paraparti, u morën shënim për më pas. Komunistë jostalinistë që përfshihen në studim, si Sejfulla Malëshova, Isuf Keçi, Petro Marko, do të pësonin fate të hidhura në “liri”, prej se të qenët komunist dhe të ndjekurit e vijës së partisë nuk qenë doemos e njëjta gjë. E para dhe më rëndë, u zhduk e majta socialdemokrate, duke nisur me ish-ministrin e Arsimit, Gjergj Kokoshi, që pat qenë në radhët e luftës me armë, mandej zërat e mendimit dhe letërsisë, si Musine Kokalari, Suad Asllani, Myzafer e Arshi Pipa. Gjyqi i deputetëve vrau zyrtarisht dhe publikisht mendimin ndryshe brenda së majtës, duke paralajmëruar për çka do të vinte më pas.

Lufta e klasave nuk çoi në një shoqëri pa klasa, sikundër predikonte në krye të herës Marksi apo Engelsi, por në fakt u krijua një “klasë” e re, ajo e partisë-shtet, funksionarët e së cilës gëzonin privilegjet e vetme në shoqëri që, - sipas Milovan Gjilas (e shumë të tjerëve) dhe vetë viktimave, siç do të dalë nga profilet, - që një klasë shumë më pak meritokratike se sa borgjezia. Klasa e re e komunistëve që kishin konsoliduar pushtetin e tyre pas Revolucionit Bolshevik të Tetorit kishte arritur dominimin shoqëror, në kuptimin edhe të pushtetit politik, edhe atij ekonomik, falë arrvizimit të tyre dhe jo meritave a dijeve. Mes gjithë nuancave, socialdemokracia ishte një ndër alternativat ndaj së majtës marksiste, me shembullin ideal atë danez, themeluar që më 1876, që sot gjendet te lidërshipi i laburistëve anglezë ose demokratit amerikan Bernie Sanders. Ajo rrok drejtësinë sociale dhe konceptet e rishpërndarjes së pasurisë përmes taksimit progresiv, parime sa historike, aq edhe aktuale, që kanë gjetur reflektim të plotë edhe te socialdemokratët shqiptarë të viteve ’30 dhe te partia jetëshkurtër e Musine Kokalarit, Isuf Luzajt e të tjerëve.

Mendime të mbytura

Pas instalimit të sistemit, ngjyrat u shuan. Cila ishte e majta jostaliniste në kushtet e një regjimi totalitar? Kalemaj thotë se është e vështirë të flasësh për mendimin politik të së majtës në kushtet e një regjimi totalitar stalinist, i cili, në kuadër të procesit të unifikimit ideologjik, luftoi pa mëshirë çdo individ apo grupim që guxonte të shfaqte tendenca të së majtës jostaliniste. Emra të njohur të së majtës, që u ndërgjegjësuat për atë që kishin brohoritur për të sjellë në vend, u heshtën përgjithnjë, herë si kolaboracionistë (Kolë Tromara), herë me grupin e deputetëve (Shefqet Beja, Kolë Kuqali, Sheh Ibrahim Karbunara, Irfan Majuni, Enver Sazani, Riza Dani, Selaudin Toto apo Kostandin Boshnjaku) a emra të tjerë me kapital në publik (Musine Kokalari, Gjergj Kokoshi, etj.).

Goditja e së majtës jostaliniste vijoi kohë pas kohe dhe përfshiu shumë veprimtarë apo mendimtarë të së majtës komuniste, duke dëshmuar luftën e pareshtur për të jetësuar pushtetin e pakufizuar të Hoxhës.

Pas spastrimit të pasluftës, Konferenca e Tiranës e prillit 1956 do të shërbente si shembull për të gjithë ata që do të guxonin të ngrinin zërin kundër pushtetarëve. Nën shpresën e krijuar nga procesi i destalinizimit, komunistët e Tiranës shpresuan të detyronin lidershipin në vendin e tyre për ta bërë regjimin më njerëzor. 300 pyetjet e drejtuara Presidiumit të Konferencës nga salla e që shprehnin shqetësimet e drejta për gjendjen tejet të vështirë të vendit, privilegjet e Bllokut dhe mungesën e demokracisë brenda partisë, shërbyen për të evidentuar zërat ndryshe a kundër. Për Kalemajn, në vetëm disa orë, akuzuesit e Konferencës së Tiranës u kthyen në të akuzuar dhe u kalua nga shpresa për ndryshim, e shprehur deri edhe me nuanca revolte, te frika e kupolës nga forca e të nënshtruarve. Në “gjuetinë e shtrigave” që pasoi, bënë që 243 organizata partie e 2000 komunistë të dënonin veprimtarinë “armiçësore” të kritikëve të konferencës dhe të atyre që i mbështetën. Në javët, muajt e madje vitet në vijim, guximtarët u linçuan. Konferenca e Tiranës do të qëndronte në kryet e tyre si shpata e Damokleut, ndërsa për shqiptarët, destalinizimi nuk ndodhi kurrë.

Një rrekje e fundme është ajo e të rinjve të 1962-t, kryesuar nga gazetarët Fadil Kokomani dhe Vangjel Lezho, të ndjekur nga ushtarakët Trifon Xhagjika e Thoma Rafaeli, etj. Ajo që nisi si kërkesë kulturore mori drejtim politik, duke kërkuar zbutje të sistemit diktatorial dhe lirim të të burgosurve politikë. Të gjithë u arrestuan, Xhagjika dhe Rafaeli u pushkatuan, ndërsa dy gazetarët u pushkatuan më 1979, pas një letre ku i kërkonin Komitetit Qendror shkarkimin e Enver Hoxhës.

Pos sa më lart, ky libër do të tregojë edhe mendimin e majtë të komunistit Xhavid Qesja, “ruajtur” nga Sigurimi, një zë i vetëm nga burgu në burg. E majta, *de jure*, nuk kishte filluar me Enver Hoxhën, por studimet do të tregojnë se *de facto*, ajo perceptohej, interpretohej dhe treguhej sipas qasjes së tij. Mes gjithë të majtave, fitoi alternativa më e mbrapshtë “*In absentia lucis, Tenebrae vincunt*” (në mungesë të dritës, errësira triumfon).

Sejfulla
Malëshova

1

Mes ëndrrës dhe zhgënjimit

Djaloshi që u dha herët pas komunizmit, që ngjiti shpejt shkallët e pushtetit, po aq papritur u gremis që andej. Do ta mbyllte jetën i vetmuar në një nga lagjet e varfra të Fierit, ndaj Lalaj pyet nëse Malëshova, ishte një bolshevik i bindur apo një i majtë i moderuar; e më në fund, ishte ai viktimë e luftës për pushtet, apo kurban i ideve të veta?

Portreti i hequr i një burri dhe shikimi, që herë duket se të sheh në sy, e herë duket se e ka hedhur vështrimin në një pikë të pacaktuar, nuk të thotë shumë për njeriun prapa tij. As balli i lartë, as buzët e holla, as fytyra e imët nuk kumtojnë. Vetëm kur njohim historinë e tij, vështrimi i padeshfrueshëm pothuaj i thotë të gjitha. Djaloshi që u dha herët pas komunizmit, që ngjiti shpejt shkallët e pushtetit dhe po aq papritur u gremis që andej, poeti popullor, përkthyesi anonim që kishte sjellë në shqip Gëten, Pushkinin e Nekrasovin, po dhe Gorkin e Marksit, do ta mbyllte jetën i vetmuar në një nga lagjet e varfra të Fierit. Ngjashmërisht me legjendën, për në jetën e përtejme e përcolli vetëm motra, e vetmja që i kishte mbetur, bashkë me dy varrmihës dhe dy agjentë të Sigurimit të Shtetit, që në njëzet vjet i qenë bërë hije e vetvetes.

Ky është Sejfulla Malëshova. I gjithëpranuar si një nga burrat më të ditur e të kulturuar, por nga më të debatuarit si personalitet politik i Luftës së Dytë Botërore dhe i pasluftës. Midis këtyre dy poleve, prof. Ana Lalaj, historiane, mbi studimin e së cilës do të bazohet më tej ky artikull, kujdeset të vërë në dukje disa linja të holla e të ndërmjetme, që në rastin e Sejfulla Malëshovës, ajo i sheh si përcaktuese të personalitetit të tij. Që në krye të studimit, ajo pyet nëse Malëshova, ishte një bolshevik i bindur apo një i majtë i moderuar, ndoshta socialdemokrat, sipas një versioni në qarkullim; e më në fund, ishte ai viktimë e luftës për pushtet apo kurban i ideve të veta?

I lindur në marsin e 1900-s në Malëshovë, i ati doganier, Tasim Hoxha do ta merrte në Vlorë, ku mendohet se mori mësimet e para në turqisht. Mandej dihet se ka ndjekur mësimet e mesme në kolegjin e Shën Adrianit, në Kalabri, prej ku shkoi në Romë për mjekësi. I kësaj kohe duhet të ketë qenë ndërrimi i mbiemrit nga Hoxha në Malëshova. Kur ai ishte 19 vjeç, në Evropën politike, kishin lindur shtete të reja kombëtare, ndërsa në Rusi qe vendosur bolshevizmi, varianti më ekstrem i komunizmit të Marksit. Më 1919, kur turmat kërkuan përmbysjen e borgjezisë, komunizmi nis të mbërrijë në Shqipëri, një vend pa parti të majta. Denoncimi që i bëri Lenini Traktatit të Fshtët të Londrës që cenonte kufijtë e Shqipërisë, ngjalli simpati për të.


Për rininë e Sejfulla Malëshovës që përkonte me këto vite, ka pak të dhëna, përveç botimit të poezive të para nën emrin Lame Kodra. Një raport i 1944-s thotë se më 1922 i ndërpreu bursën në Romë, si “element subversiv” dhe “revolucionar”. Atë vit gjenden gjurmët e tij në Tiranë si editor te gazeta “Xhoka”. Më 1924, që shihet si vit kyç për të majtën në vend me dy anët e saj, Malëshova ishte në Shqipëri, ku e gjejmë mes të ndaluarve për atentatin ndaj Ahmet Zogut. Vrasja më pas e Avni Rustemit që u ndoq nga kryengritja e qershorit, ikja e Ahmet Zogut, ardhja e qeverisë së Nolit, dështimi i tij, rikthimi i Zogut dhe ikja e Fan Nolit, shënon edhe ikjen e Sejfulla Malëshovës, që ishte sekretar i përgjithshëm i qeverisë disamujore.

Në vitin 1925, të mërguarit e majtë e të djathtë, si Fan Noli, Lazar Fundo e Mustafa Kruja formuan organizatën KONARE (Komiteti Nacional Revolucionar), e brenda saj, të majtët ngritën *Komitetin e Çlirimit Nacional*, ndërsa të djathtët dolën më vete, e krijuan *Bashkimin Kombëtar*, në shenjë mospajtimi me politikën e majtë që ndoqi KONARE-ja, veçanërisht me financimet që merrte nga Moska. Ana Lalaj arrin në përfundimin se në mesin e viteve ‘20, e majta, aq më pak ajo komuniste, nuk mund të zhvillohej në rrugë legale brenda në Shqipëri, ndaj ajo u krijua në emigracion, ku dolën në pah disa grupime e personazhe, mes tyre edhe Sejfulla Malëshova.

Një organizatë komuniste më vete e shqiptarëve për herë të parë u krijua më 28 gusht 1927, nën emrin *Grupi Komunist Shqiptar* në Bashkimin Sovjetik. Malëshova gjendet mes 12 studentëve që përmes Kominternit, ishin dërguar në Bashkimin Sovjetik për studime. Nga bisedat e tij private, të regjistruara kur u vu në përpunim nga Sigurimi i Shtetit më 1951, gjendet ky pohim: “Më 1927 u pranua kandidat i Partisë Bolshevike. Në vitet ’30 u bëra anëtar i saj. Më ’30-’31 erdha në konflikt me shokët shqiptarë për çështjen taktike të punës në Shqipëri dhe Kominterni ia besoi punën Zai Fundos ... Unë vazhdova të shkruaj artikuj për “Lirinë Kombëtare” dhe vazhdova punën si profesor filozofie në Moskë”. Nga Moska del të jetë larguar në vitin 1939, megjithëse Fjalori Enciklopedik Shqiptar thotë se ai “u përjashtua si buharinist”.

Që në vitet e para komunistët ishin ndarë në grupe, ndasitë mes të cilëve, thelloheshin dita-ditës, duke u reflektuar edhe në mediat e kohës. Në ato debate që imitonin debatet moskovite, Malëshova iu mbajt vijës bolshevike. Por studiuesja Lalaj, thotë se ajo çfarë ndodhi vite më pas në veprimet e Malëshovës e vë në dyshim nëse bolshevizmi i mëhershëm ka qenë bindje e tij apo një konformizëm ideologjik në kushte dhune i një anëtari të Partisë bolshevike. Nëse do të ishte kjo e dyta, mund të thuhet po aq se kjo do të kishte qenë për të një sjellje atipike.

Fillimi i Luftës së Dytë Botërore e gjeti Malëshovën në Francë, ku pothuaj ka shkëputur çdo lidhje me Shqipërinë. Kjo del qartë nga letrat e njëpasnjëshme që i dërgon Fan Nolit në Amerikë, ku i kërkon të ndërhyjë për t’i gjetur punë në SHBA. Ndërsa të dhënat flasin për një propozim që i bëri Ahmet Zogu Malëshovës, që të punojë me shqiptarët e Amerikës në mbështetje të luftës, sigurisht për interes të oborrit. Në një letër të tetorit 1944, Miladin Popoviçi shprehet për të se “*Ky person, që jeton në Paris, asgjë nuk ka bërë deri më tash për punën revolucionare në Shqipëri*”.



Sejfulla Malëshova ishte një bolshevik i bindur apo një i majtë i moderuar, ndoshta socialdemokrat, sipas një versioni në qarkullim. (në foto)

Dy vite më pas e gjejmë në Shqipëri. Nga dosja e tij formulare, del të ketë pohuar që ka ardhur me pasaportë të rregullt, lëshuar nga legata shqiptare në Paris me emrin Sejfulla Tahsin. Dokumentet tregojnë se ai ishte takuar në Modena me Hulusi Spahiun, ushtarak dhe vullnetar në Luftën e Spanjës. Ishte po ai që i shërbeu si lidhje e tij me Partinë Komuniste. Më 4 korrik 1943, Malëshova ishte në mbledhjen e Labinotit, ku u vendos krijimi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe ai u zgjodh anëtar. Malëshova u bë pjesë e Komitetit Qendror të PKSH dhe mori funksione në Kongresin e Përmetit dhe në qeverinë e Beratit në fund të luftës. Ndërsa gjatë saj, pati funksione të rëndësishme politike, por jo ushtarake, edhe pse kishte studiuar në një akademi ushtarake-politike. Për të nuk dihet të ketë qenë në luftime, as të jetë marrë me plane a skema taktikash a veprimesh luftarake. Historiana Ana Lalaj, vë në dukje se Enver Hoxhës i duhej dikush që të shpjegonte luftën që ai drejtonte dhe të frymëzonte luftëtarët. Malëshova, pa dyshim, ishte njeriu i përshtatshëm. Ai përshkruhet si një njeri që kuptonte nevojën për mbështetje në popull dhe atë për aleanca. I ditur, i qartë në të shprehur e të shkruar, Hoxha e përfshiu Malëshovën në të gjitha forumet e luftës, ku duhej të hartonte rezoluta, të përgatiste vendime, të nxirrte buletine, të shkruante trakte e deri pjesë për teatrin partizan.

Megjithatë Hoxha shfaqet i pakënaqur me punën e tij, çka del në disa letra drejtuar Ymer Dishnicës. Ai shkruan se *“s’po bën gjëkafshë ... mund të jesh komunist me kokë të madhe, mund të kesh punuar dhe në Moskë, mund të kesh punuar dhe në Komintern, si thotë Sejfullahu, po fakti është se nuk po bën gjë”*. Pakënaqësitë e Hoxhës, Lalaj i sheh më shumë si taktikë të tij për t’i shfrytëzuar deri në fund kapacitetet e Malëshovës e sidomos për ta mbajtur atë në kontroll. Hoxha është i pakënaqur me Malëshovën jo se ai i shmangej punës, përkundrazi, po se ai *“... ka shtuar kritikën ... Ai kritikon, bile ashpër të gjithë artikujt që shkruhen në Zërin e Popullit dhe në Bashkimi kundra Ballit ... Këto të meta ne duhet t’ia zhdukim ...”*. E qartë, Hoxha

“

Për herë të parë këtu
unë mora vesh si u vra
Mustafa Gjinishi dhe
nuk e kuptoj përse,
tha ai ... Ose ai ka qenë
tradhtar i Partisë dhe
i popullit dhe duhej
të dënohej hapur, ose
ai ka bërë gabime
dhe për gabime nuk
dënohen njerëzit ...

Sejfulla Malëshova

”

ndjehet i shqetësuar jo për “rendimentin” në punë të Malëshovës, po se ai nuk ishte përfshirë ende në strategjinë e re të Hoxhës në raportet me Ballin, teksa ai sapo kishte urdhëruar “për shpartallimin e tij”. Pavarësisht mospajtimeve, rezultoi që në fund të luftës, Malëshova të ketë marrë mbështetjen e Hoxhës dhe po ashtu, të ketë fituar prestigj midis luftëtarëve. Gjatë ditëve kur u mbajt Kongresi i Përmetit, maj 1944, fjala e tij dhe poezitë e recituara priteshin me ovacione. Në këtë kongres Malëshova u zgjodh anëtar i Komitetit të Përgjithshëm të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar; në tetor anëtar i KQ, ministër për propagandën dhe kulturën popullore në Qeverinë e Përkohshme Demokratike dhe po atë muaj sekretar i organizatës së Frontit Nacionalçlirimtar.

Po në nëntor 1944, në ditët kur Berati ishte kthyer në kryeqendër të vendit dhe që vendosur atje selia e *Qeverisë Provizore Demokratike*, u mbajt Plenumi II i KQ të Partisë Komuniste, i cili bëri analizën politike të kohës së luftës. Për shkak se ajo mbledhje ishte krye e fund kritike, ajo u mbajt e fshehtë 50 vjet, deri më 1996, kur Arkivi i Shtetit e bëri publike dosjen. Referatet qenë mbajtur nga Malëshova, Xoxe dhe Hoxha. Referati i Malëshovës për gjendjen politike në vend, nuk është gjetur në arkivin e Partisë së Punës. Megjithatë, ai e ka marrë disa herë fjalën, çka është regjistruar në protokollet e asaj mbledhjeje dhe ku duket se ai i ka dhënë tonin analizës. Ajo që përshkoi thujse gjithë diskutimet ishte sektarizmi i luftës dhe kjo çështje për Malëshovën u kthye në çast thelbësor të vetëdijes politike. Jo se ai që më kritikoi ndaj praktikave sektare të luftës, jo se ishte më kritikoi ndaj Enver Hoxhës, njeriut përgjegjës për inkurajimin e këtyre praktikave, po se për të ishte verifikimi i parë në terren i formimit të tij me komunizmin si ideologji, si filozofi dhe si politikë. Çështja u kthye në çast thelbësor edhe për kthesat e vështira që mori jeta e Sejfulla Malëshovës, ku Berati u shënua si referencë e fshehur për peripecitë që do ta ndiqnin.

Duke folur për sektarizmin e luftës, vetë Hoxha duket reflektiv tek thotë se me Ballin, “nga oportunitizmi i parë u hodhëm në një sektarizëm të ekzagjeruar”. Malëshova e çon më tej mendimin, duke e quajtur si provokim të komunistëve kundërvënien me armë ndaj Ballit. Por më tronditëse është ajo çka kumton Malëshova, teksa ka vërejtur si partia e tij po degjeneronte në bandë kriminelësh. *“Për herë të parë këtu unë mora vesh si u vra Mustafa Gjinishi dhe nuk e kuptoj përse, tha ai ... Ose ai ka qenë tradhtar i Partisë dhe i popullit dhe duhej të dënohej hapur, ose ai ka bërë gabime dhe për gabime nuk dënohen njerëzit ... Terrorizmi, si në popull, si në ushtri, si në parti, tregon, së pari, dobësinë e vijës sonë politike, së dyti tregon mosbesimin në popull, së treti, tregon se ne nuk kemi lidhje me masat ... Tregon se në çfarë niveli teorik e politik qëndron Partia jonë ... Unë jam çuditur kur kam dëgjuar të thuhet se sa më brutal e terrorist të jetë një njeri, aq më komunist është, dmth i masim shokët nga brutaliteti dhe kriminaliteti. Ky është një kriter i gabuar. Kështu në Partinë tonë po duken simptomat e degjenerimit nga një parti politike në një bandë kriminelësh”.*


Kritikat në Plenumin e Beratit, Hoxha i priti me qetësi, ndonëse siç e ka pohuar më vonë, personalisht Berati i kishte dhembur shumë. Nuk ka të dhëna që ai t'i jetë kundërvënë ndonjërit prej kritikëve, së paku për njëfarë kohe, për shkak të Beratit. Pra, as Malëshovës, edhe pse më i hidhuri. Përkundrazi, faktet thonë se ai u mbështet shumë te Malëshova, duke i dhënë pushtet skaj më skaj, nga kultura e deri tek ekonomia. Më shumë se aq, në vitin e parë të pasluftës ai u vu në krye të reformave kryesore në vend dhe u mor sidomos me përgatitjen e zgjedhjeve për Asamblenë Kushtetuese. Këtu fillon segmenti kohor politik, gjithë-gjithë pak më shumë se 13 muaj, koha më intensive për Malëshovën politikan e shtetar. Ky segment nisi më 26 tetor 1944, që kur në Berat u krijua Organizata e Frontit Nacionalçlirimtar. Në atë konferencë Malëshova paraqiti platformën e organizatës, në të cilën ftoheshin të gjithë, përfshirë edhe kundërshtarë të komunistëve, përjashtuar ata që kishin humbur të drejtat civile. Në gushtin pasardhës u bë kongresi dhe përsëri Malëshova shpjegoi e mbrojti të njëjtën platformë.




Enver Hoxha dhe Sejfulla Malëshova, nga e majta në të djathtë, i katërti dhe i pesti

Politika e hapjes së Frontit ishte taktikë e zgjuar. Përpara ishin zgjedhjet e përgjithshme dhe taktikat me Frontin lidhen pikërisht me këto zgjedhje. Organizata e Frontit u gjet si ombrellë elektorale ku mund të bënin pjesë parti, organizata dhe shoqata. Në kushtet kur komunistët e kishin lënë vendin djallëzsisht pa opozitë, Hoxha u përpoq të sajonte një opozitë fasadë, siç ishte rasti me klerin katolik. Por kjo u kuptua dhe askush nuk e pranoi fasadën. Më 2 dhjetor 1945 komunistët morën 93 për qind të votave. Por nga politika e hapjes së Frontit përfituan edhe disa individë jo simpatizantë të komunistëve, po që u bënë pjesë e Asamblesë me mbështetjen e këtyre të fundit. Hoxha e kuptoi se ata do të organizoheshin të krijonin një opozitë nga brenda. Në ditën e katërt pas zgjedhjeve Hoxha thirri Byronë Politike, ku lëshoi alarmin për oportunizëm në parti e jo vetëm. Ai e drejtoi gishtin te Sejfulla Malëshova si personi përgjegjës për oportunizëm; u shënjestrua edhe për politikën e ndjekura në ekonomi dhe në politikën fiskale; si dhe për marrëdhëniet me Perëndimin. Më 11 dhjetor gjashtë anëtarët e Byrosë, në rresht, firmosën dokumentin kundër oportunizmit të Malëshovës, duke ia kaluar çështjen për analizë të mëtejshme Plenumit të KQ. I vetmi që votoi kundër dhe që nuk i pranoi kritikën ishte vetë Malëshova.

Kjo ditë shënon fundin politik të Malëshovës. Aktet e mëtejshme janë thjesht sanksione të një fati të paravendosur. Kjo histori dëshmon edhe dallimet konceptuale dhe të praktikave të zbatimit midis atij dhe pjesës tjetër të udhëheqjes komuniste, duke e shenjuar dallueshëm me të gjitha rastet që pasuan. Sigurisht, veprimet e Malëshovës nuk ishin kryer fshehtas nga Partia, por ato ishin të ndryshme në qëllime. Nëse Hoxha e shihte gjithçka në shërbim të pushtetit të tij, Malëshova e manifestoi si bindje. Dhe për këtë arsye i mbrojti sa mundi pikëpamjet e veta, pa bërë asnjëherë autokritikë. Për këtë vizion ndryshe, studiuesja Ana Lalaj vjen në përfundimin se fryma që kërkoi t'u jepte në mënyrë idealistike



Qeveria e Beratit më 1944, ku Malëshova figuron ministër i Shtypit, Propagandës dhe Kulturës Popullore



Informacion nga Legata jugosllave në Tiranë, maj 1947, ku flitet për Sejfulla Malëshovën

raporteve sociale në vend, sa ç'ishte largim nga dogma, duket se po aq ishte me ndikim perëndimor, prej nga Malëshova vinte. Sejfulla Malëshova mbrojtë si rrugë progresi për vendin e tij mbështetjen, sa te Bashkimi Sovjetik, aq edhe te Perëndimi, edhe pse mund të mos ishte rrugë e sigurt. E sigurt është se ky opinionion u bë njëri nga shkaqet që i kushtoi shumë malëshovitetit idealist. Sikundër ideja e bashkëjetesës, edhe ajo e konkurrencës së lirë midis pronës së shtetit dhe pronës private, si mekanizëm zhvillimi, mund të mos ishte jetëgjatë. Edhe kjo ide kundërvënëse me çdo program bolshevist, që ka për thelb asgjësimin e pronës private, i kushtoi jo pak profesorit të filozofisë, ministrit të Propagandës dhe të Kulturës Popullore, kryetarit të Komitetit për Ekonominë.

Janë të shumta dhe të mjafta burimet dokumentare, ku janë fiksuar pikëpamjet e Sejfulla Malëshovës në rrafshet e politikës, të praktikave ekonomike e sociale, po edhe të përpjekjeve për hapësira demokracie në kushte diktature. Vështirë të thuash se këto ide do të provoheshin të efektshme, nëse në terrenin shqiptar do të qe aplikuar një regjim disi më i butë. Vetë Malëshova duhet të ketë pasur përvojë të vështira në fund të viteve '20, kohë e bolshevizimit të përgjithshëm të komunizmit europian, përfshirë nën moton "Revolution from above". Ashtu sikundër një tjetër përvojë duhet të ketë lënë gjurmë, ndërsa Malëshova, si anëtar i partisë bolshevice, e kishte përjetuar nga afër *Purgën* e tmerrshme të mesviteve '30 në Rusinë Sovjetike. Përmasat e atij tmerrri ndoshta përbëjnë arsye të mjaftueshme pse ai u përpoq me sa mundi të shmangej e ngjashmja në vendin e tij. Sidoqoftë, këto qëndrime politike, si dhe idetë për reforma ekonomike, përbëjnë të veçantat në veprimtarinë politike të Sejfulla Malëshovës. Në këto linja, studiuesja Lalaj mendon se duhet gjykuar Malëshova dhe do gjetur thelbi i malëshovizmit, si përpjekje për jetë njerëzore në një regjim çnjerëzor.

Konstandin Çekrezi



Socialdemokrati që kundërshtoi dy pushtete

Ai që gjatë luftës kishte kërkuar bashkëpunimin e shqiptarëve të emigracionit me ata të rezistencës, ai që kishte njohur pa hezitim qeverinë e dalë nga lufta, tashmë u kishte kthyer krahët fitimtarëve. Dhuna e përdorur për vendosjen e regjimit të ri duket se e shpjegon metamorfozën e Çekrezit.

“Ishte e shtuna e dytë, 12 qershor 1910, kur djaloshi i ri, Kostë Çekrezi, me cullufen e ngritur mbi ballë, linte rrugicat e kalldrëmta të Korçës dhe ndiqte pas, në të dalë të Mborjes, të atin, një burrë i shkurtër e fjalëpakë. Në njërën anë të mushkës kishin ngarkuar një valixhe druri të mbushur me libra dhe fletore”. Andon Andoni, autor i monografisë “Kostë Çekrezi, i treti i munguari” i bën këtë përshkrim një prej shqiptarëve më në zë të viteve ’30 -’40. Prej këtyre frazave që flasin për të 18-at e tij, Kostandini, historian, gazetar, publicist e politikan, do të ruante deri në fund të jetës dy elementë të pangatërrueshëm, atdheun dhe librat. Në imazhet e mbërritura deri në ditët tona, pos syzeve çehoviane, shquan edhe një shikim plot dritë, si parathënës i largpamësisë që ushqeu për Shqipëri të lirë.

I lindur më 1892 në Ziçisht, mësimet e para i mori në shqip e greqisht, më pas mbaroi gjimnazin grek të Korçës. Studimet universitare që nisi në Selanik i la prej luftës së madhe, por më 1918 e gjejmë t’i ketë kryer për ekonomi dhe administrim publik në Universitetin e Harvardit.

Në mesin e këtyre dy kufijve, veçse 22 vjeç u përball me çështje të ndjeshme që e shenjojnë si njeri i ndryshimit, siç qe procesi kundër një myftiu kur punonte në Gjykatën e Vlorës. Dhe jeta do ta vinte gjithnjë para sfidash e ngjarjesh të mëdha. Mbështet reformat e qeverisë së dalë pas Pavarësisë, mes të cilave shtetin laik, përkthen pranë Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit e Princ Vidit. Në moshën 23-vjeçare emigron në Amerikë dhe në pak vite është në krye të tri mediave me rëndësi, më 1915, në gazetën “Dielli” të “Vatrës”, më 1916 tek “Illyria” dhe më 1919 tek “Adriatic Review”.

Njëherit, regjistron komunitetin shqiptar në SHBA dhe kërkon ta kthejë “Vatrën” në shoqëri politike, por has në kundërshtimin e fuqishëm të Fan Nolit, me të cilin nuk do të binin dakord për shumë gjëra në vitet e ardhshme.


Më 1919 botoi librin “*Albania, past and present*”, ku jo vetëm rrëzon shtrembërimet fqinje, por siç shënonte në parathënie profesori i njohur amerikan Charles D. Hazen, “është i pari i një shqiptari për Shqipërinë që ka dalë në gjuhën angleze” dhe që “një shpalesje e historisë së Shqipërisë, një paraqitje të kërkesave të shqiptarëve”.

Profesor Hamit Kaba, mbi studimin e të cilit bazohet ky artikull, e sheh me interes librin ngase në të dalin të qarta idetë e Çekrezit: zgjidhja e problemit të tokave si detyrim i pashmangshëm, besimi se Shqipëria mund të bëhej shtet modern dhe bindja se, “askund në Ballkan gruaja nuk respektohet e nderohet kaq shumë (sa te ne)”. Megjithatë, Çekrezi e dinte se vendi dhe qeveria nuk mund të modernizohej brenda natës, çka e thotë qartë kur flet kundër kritikëve të qeverisë së Ismail Qemalit. Ndonëse Kaba gjen edhe idealizime, idetë liberale e socialdemokrate të Çekrezit i shquan te trajtimi i problemit të pakicave e minoriteteve në Shqipëri. Në tri vitet në vijim e gjejmë mes diplomacisë dhe mësimdhënies. Si komisionier i Shqipërisë në Uashington bën përpjekje të jashtëzakonshme për njohjen e qeverisë shqiptare nga SHBA dhe jep dorëheqjen kur nuk arrin rezultat (1922). Ndërsa në ligjërimet e mbajtura si pedagog në Universitetin e Uashingtonit dhe atë të Nju Jorkut, dalin në pah aftësitë e tij profesionale e intelektuale.

Konstandin Çekrezi kthehet në Shqipëri më 1925. Ka ardhur në pushtet Ahmet Zogu e me ndihmën e tij, Konstandini ka siguruar një shtypshkronjë. Boton gazetën “Telegraf” dhe për tre vjet mbështet “shugurimin” e Zogut mbret të shqiptarëve. Por më 1928, mes tyre nis një përplasje e përjetshme. Si shkaqe renditen disa: raporti i afërt i mbretit me Italinë, qeverisja autoritare, paaftësia e “oborrarëve” dhe një pretendim i mundshëm i Çekrezit për president. Profesor Kaba, më shumë se ambiciet e ish-studentit të Harvardit, e gjen të vështirë të pajtojë natyrën rebele të Çekrezit dhe formimin me idetë e demokracisë amerikane, me stilin qeverisës me tharm oriental të mbretit Zog.

Më 14 shtator 1928, Çekrezi arrestohet dhe dënohet me një vit burg, por bën vetëm disa javë. Pas mbylljes së gazetës “Telegraf” ai hap revistën “Ora”, duke lënë në krye kushëririn e tij, Vasil Xhaçka. Tre vjet më vonë, më 1931, e gjejmë sërish në gjyq, si një ndër organizatorët e një kryengritjeje tjetër kundër mbretit që e kishte përkrahur edhe në revistë, edhe duke marrë përsipër të rekrutonte shqiptarët e Amerikës. I dënuar me tre vjet, ai qëndroi dy vjet e gjysmë në burg. Por me të dalë, më 1935, përfshihet në Kryengritjen e Fierit, një tjetër komplot kundër monarkut. Kryengritja ishte një bashkim njerëzish me bindje republikane, nacionaliste e deri komuniste, ndërsa vetë Çekrezi ishte i pakënaqur me regjimin e “bazuar te forca”, që kishte sjellë katër lëvizje kryengritëse në dhjetë vjet. Këtë herë e dënuan me vdekje dhe ai u detyrua të emigrojë fillimisht në Itali e më pas në Francë, ku më 1939, së bashku me Sejfulla Malëshovën, Dr. Ymer Dishnicën, etj., krijuan Konfederatën e Shqiptarëve në Mërgim, një shoqatë me pikëpamje relativisht të majta, të udhëhequr prej tij.

Që në këtë kohë që nisën ta quanin komunist, por Kaba nuk gjen të dhëna për bindje të tilla. Vetë Çekrezi fajësonte Zogun për këtë akuzë të pabazë, ndërsa Dalip Greca, duke pranuar se Çekrezi anonte majtas, sqaron se ishte “një i majtë liberal i modelit amerikan”. Antikomunizmi i tij del qartë në shkrimet e lëna në gazetën “Telegraf” dhe debatet me disa komunistë të njohur shqiptarë të kohës. Mjaft të përmendim që Çekrezi e quajti “vetëvrasje politike” pjesëmarrjen e Fan Nolit në festimet e 10-vjetorit të Revolucionit të Tetorit në Moskë, më 1927. Më qartë, dasitë me pikëpamjet politike me komunistët dalin te libri “*Plani i tretë për copëtimin e Shqipërisë*”. Në të, historiani dhe politikani rrëfen vështirësinë e bashkëjetesës me komunistët shqiptarë në kampin e internimit të Vishisë në Francë (ku ishte çuar pas Luftës së Spanjës). Ai përmend debate me Mehmet Shehun në barakën nr. 38, ku



Çekrezi, si shumë shqiptarë të tjerë emigroi në Amerikë dhe shumë shpejt (në vitin 1915) u emërua kryeredaktor i gazetës 'Dielli' të 'Vatrës', të cilën e shndërroi në gazetë të përditshme. (në foto)

kryeministri i ardhshëm deklaronte se: *"për të rrënjosur komunizmin në çdo vend, qoftë e sidomos në Shqipëri, do të jetë e nevojshme të shfarosen të gjithë elementët kundërshtarë..."*. Kur Çekrezi e pyeti *"po nëse shumica e popullit është kundra?"*, Mehmet Shehu iu përgjigj: *"atëherë, shumica duhet shfarosur"*.

Ai del prej Vishisë me ndihmën e amerikanëve dhe më 27 tetor 1941 mbërrin në Nju Jork. Dy muaj më pas thërret një kongres të shqiptarëve të Amerikës, krijon organizatën "Shqipëria e Lirë" dhe merr drejtimin e saj duke i dhënë tiparet e veta, rebele, ambicioze, nacionaliste dhe demokratike. Programi i tij politik me 5 pika, synonte të bashkonte shqiptarët e mërguar, të garantonte të drejtat e kombit shqiptar, duke bashkëpunuar me Amerikën e Anglinë; të vendoste lidhje me grupet e rezistencës në Shqipëri dhe të përgatiste plane për rindërtimin e shtetit shqiptar të pasluftës. Për këtë lipsej krijuar, sipas tij, një qeveri që do të dilte nga populli, *"duke përjashtuar të gjithë ata që duan të bëhen mbretër, princër, diktatorë e shtypës të popullit"*.

"Shqipëria e Lirë" e Çekrezit u paraqit si qeveri në mërgim, në mbrojtje të të drejtave të Shqipërisë, deri kur populli shqiptar të zgjidhte lirisht qeverinë e vet, kohë kur ajo do të kthehej në *"parti politike me program liberal, demokratik e popullor"*.

As mbreti i mërguar, as "Vatra" e Faik Konicës dhe Fan Nolit nuk e pritën mirë nismën e Çekrezit dhe palët hynë në polemika që shkonin deri në fyerje personale. "Vatra" mbështeste një qeveri ekzili me Zogun në krye, Çekrezi e kundërshtonte. Profesor Kaba, mbi studimin e të cilit bazohet ky artikull, e gjen qëndrimin e Çekrezit egoist, por i vë në pah dy merita: si i pari lider shqiptar në emigracion që kërkon bashkëpunim me rezistencën në Shqipëri, dhe kritikën ndaj pretendimit të Zogut për të qenë përfaqësuesi absolut e legjitim i shqiptarëve.

“

Në përpjekjet e mia për të mbledhur tok dhe për të organizuar gjithë elementët kundërshtarë të regjimit, hyra në kontakt edhe me Grupin Komunist të Shqipërisë

Konstandin Çekrezi

”



Gjatë luftës, Çekrezi bëri ç'mundi për njohjen e një qeverie shqiptare në emigracion nga aleatët, për ringritjen e shtetit të pavarur shqiptar pas mbarimit të luftës, dhe mbrojtjen e vendit nga pretendimet greke, duke bashkëpunuar për këtë me Departamentin e Shtetit. Por, duke qenë se premtimin e dhënë shqiptarëve të emigracionit, se aleatët do ta pranonin Shqipërinë në Kombet e Bashkuara, nuk e mbajti dot, më 1943 ai bëri një tërheqje taktike. Ra dakord për marrëveshje mes “Shqipërisë së Lirë” dhe “Vatrës” për të krijuar një Komitet Kombëtar me funksionet e një qeverie në emigracion, që mund të drejtohej nga Zogu me mandat vetëm për kohën e luftës, e formë regjimi që do të vendosej nga populli pas luftës, për çka binte dakord edhe Noli.

Kaba gjykon se Noli ishte më i moderuar dhe më elastik se Çekrezi që ushqente ambicie për të qenë ai në krye të qeverisë shqiptare në mërgim. Ndërkohë që grupimet e Nolit, Zogut e Çekrezit flisnin për ujdinë, në Shqipëri ishte mbajtur Kongresi i Përmetit, për të cilin Çekrezi mori dijeni dhe madje kërkoi njohjen e saj nga Departamenti i Shtetit. Duke qenë se kjo iu refuzua, më 2 nëntor 1944 Çekrezi i drejtoi Presidentit Ruzvelt një telegram me shumë ankesa e fajësime për qëndrimin e mbajtur nga Aleatët e Mëdhenj në përgjithësi dhe në veçanti, nga qeveria amerikane ndaj çështjes shqiptare. Ai shprehej se Amerika nuk kishte njohur qeverinë e dalë nga Kongresi i Përmetit, për shkak se ajo dominohej nga një bërthamë komuniste, por nuk kishte pranuar të njihje as një qeveri të krijuar në mërgim. Një ditë më pas, ai mori përgjigje nga Departamenti i Shtetit, ku dukej se kishte oficerë që ndanin të njëjtin shqetësim.

Vetë Çekrezi i analizonte mirë forcat politike e ushtarake në Shqipëri gjatë LDB. Për të, Balli Kombëtar, ku gjeje bejlerë e fshatarë që bënin sikur bashkëpunonin me italianët, por edhe i sabotonin, nuk ishte një parti homogjene. Ai mendon se Balli e humbi luftën se “nuk mundi ose nuk diti ta bëjë popullin shqiptar për vete”.

Ndonëse i kishte të qarta të metat e Ballit, ish-studenti i Harvardit nuk u pajtua me vendosjen e regjimit komunist në Shqipëri dhe marrëdhëniet që qeveria shqiptare ndërtoi me SHBA-në dhe Perëndimin. Ai u nda nga organizata “Shqipëria e Lirë” në maj 1945, duke dhënë dorëheqjen e pas kësaj periudhe, deri në vdekje, mbajti qëndrim kritik ndaj saj, “Vatrës”, Nolit dhe kujtdo tjetër që mbështeste qeverinë e Tiranës. Formimi i tij si liberaldemokrat nuk e lejonte Çekrezin të pajtohej me realitetin komunist të Shqipërisë dhe me mbështetjen që iu dha asaj nga “Shqipëria e Lirë”, “Vatra” dhe Noli.

Duke qenë se vërejtjet e tij kundër mbështetjes së qeverisë së gjeneral Hoxhës nuk u dëgjuan, për të “Shqipëria e Lirë” u bë një agjenci e thjeshtë propagandistike e qeverisë së Tiranës. Ai që gjatë luftës kishte kërkuar bashkëpunimin e shqiptarëve të emigracionit me ata të rezistencës në luftë, ai që kishte njohur pa hezitim qeverinë e dalë nga lufta, tashmë iu kishte kthyer krahët fitimtarëve. Studimi i Kabës e gjen arsyen të marrëdhëniet jo të mira të qeverisë komuniste me SHBA-në dhe Britaninë e Madhe, tek e ardhmja e vendit të tij të lindjes larg modelit perëndimor, që ai kishte mbrojtur gjatë gjithë jetës së tij. Sidomos dhuna e përdorur për vendosjen e regjimit të ri duket se e shpjegon metamorfozën e Çekrezit.

“Vendi ynë u lirua nga pushtimi i huaj për të hyrë në zgjedhën e një ideologjie të huaj”, thotë Çekrezi te “Plani i tretë për copëtimin e Shqipërisë”, ku vë në dukje edhe karakteristikat e regjimit të ri, duke përshkruar ngjarjet e 27 nëntorit 1944: “Në atë datë të paharrueshme...Tirana jepte pamjen e një kasaphane të tmerrshme, në të cilën gjaku i ushtarëve gjermanë u trazua me gjakun e kundërshtarëve shqiptarë të Komitetit Nacional të Çlirimit, ballistë, zogistë, liberalë, fajtorë ose të pafajshëm. Të ndezur nga lufta dhe të etur për hakmarrje, partizanët u vërsulën nëpër kafene dhe vendet e tjera publike dhe private, për të vrarë çdo njeri që ishte shënuar

INFORMATA MBI REAKSIONIN SHQIPTAR NE AMERIKE

Ne sa mendojme ate shikimet. Çekrezi pò mundohet te hyje sereeri ndehesjeje te Shqiptarve t,amerikes.Dhe ne Kerisio ai shikone mire,Se deri qe Kerimi vjen ne Washinton,ata shikojne bashke ne Dept. te Shtetit.Aty thuhet se mbajne lidhje ne nje faze James Charles,i cili shente ne Sekretionin per Ballkanin.James ka qene ne Fier Shqiperi ne 1934 dhe flet Jugosllavicht mire.

Çekrezi banon ne Afersi te Washiktonit dhe nuk ka ndò nje puna legale.-

Najere nga nje raport nga 396. Nr.62-5046 dat. 04-5-948.-

Informata për Çekrezin nxjerrë nga dosja për të

INFORMAT MBI TE ARRATSHURIT SHQIPTARE JAS

Thomas Stofani, Frank Çekrezi, Hafat Frier
Panojne ne Departamentin e Shtetit Ameri

----- 0 -----

Exjere nga informata Nr.15 date 31 Maj 19

45 68

Model Nr. 7
TEPER SEKKET

KERKESE

Seksionit Evidencës Operative
Pranë Drejtoris Zbulimit Publik M. P. M.

Lutemi kontrolloni si pas evidencave:

Mbiemri Çekrezi
Emri Frank
Atësitia Nastor
Dat Lindia 1891 Kombësija Shqiptare nënshtrësitia Shqiptare
Vend lindia Katunat, Fier
Në cilët shtete ka jetuar më parë dhe ku ndodhet në kohën e tashme Si qytet i shtetit në Fier, Shqipëri dhe ka ikur më 13-feb 1931 në

Kryetari i Degës _____ Drejtoris _____
Stefan Lekaj (Ministër) _____
Grada _____ firma _____

Emri, mbiemri dhe Nr. i telefonit të buntorit operativ _____

INFORMATA MBI AGJENTAT E DEPARTAMENTIT TE SHQIPTAR

Jane interpretuar me gjeje =Shtetet Shqiptare qe qe mberbejne ne Dept. e Shtetit dhe deri tashmi rezultojne ppor jo me siguri/ai tistatit keta elementat

- 1- Kostadin Çekrezi Washikton
- 2- Qerim Panariti ne Vatra, Soton
- 3- Stefan Lekaj dhe i Vella j " " " " " " " "
- 4- Lluji Prifti Kryetar i Kom. te Jergani.
- 5- Heli Dindari " " " " " " " "


Te larte përmendurit nuk dihet se çfare relatesh te rregullta dhe te pa rregullta mbajne ne detyr. Venue jane pure vanderisakt ne kontakte me elenat te Qeveris. Sic shifet, nje pjesë e tyre kane qene vend ne par org. e ndryshme te Shqiptarve t, Amerikes dhe qe keteje /pervec punes infór- aktive qe mund te bejne ku direkt dhe ku indirekt bene pròpogande e hapin parulla kunder Shqiperise. Si p.sh. fain e maredenjeve te keqija mndis Shqiperise dhe Amerikes ja hedhin Shqiperise etj.

Per neve ne i rresikimi tashmi paraqitet Qerim Panariti, abasi ai ka sene pòrite ne Vatra. Dhe bile Qerimi ne qe u grind ne delegacionin t, dhe per punen e Komitetit te ndihmave, jesh ne nje nga Nr. e fundit te shkrimit rreth punes ne "Brigadeve Kulturale" ne Shqiperi, ai edhe rreth shvillimit te procesit ne Shqiptar Bejers.

Per sa i perket Kosta Çekrezi, ai qendron gjithen Ketu ne Washik- tone. Ëire pò para dize ditesh sakoi ne New-Yòr dhe u taina ne delegaciont Atij delegacioni i u ufaq hapazi ai i derguarë i Dept. te shtetit dhe e ftdi qe te vinte ne Washikton, per te more kontakt me ndonje nga zyrtarat e Dept. e per te bleduar rreth maredenjeve diplomantike te Shqiperise ne Ameriken. Pòr delegacioni i tha te shodim. Nga tjetor i sakoi Ministrive dhe nuk dihet se i arazi ndò nje pergjigje rreth rreth çastje dhe jò.

Report për Kostë Çekrezin ku cilësohet agjent i Departamentit të Shtetit

Kërkesë e Sigurimit për figurën e Çekrezit




Qemal Panariti i shkruan
Enver Hoxhës për një letër
të Kostë Çekrezit

që më parë si “armik i popullit”... për t’u bërë shembull për të gjithë kundërshtarët e regjimit të ri”. Sipas tij, “diktaturat ideologjike, qofshin fashiste, naziste ose komuniste, veshin rrobat e idealizmit për t’ia arritur qëllimit të tyre më me efektivitet”.

Më 1951, Sigurimi i Shtetit i çel dosjen e Konstandin Çekrezit në kategorinë II-A, me pseudonimin ‘Tomas’, si ‘agjent amerikan që paraqet rrezikshmëri për interesat e vendit tonë’. Vetë ai, ndër shqetësimet më të mëdha kishte nënën plakë në Ziçisht të Devollit, me të cilën e kishte gati të pamundur të komunikonte.

Studiuesi Kaba i vesh atij pikëpamje socialdemokrate. Kur më 1959 u nda nga jeta, Noli në ceremoninë e varrimit tha për Çekrezin se “vdiq fukara një burrë i madh i Shqipërisë”. Vetë Çekrezit la pas shumëçka të shkruar, si një lloj testamenti politik e ideologjik, pasi kishte këshilluar se “duke marrë pendën në dorë që t’i shkruajmë ndonjë njeriu, pikë së pari duhet të mendojmë që ato që do të shkruajmë, do të mbeten përjetë”.

Tajar Zavalani



Komunisti i zhgënjyer nga stalinizmi

Në fillim të viteve '30, ai filloi të dyshonte te politika staliniste për kolektivizimin e bujqësisë, si rezultat i së cilës pati miliona fshatarë të vdekur nga zia e bukës, të syrgjynosur në Siberi e të dënuar në gjyqet kundër kulakëve. Por ajo që mund të ketë shënuar ndarjen përfundimtare me besimin hirplotë të një jete të re pas revolucionit, mund të ketë qenë eliminimi i vëllait të tij, Hysenit.

Madhështitë e veprave letrare si të tilla, kanë ngërthyer shpesh keqazi stilet tërheqëse, subjektet dhe zgjidhjet autoriale, me kohët e vendet kur u shkruan, duke i bërë lexuesit jo rrallë, të mahnitën prej veprave, sa zor se mund të shquanin mes linjave e rreshtave, euforitë e trillet letrare, atmosferën e përcjellë e ndodhitë reale me dëshirat e mundshme. Ky 'mëkat' i letërsisë ndodh të ushqejë dashuri të pajustificueshme të ndërtuara mbi pritshmëri, më shumë se sa mbi logjika të shëndosha. Gjithsesi, letërsia nuk mban përgjegjësi për të ardhmen e asaj që duket si premtim i mundshëm. Megjithëkëtë, lexuesi i stërvitur, Tajar Zavalani, në të tridhjetat e tij, zor se është magjepsur nga "Nëna" e Gorkit gjatë përkthimit në shekullin që pat moshën e tij, sa për të rënë në rrjetën e ideologjisë bolshevike, që ato kohë, kishte rizgjuar perandorinë nën tise revolucionare, por pa i liruuar të shtypurit. Zavalani kishte lindur më 1903 e që në moshën 10-vjeçare, kishte kërkuar si edhe Gorki, lirinë për të shtypurit, çka dëshmohet nga një bisedë me të atin, nacionalistin Fehim Zavalani, të cilit i thoshte "*se, nuk ishte e drejtë që pjesa më e madhe e prodhimeve shkonin në hambarin e tij, e jo të atyre që kishin derdhur djersën duke punuar...*"

Pas mësimëve në shkollën katolike franceze 'Marist Brothers' në Manastir të Maqedonisë së Veriut, ai kishte ndjekur studimet në degën e letërsisë në shkollën franceze të Selanikut. Më 1922, niste punë në Ministrinë e Jashtme në Tiranë, si sekretar i Komisionit Shqiptar për Përcaktimin e Kufijve. Sipas studimit të Hamit Kabës, mbi të cilin bazohet ky artikull, më 1924, 21-vjeçari Tajar Zavalani, ishte pjesë e 'Bashkimit', një shoqatë politike, shoqërore e kulturore me prije të majta marksiste dhe jomarksiste, së bashku me personalitete të tjera të njohura si Avni Rustemi, Zai Fundo, Reshat Këlliçi, çka mund të ketë shënuar edhe takimin e tij të parë me komunizmin. Është në kryeqytet gjatë revolucionit të qershorit që ai e quan kryengritje të armatosur dhe fund të bashkimit të shenjtë. "*Mendimet u ndanë, - ka shkruar ai, - kur erdhi puna me ç'dukë gjurmët e sundimit osman*


dhe me e kthye Shqipërinë në një shtet modern, mbas modelit perëndimor”. Zavalani mbështeti grupin e radikalëve të majtë, si e cilëson ai grupimin e udhëhequr nga Noli, të cilët synonin që spastrimin me themel të sistemit administrativ, ekonomik dhe shoqëror trashëguar nga Perandoria Osmane. Masat kryesore të këtij grupimi qenë reforma agrare, ndarja e fesë nga shteti, ndërtimi i shkollave, mësimet universitare etj. Dështimin e kësaj ngjarjeje ai e lidh me shumë faktorë, ndërsa vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Bashkimin Sovjetik, e sheh si hap tërësisht të gabuar e me pasoja.

Me dështimin e lëvizjes së qershorit, Zavalani, si shumë mbështetës të Nolit, mërgoi si emigrant politik, fillimisht në Romë dhe pas saj, gati 8 vjet në Bashkimin Sovjetik me 20 moshatarë. Në një autobiografi që njihet si “*Ditar*”, duke pohuar dëshirën për të shkuar në BS dhe idetë e zbehta mbi komunizmin, sqaron se ambicia e tij ishin së pari, studimet e larta. Mësoi gjuhën ruse dhe për 3 vjet ndoqi Shkollën Marksiste-Leniniste në Leningrad. Hamit Kaba vëren se Zavalani në ato vite nuk e kishte vënë në dyshim filozofinë bolshevike dhe praktikën staliniste të ndërtimit të shtetit komunist, përkundrazi, Zavalani shkruante se ‘*kënaqësia ime më e madhe intelektuale ka qenë se, gjeta përgjigjen në pyetjen që më kishte munduar prej kohësh, e ajo është: Çka e bën shoqërinë njerëzore që të ecë përpara dhe të përparojë?*’ Më pak se 10 vite më vonë, ai do të zbulonte se përgjigja e gjetur që kryekëput gabim, por kishte ende kohë.

Më 28 gusht 1927, Zavalani, Zai Fundo, Sejfulla Malëshova, Riza Dani e studentë të tjerë shqiptarë që vazhdonin studimet në ‘djepin’ e komunizmit, u pranuan anëtarë të Partisë Komuniste Bolshevike dhe formuan Grupin Komunist Shqiptar në Bashkimin Sovjetik. “*Kominterni, - kujton Zavalani, - donte që të shkoja në Shqipëri dhe të punoja ilegalisht, por unë refuzova*”. Ai nuk ndjek këshillën për t’u kthyer në atdhe por krijon një komision të përkohshëm, që do të merrej me punën përgatitore për formimin e një partie komuniste në Shqipëri dhe përkthen “*Manifestin Komunist*” të Marksit. Më 1929 ai gjendet specialist në Institutin e Bujqësisë në Moskë, ndërsa më 1930 me urdhër të Kominternit, i atashohet grupit të komunistëve shqiptarë pranë KONARE-s në Berlin, që drejtohej nga Fan Noli. Vetë KONARE, kishte divergjencja të forta me dy platforma dhe grupime, ‘çlirimistët’ që mendonin se në Shqipëri duhej të vendosej një regjim demokratik përparimtar dhe ‘bolshevikët’, që gjykonin se duhej kryer revolucionin socialist, nën shembullin e Revolucionit të Tetorit. Atëkohë, Zavalani ishte me të dytët, por vetëm një vit më pas, duke filluar që më 1931, ai, Lazar Fundo dhe disa komunistë të tjerë, i ndryshuan pikëpamjet e tyre për një revolucion të asisojtë në Shqipëri. Dhe arsyet do të dalin një e nga një. Të ketë qenë ajo që panë në Moskë a dëgjuar për periferitë e largëta?

Tajar Zavalani u kthye në Shqipëri në fillim të vitit 1933, pas qëndrimit për pak kohë tek familja e tij në Selanik. Me ndihmën e Mehmet Konicës filloi punë si drejtor i Zyrës së Statistikës. “*Në këtë periudhë - ka shkruar Zavalani në autobiografinë e vet, - fillova t’i kontribuoj shtypit ‘legal’ dhe kjo nxori në sipërfaqe për herë të parë mospajtimin tim me llojin e komunizmit sovjetik*”. “*Sidoqoftë, - shton ai më tej, - u jam përmbajtur ideve të mija revolucionare*”. Ishte kjo koha, kur i kushtoi kujdes sjelljes në shqip të përkthimeve nga letërsia botërore. Nga ‘Ana Karenina’ e Tolstoit, ‘Sonata’ e Krojcerit, ‘Nëna’ e Gorkit, ‘Ishulli i thesarit’ i Stivensonit, ‘Tartari i Taraskonit’ i Dodesë, ‘Gobseku’ i Balzakut dhe ‘Dama me kamelië’ i Dymasë. Fundi i viteve ’30 shënon ndarjen përfundimtare të Tajar Zavalanit me idetë komuniste. Braktisja e komunizmit sovjetik erdhi në mënyrë graduale. Në autobiografinë e vet, Zavalani ka përmendur se, në fillim të viteve ’30 ai filloi të dyshojë tek politika staliniste për kolektivizimin e bujqësisë, si rezultat i së cilës pati miliona fshatarë të vdekur nga zija e bukës, të syrgjynosur në Siberi e të dënuar në gjyqet kundër kulakëve. Spastrimet, vrasjet dhe dënimet e ashpra në ushtrinë e kuqe, po ashtu morën jetë. Por ajo që mundet të ketë shënuar ndarjen përfundimtare me besimin hirplotë të një jete të re pas revolucionit, mund të ketë qenë eliminimi i vëllait të tij Hysenit; po në këtë vazhdë, në “*Ditar*” ai përmend edhe sulmin e Bashkimit Sovjetik mbi Finlandën më 1940 që bashkë me humbjen e vëllait, i ‘hapën sytë’ dhe e larguan atë përfundimisht nga komunizmi bolshevik sovjetik.

Me pushtimin e Shqipërisë, Zavalani që po ndahej nga komunizmi, shfaqet si nacionalist antifashist dhe socialdemokrat. Më 1939 ai u internua në Italinë e Veriut si veprimtar kundër italianëve. Me ndihmën e Ernest Koliqit dhe mbështetjen financiare të po atij, u lirua nga internimi dhe me të shoqen shkoi në Zvicër. Pas një qëndrimi të shkurtër, Zavalani, mbërrin në Paris, ku për herë të parë, bie në kontakt me Mbretin



Zog, siç e pranon vetë. Me rënien e Francës në duart e nazistëve, Zavalani vendoset në Londër. Prej 1940-ës e deri në vdekjen e vet, punoi në BBC (The British Broadcasting Corporation) në seksionin e gjuhës shqipe. Historiani Hamit Kaba shënon se gjatë Luftës së Dytë Botërore tek profili i Tajar Zavalanit skicohen më qartë karakteristikat e një nacionalisti antifashist dhe të një socialdemokrati, aktiv në emigracionin shqiptar në Angli e Amerikë, me vizion të qartë për zhvillimin e ardhshëm të Shqipërisë në rrugën e demokracisë perëndimore. Burime arkivore britanike e amerikane tregojnë përpjekjet që ai bën për ta njohur e pranuar zyrtarisht Shqipërinë në Kombet e Bashkuara Antifashiste, njohjen e rezistencës dhe kontributin e popullit shqiptar në favor të kauzës antifashiste. Zavalani bëri përpjekje që të bashkëpunonte me mbretin Zog, duke ofruar si rrugëzgjdhje krijimin e një Komiteti Kombëtar apo një Fronti të Përbashkët kundër rrezikut fashist e nazist. Sipas Kabës, kjo do të ishte një marrëveshje pragmatike e detyrueshme për të fuqizuar rezistencën shqiptare kundër ushtrive të Boshtit, ndonëse Zavalani nuk mbështeste restaurimin e monarkisë zogiste në Shqipërinë e pasluftës. “Zogu, - ka shkruar Zavalani në “Ditarin” e tij autobiografik, - nuk mund të jetë ideali për të cilin duhet të luftojnë e të vriten shqiptarët”, ndërsa flet për një model që nënkupton “një demokraci e vërtetë, ku sovraniteti i popullit të jetë një realitet e jo një kallëp i gënjeshtër sa për të rrejtur botën”. Megjithëse e nxiti dhe e mbështeti frymën e bashkëpunimit dhe afrimit të korrenteve të ndara e të përçara në emigracion, përpjekjet e Zavalanit nuk patën sukses. Shqiptarët si jashtë, ashtu edhe brenda vendit vazhduan të mbeteshin të ndarë.

Hamit Kaba ka gjetur të dhëna se Tajar Zavalani si askush shqiptar tjetër në emigracion u përpoq të bëjë të njohur rezistencën shqiptare kundër pushtimit italian e gjerman, si në Londër edhe në Uashington. Detyra e gazetarit të BBC e ndihmonte në këtë rol. Ai ka zhvilluar disa takime zyrtare e jo zyrtare me diplomatë të FO dhe të tjerë të interesuar për Shqipërinë gjatë luftës. Në këtë vazhdë, në dhjetor 1943, Zavalani shkroi pamfletin me titull ‘Albania Under Nazi Oppression’, i cili u botua nga Zyra e Londrës e Organizatës ‘Shqipëria e Lirë’. Ai vlerëson katër anëtarët e Regjencës, duke filluar me Mehdi Frashërin, Lef Nosin, Patër Anton Harapin dhe Fuad Dibrën për patriotizmin dhe ndershmërinë e tyre. Asnjëri syresh, nuk pranoi fillimisht të merrte përsipër detyrën e regjentit, por ajo u bë e mundur pas ndërhyrjes së fortë të Xhafer Devës.

Zavalani u tregua entuziast kur mësoi se në tetor 1944 në Shqipëri do të zbarkonin trupat komando britanike, ngase shpresonte se me mbështetjen e tyre, Shqipëria do të ndiqte rrugën e demokracive perëndimore. Por Shqipëria, mori rrugën që Zavalani kishte braktisur, atë të komunizmit. Paslufte, ndërsa punonte në BBC,

“

**Paragjykimeve dhe
koncepteve të gabuara të
së kaluarës po iu shtohet
tani edhe efekti i keq
i veprave stupide dhe
kriminale të komunistëve**

Tajar Zavalani

”



nuk u pajtua kurrë me sistemin komunist as formën shqiptare të tij, madje mbajti qëndrim të ashpër. Për t'i shërbyer qëllimeve antikomuniste u anëtarësua në 'Pen Club' (klub i shkrimtarëve antikomunistë të Evropës), në gazetën e të cilit shkroi disa artikuj kundër komunizmit. Po me këtë qëllim, më 1951, Zavalani botoi në Londër librin e tij të parë, "How Strong is Russia", që të zgjonte botën nga 'qëllimet e mira të Stalinit me shokë'. Për Kabën, periudha disavejeçare e qëndrimit të tij në 'Mekën' e komunizmit botëror, njohuritë teorike të fituara në shkollën marksiste-leniniste, eksperiencia në Institutin e Studimeve Agrare në Moskë dhe praktika staliniste e viteve '30, bënë që Tajar Zavalani të shkruante një libër të veçantë e të mirëpritur për lexuesin. Qëndrimi i tij në Rusi kishte përkuar me një nga periudhat më të rëndësishme të historisë së Bashkimit Sovjetik, pikërisht në kohën kur po formatohej modeli sovjetik i zhvillimit të këtij shteti të madh. Gjatë viteve '30 kishte nisur procesi i kolektivizimit të bujqësisë dhe industrializimit të ekonomisë. Ai e dinte mirë se prodhimi bujqësor dhe blegtoral kishin pësuar rënie, e dinte po ashtu mirë se miliona fshatarë vdiqën nga zija e bukës, nga dënimet me vdekje, apo nga internimet famëkeqe në Siberi. Zavalani qe përpjekur të nxjerrë BS nga mjegulla e propagandës, me të cilën shfaqte veten udhëheqja moskovite. Dhe ndërsa bota besonte se imazhi i Bashkimit Sovjetik ishte i pasfidueshëm, një shqiptar si Zavalani, i tregonte botës atë që nuk shihet, dhe atë që vetë nuk kishte parë, kur kishte besuar në atë sistem. Kjo ishte thyerja e botës, por ishte më herët thyerja e tij.

Megjithëkëtë, libri më me vlerë i Zavalanit, mbetet "Historia e Shqipërisë" që pat nisur të shkruhej gjatë luftës, e që do të përfundohej kur autori ishte në moshë të pjekur. Sipas Kabës, ai libër, reflekton mendimin final të Zavalanit për Shqipërinë. Kaba arrin në përfundimin se pikëpamjet politike të Tajar Zavalanit në periudhën e pasluftës kanë evoluar drejt një demokraci liberal dhe antikomunisti të pakompromis. Ai është tejet kritik me regjimin stalinist të Shqipërisë dhe të shkuarën e komunistëve shqiptarë. Nëse krahasohen gjykimet e tij autentike të pasqyruara tek "Ditari" (1942-1944) për periudhën e luftës, me ato çka shkruan tek "Historia e Shqipërisë", thotë Kaba, vihen re, jo thjesht reflektime, por përmbysje. Gjykimet e Zavalanit ndaj komunistëve shqiptarë, të kthyer nga emigracioni në vitet '30-'40 janë nga më të ashprat, ndonëse nuk e përmend veten e tij. Megjithëkëtë, Zavalani ka koncepte të qarta për demokracinë parlamentare, republikën autoritare, monarkinë parlamentare, diktaturën fashiste e komuniste. Mendimi i tij politik e tregon nacionalist të pastër. Internacionalizmi i viteve '30, përqaftimi i idesë për krijimin e një Federate Ballkanike ku do të përfshihej edhe Shqipëria është zhdukur në periudhën e pasluftës.

Zavalani që kishte qenë i pakënaqur me gjendjen e prapambetur të Shqipërisë dhe me qeverisjen e Zogut, modelin tjetër fillimisht e kërkoi në Moskë tek komunizmi sovjetik. Kur gradualisht u zhgënjye prej tij, ai përqaftoi idetë socialdemokrate të mishëruara tek Demokracitë Perëndimore. Kaba beson se është vështirë të gjendet një person tjetër i ngjashëm me Tajar Zavalanin, që të jetë endur aq gjatë sa ai, në kërkim të modelit më të mirë për të ardhmen e vendit të vet. Është njëherit po aq e vështirë të gjendet dikush tjetër si ai, që të ketë pësuar një metamorfozë të vërtetë të bindjeve të tij politike. Përkthyesi i 'Manifestit komunist', u shndërrua në një denoncues të komunizmit që u vendos në Shqipëri dhe në tërë Lindjen.

Ai kish mundur të pajtohej me ata që mendonin ndryshe dhe kish mundur të riformulonte bindjet e besimet kur kishte parë idhujt e rremë. Jeta e Zavalanit u shoqërua me thyerje të mëdha: nisi si i ri me pikëpamje të majta, për t'u bërë komunist në Bashkimin Sovjetik; u kthye në Shqipëri dhe u largua gradualisht nga komunizmi bolshevik pas zhgënjimeve që pësoi prej tij; u transformua në socialdemokrat gjatë Luftës së Dytë Botërore, për t'u shndërruar në antikomunist pas mbarimit të saj. Edhe në fushën e besimit jeta e T. Zavalanit pati ndryshime drastike. Lindi në një familje të besimit mysliman të ritit Bektashi, u shndërrua në një komunist ateist, për t'u konvertuar në vitin 1958 në katolik, me emrin e ri, Thomas-Henry Zavalani. Pavarësisht nga 'galopet' në jetën e tij, në personalitetin e Tajar Zavalanit spikasin dy veti thelbësore: kultura e gjerë dhe atdhetaria.

Zavalani nuk mundi të kthehej kurrë më në Shqipëri pas luftës. Vdiq mëngjesin e 19 gushtit të vitit 1966 në Londër. Për shkakun e vdekjes, ka dy versione. Versioni i parë është ai i një ataku kardiak, ndërsa i dyti, ai i një aksidenti automobilistik. Në Shqipërinë komuniste emri i tij pothuajse nuk u përmend. Gruaja e tij Selma Zavalani vazhdoi të angazhohej në organizatën 'Shqipëria e Lirë'.

Musine Kokalari



Musine Kokalari, alternativa e humbur socialdemokrate

Shkrimtarja që kërkoi reformë agrare, sistem sigurimi shoqëror, liri politike e pluralizëm, drejtësi shoqërore, e shkolluara në Romë, bija e një familjeje emërmadhe, motra e dy vëllezërve të pushkatuar, u dergj në një qytezë. Ajo që kishte mbështetur idenë e një konfederate ballkanike, u pa si rrezik për monopolin e pushtetit komunist.

Me gjyshin teolog të Islamit dhe babanë të diplomuar në drejtësi, Musine Kokalari erdhi në jetë në Adana të Turqisë Jugore, në një familje intelektualësh gjirokastritë. Motra e tre vëllezërve, Mumtazit, Vesimit dhe Hamitit, të tre më pas të shkolluar në drejtësi e frëngjisht. Vetëm tri vjeçe, më 1921, ajo kthehet në Shqipëri dhe Kokalarët vendosen në Gjirokastrë, ku Musineja merr mësimet e para. Më 1930 familja vjen në Tiranë, ku Vesimi hap një librari që bëhet pikë referimi në kryeqytetin e ri. Ajo ndjek studimet në Institutit Femëror në Tiranë, që në vitet '30 shënonte hapat e parë të modernizimit të botës shqiptare. Musineja nis të botojë në shtypin e kohës skica letrare, ku vë në pah plagët shoqërore, varfërinë, diskriminimin, analfabetizmin dhe problemet e gruas së kohës, që trajtohej si skllave.

Ndonëse mbetet pak e amullt se cilës rrymë i përkiste ato vite, në kujtimet e shkruara më 1972 nën titullin "Si lindi Partia Social-Demokrate", Musineja vë në pah konfliktin mes brezave në jetën politike të viteve 1930. Pozicionimi i saj tek idetë e një përparimi të shpejtë që perceptuar si kontradiktë me elitën e vjetër të shkolluar në Turqi, që bartte nostalgji ndaj privilegjeve. Përtej ideve të filozofit Ismet Toto e neoshqiptarizmit të Branko Merxhanit, në formimin e saj ndikoi fort familja. Dy vëllezërit e Musinesë qenë pjesë e organizatës së Vlorës më 1932 për rrëzimin e monarkisë dhe vendosjen e një sistemi republikan qeverisjeje. Shumë prej pjesëtarëve të organizatës u arrestuan, përfshi vëllanë e saj, Vesimin. Gjatë takimeve me të në burg, ajo njohu rrethin intelektual të kohës, me të cilët më vonë do të themelonte Partinë Socialdemokrate. Sipas një studimi të Dorian Koçit, mbi hulumtimet

e të cilit bazohet ky artikull, njohja me ta shenjoj përfundimisht botëkuptimin e Musinesë, me ideale antif feudale, laike në kulturë e në marrëdhënie shoqërore, për progres shoqëror, për liri politike, barazi shoqërore e reformim ekonomik. Vetëdija e saj shpërfaqet edhe në letërsinë që shkroi atë kohë, me pseudonimet ‘Muza’ a ‘Tacita’.

Më 1937 ajo kish mbaruar Institutin Femëror dhe ishte nisur drejt Romës, ku mbaroi universitetin me temë diplome rilindasin Naim Frashëri, më 1941. Në Itali ka zbuluar veten dhe qytetërimin europian. Ka qenë atje ndërsa pritej pushtimi i Shqipërisë, është nisur me anijen e fundit në Bari dhe ka mbërritur më 6 prill. Të nesërmen, vendi i është dorëzuar Italisë. Te *“Jeta ime Universitare” (1940-1942)* shkruan *“arrita, në çastin kur qielli ishte mbuluar me aeroplanë italianë. Anëmbanë mbretëronte një gjendje shpirtërore që mundet lehtësisht të përfytyrohet. Në ato çaste ndjenjat më intime zgjohen dhe shpirti gjendet në një turbullirë të tmerrshme”*.

Nga burimet arkivore nuk rezulton që Musine Kokalari të ketë qenë pjesë e ndonjë organizimi fashist të rinisë shqiptare universitare. Duket se deri në fund të vitit 1941 ajo nuk është përfshirë në aktivitete politike të drejtpërdrejta, madje rrekej të gjente udhë letrare. Mikut të saj shkrimtar, Ali Asllani, do t’i rrëfente se *“Dua të shkruaj, të shkruaj e vetëm të shkruaj letërsi dhe të mos kem fare të bëj me politikë”*. Por lufta i trazoi ujërat. Intelektualët e populli u ndanë në kolaboracionistë, antifashistë, neutralë, mandej nacionalistë, *‘individë e bërthama me bindje republikane, monarkiste dhe komuniste’*.

Amullisë së parë ia la vendin një polarizim i skajshëm. Rezistenca kishte në një anë të “rinjtë” komunistë me asistencë sllave dhe të “vjetrit” nacionalistë me “Ballin Kombëtar” e pikëpamje republikane e reformatore. Ngase mbreti Zog nuk kishte lejuar formimin e partive, Shqipëria u gjend pa traditë të përfaqësimit politik. Musineja vë kontakte me të dy krahët e rezistencës dhe bëhet pjesë e aksioneve antifashiste. Megjithatë, *“Musineja ishte tepër e kthjellët dhe kishte bindjen, që komunizmi dhe fashizmi s’kanë asnjë ndryshim midis tyre, përdërisa dhe vrasin njeriun ..”*, do të kujtonte shoqja e saj Selfixhe Ciu. Fytyra e Musinesë në oborrin e burgut ku gjendet Selfixhja, tronditet e në sy i shihet dhembja kur përballet me dhjetëra vajza të reja të arrestuara.

Hyrja e saj në rezistencë shënon risi në përfshirjen e grave të shkolluara në luftë. Ajo ngërthente trashëgiminë politike të Shqipërisë me parimet e demokracisë liberale të Britanisë së Madhe dhe Francës. Te kujtimet e saj flet qartë për idetë tradicionale të zhvillimit të Shqipërisë dhe idealet e së majtës ekstreme, kur thotë se *“Revolucioni i Tëtorit pruri ideale të tjera revolucionare që hynin në Shqipëri dhe u formuan grupet komuniste, jo me shtrirje në shkallë kombëtare, por të kufizuara dhe me parime jo të qarta, as të njëjlojta”*.

Mes ndikimeve të Totos, Merxhanit, familjes e shkollës, formimi i saj intelektual kishte kaluar nëpër shkollën evolucioniste të mendimit politik shqiptar. Ndonëse shkollë e paafirmuar me ideologë të mirëfilltë, ajo bartte ide republikane e liberale që nga Rilindja Kombëtare e deri në vitet ’40. Përfaqësohej nga Sami Frashëri, gjuhëtar e filozof. Traktati i tij politik që bërë “bibla” e elitës liberale shqiptare. Ajo kish mbrojtur diplomën me të vëllanë e Samiut, ndërsa nipi i tij, Mit’hat Frashëri, pat ndërtuar në Tiranë një librari ku këto ide përhapeshin. *“Unë e kam njohur këtë ambient që në vogëli, – shkruan Musineja për Librarinë e Mit’hat Frashërit, ku qe takuar me intelektualë në zë, si Sotir Kolea, Aleksandër Xhuvani e Mati Logoreci. Kujtonte se qe “mbështetur në botëkuptimin e thellë iluminist dhe në reformizmin e parlamentarizmin që na e ushqeu Sami Frashëri që në bangat e shkollës”*. Në këtë librari, bashkë me Skënder Muçon, Isuf Luzajn dhe Selman Rizën themelon Partinë Socialdemokrate të Shqipërisë, si *“një alternativë evolucioniste dhe rrugë të mesme që të lidhte me të forcat e pakristalizuara, duke u radhitur në aleancë me Partinë Komuniste në Frontin Nacionalçlirimtar”*.

Megjithatë, Musineja është e qartë me kë është në aleancë. Më 1943 njihet me Nexhmije Xhuglinin (më vonë bashkëshortja e diktatorit Hoxha) dhe përfshihet në Organizatën e Gruas Antifashiste për Tiranën



Më 1921, Musineja u kthye me familjen në Shqipëri, ku nisi shkollën fillore në Gjirokastrë. Familja e saj u vendos në Tiranë, nëntë vjet pasi u rikthyen në atdhe. Musine Kokalari ishte nxënëse e Institutit Femëror në Tiranë, që në mesin e viteve '30 ishte fidanishte e modernitetit të botës shqiptare.

e në organet drejtuese. Pas dështimit të mbledhjes së Mukjes dhe acarimit të marrëdhënieve mes dy organizatave politike në Shqipëri, Musineja jep dorëheqjen nga ky pozicion. Në një letër që Xhunglini i shkruan Hoxhës më 22 shtator 1943, thotë se “Musineja me shoqe kërkon formimin e partisë social-demokrate, megjithëse është ‘apolitike”, - thotë në kujtimet e saj gruaja e diktatorit. Një ide e tillë pohohet nga kujtimet e Musinesë, që rrëfen t’i ketë thënë Nexhmijes “për të hyrë në gjirin e Frontit Nacionalçlirimtar, jo si individë të veçantë, por si grup demokratik ose më mirë si parti (socialdemokrate)”. Rreka e Musine Kokalari për të gjetur rrugën e mesme në rezistencën e armatosur ra në vesh të shurdhër, si nga përfaqësuesit e PKSH-së, ashtu dhe nga udhëheqësit e organizatës politike Balli Kombëtar. Por pushtimi kërkonte të luftohej, përtej dasive. Ndonëse mes programit të Ballit Kombëtar, të njohur si “Dekalogu” gjendeshin pika të përbashkëta me programin e Partisë Socialdemokrate, të hartuar nga Musine Kokalari dhe Isuf Luzaj, udhëheqësit e Ballit Kombëtar, Mit’hat Frashëri dhe Hasan Dosti, nuk e pranuan alternativën e krijimit të këtij formacioni të ri politik, me arsyen se do të përçahej organizata e tyre. Musineja me Luzajn e Muçon themeluan Partinë Socialdemokrate dhe nxorën gazetën e saj “Zëri i Lirisë”. Shtypi i LANÇ jep si datë themelimi tetorin e vitit 1943, ndonëse gazeta zyrtare e PSD-së doli më 1 janar 1944, me emrin “Zërit i Lirisë”. Në të shpallet programi i Partisë Socialdemokrate dhe ndonjë aspekt i statutit të saj (i pabotuar në këtë organ dhe që nuk ka arritur si dokument as në arkivat tona).

E vetëdijshme se fraksioni i saj politik nuk do të kishte sukses, ajo këmbëngul për botimin e gazetës, me rrogën e saj dhe me ndihma nga Skënder Muçoja, si një alternativë e mesme në konfliktin politik mes komunistëve e ballistëve, pas Mukjes. Duke pasur në mendje një qëllim largpamës, ajo shkruan se “i nxora ato gjashtë numra, vetëm me një qëllim: Qe përshkruar një rrugë, një program partie. Pas çlirimit, në qoftë se do të ishte Shqipëria demokratike, të mbështeteshim në atë rrugë dhe të vazhdonte”. Shkrimi me titull “Misioni i Partisë Sociademokrate” zbërthen programin e saj në dy etapa: e para “independenca dhe kufijtë etnikë, instalimi i një qeverie demokratike” dhe e dyta “vendosja e drejtësisë shoqërore”. Gazeta merret me sfidat e



Fotografia e klasës filllore, Musine Kokalari është në rreshtin e dytë, e katërta nga e djathta. Arkivi i Arjeta Kokalarit

socialdemokracisë, çështje të sindikalizmit, ndërsa në ballinë duket deviza “Drejtësi shoqërore dhe liri politike”. Komunistët e shohin Socialdemokraten si shtojcë a vijim të Ballit, pas diskreditimit të tij. Këmbëngulja e Musinesë për bashkim nuk dëgjohet, aq sa ajo zhgënjehet e shkruan se “krerët e Ballit nuk frymëzoheshin nga demokracia...”

Pas Operacionit të Dimrit, ku një pjesë e Ballit bashkëpunoi me gjermanët, alternativa socialdemokrate, paçka mbështetjes së intelektualëve në Tiranë e Vlorë u shpërbë, ndërsa komunistët kishin qeveri të përkohshme. Atëkohë, ajo nuk e nxori më gazetën, u mor vetëm me letërsi, duke e parë që çdo përpjekje qe e kotë. Botoi dy libra, “Sa u tunt jeta” dhe “Rreth Vatrës”.

Shkrimtarja socialdemokrate vihet në kontakt me anglezët në qershor 1945, si shumë opozitarë të tjerë antikomunistë, legalistë e të rezistencës, mes të cilëve, ish-ministri i Hoxhës, Gjergj Kokoshi, i përjashtuar nga Fronti. Ata u kërkonin Aleatëve, përmes një memorandumit që besohet se e shkroi Musineja, shtyrjen e zgjedhjeve të dhjetorit dhe pranimin e partive të tjera, pos Frontit me komunistët. Nën emrin Bashkimi Demokratik, memorandumit i tyre kërkonte qeverisje demokratike dhe respektim të të drejtave të njeriut, miqësi me shtetet demokratike e fqinje, zgjidhjen e problemit të Kosovës, respektimin e të drejtave të pakicave, luftimin e elementëve fashistë dhe kriminelëve e luftës, etj. Ai reflekton elemente të programit socialdemokrat, çka ofronte një rrymë të moderuar të së majtës shqiptare, që kërkonte evolucion të shoqërisë pa ndërmarrë masa ekstreme të sistemit komunist në Bashkimin Sovjetik.

“Filloi lufta e Tiranës, - kujton Musine Kokalari në librin e vet “Si lindi Partia Social-Demokrate” (1972). “Më 12 nëntor m’i morën dy vëllezër e shumë veta në laje i vranë ‘ushtarakët çlirimtarë’. Më 13 nëntor më arrestuan”. Ajo u lirua më 28 nëntor, e vetëdijshme se lirisë i kishte ardhur fundi. “Filloi tragjedia e individit demokrat, - shkruan ajo, - nën diktaturën e proletariatit. Kështu u mbyll epoka e Rilindjes dhe tendenca demokratike nga pozita humaniste që mbron popullin e thjeshtë, njeriun e punës për të shpëtuar nga skllavëria fizike



Filloi tragjedia e individit demokrat,
nënë diktaturën e proletariatit.

Kështu u mbyll epoka e Rilindjes dhe
tendenca demokratike nga pozita
humaniste që mbron popullin e thjeshtë”

Musine Kokalari

dhe shpirtërore dhe dinjitetin njerëzor. Hyri dhuna dhe gjakderdhja për të shfarosur demokracinë dhe gëzimi mizor për gjakderdhje, me forcë e mospërfillje”.

Zgjedhjet e 2 dhjetorit nuk u shtynë, duke i hapur rrugë instalimit të diktaturës. Komunistët nën Frontin, morën shumicën e vendeve në Asamblenë Kushtetuese, ndërsa amerikanët e britanikët i pranuan zgjedhjet. E vetmja opozitë ishte Bashkimi Demokrat, ndaj për të u morën masa të menjëhershme. 75 opozitarë u arrestuan, pothuajse të gjithë pjesë e Bashkimit Demokrat, duke filluar nga Gjergj Kokoshi, Musine Kokalari, Sami Çeribashi, Ali Kavaja, Qenan Dibra, etj. Kishin qenë prej kohësh nën survejimin e agjentëve të Mbrojtjes së Popullit. Deputetëve të opozitës iu bë gjyq në teatër. Pas një procesi hetimor të dhunshëm e të egër, të akuzuar si bashkëpunëtorë me kriminelët e luftës, 9 prej tyre morën dënim me vdekje, duke nisur vargun e gjatë të eliminimit të elitës.

Musine Kokalari qe arrestuar më 23 janar 1946. Akuza që i bëhet nga hetuesit partizanë ishte se si socialdemokrate solli përçarje gjatë luftës. Të njëjtën akuzë i patën bërë ballistët kur ajo i pat lajmëruar për formimin e Partisë Socialdemokrate. E mbajtën 17 ditë në burg. Qëndrimi i saj në gjyq ishte shuplakë ndaj regjimit dhe dëshmi e forcës morale që intelektualët po tregonin kundrejt totalitarizmit. Nuk mori avokat, u mbrojt vetë dhe njihet gjerësisht për shprehjen e famshme “Unë nuk kam nevojë të jem komuniste të dua vendin tim. Unë mendoj ndryshe nga ju, por unë e dua vendin tim. Ju jeni duke më ndëshkuar për idealet e mia!”.

Më 2 korrik të vitit 1946 Musineja dënohet me 20 vjet burg nga Gjykata Ushtarake e Tiranës, si sabotatore dhe armike e popullit. Nis për të kalvari i internimeve komuniste që do ta çonte nga Tirana, në Burrel, Shkodër e Rrëshen, deri në fund të jetës së saj. Në zvarritjet e saj nëpër burgje, u përball edhe me talljet e të pushtetshmëve që do të pësonin fatin e saj. Beqir Balluku (që do të pushkatohej për tradhti ndaj atdheut), ai që e kish arrestuar në nëntor 1944, më 1957, gjatë një inspektimi në burgun e Shkodrës, e pyeste: “Si vete,



**Sende personale të
Musine Kokalarit, ruhen
nga Bibika Kokalari**

socialdemokrate?”. Më 8 tetor të vitit 1961, Musineja u lirua nga burgju dhe u çua në internim në Rrëshen, ku vëzhgohej vazhdimisht nga Sigurimi i Shtetit, siç dëshmohet nga dosja e saj në arkivat e AIDSSH.

Shkrimtarja që kërkoi reformë agrare, sistem sigurimi shoqëror, liri politike e pluralizëm, drejtësi shoqërore, e shkolluara në Romë, bija e një familje emërmadhe, motra e dy vëllezërve të pushkatuar, u dergj në një qytezë. Ajo që kishte mbështetur idenë e një konfederate ballkanike, u pa si rrezik për monopolin e pushtetit komunist, sepse socialdemokratja ishte për jetë aktive parlamentare dhe ekzistencën e opozitës në jetën politike.

Musineja punoi fshesare 11 vjet në ndërmarrjen e ndërtimit në Rrëshen, mes tullave, llaçit dhe betonit. Kur i mbaroi internimi më 1979, i thanë të shkonte në Gjirokastrë. Meqë nuk e lanë të vinte në Tiranë, ajo qëndroi në Rrëshen. Po aty ndërroi jetë, më 13 gusht 1983, e pakuruar nga kanceri dhe e vetme. E varrosën varrmihësit. Nipi i saj Hektor Kokalari do të dëshmonte se kur, më 1991, shkoi ta zhvarroste në Rrëshen, i gjeti duart e saj të lidhura me tel. Rezistenca e saj morale dhe intelektuale ka lënë gjurmë të pashlyeshme në mendimin intelektual shqiptar, por trashëgimia e mendimit të saj teorik nuk u mor parasysh pas 1990-s. Partia që mban të njëjtin emër me të sajën, iu bashkëngjiti opozitës së djathtë shqiptare, edhe pse ideologjikisht ajo i përkiste spektrit të majtë. Eshtrat e saj sot prehen në Tiranë, ndërsa emrit të saj i referohen si shkrimtarja e politikania e parë shqiptare. Ajo ishte një grua e fortë, që nuk u përkul kurrë.

Isuf
Luzaj



Isuf Luzaj - filozofi dhe socialdemokrati

Në një promemorie të majit 1944 firmosur prej tij, Luzaj thotë se, po të ikin gjermanët, komunizmi do të sundojë në jug “me terrorin e kuq”, ndërsa veriun “do ta bëjë gjah për etjen e vet”. Paralajmëron spastrimin e intelektualëve e borgjezisë dhe “çdo shenje tjetër të qytetërimit, prej thikës së kuqe, nën censurën e drejtësisë së revolucionit proletar”.

I biri i një hoxhe vlonjat që më 1912 kishte bekuar pavarësinë e Shqipërisë, më 1936 kthehet nga Parisi ku kishte studiuar dhe ishte diplomuar në letërsi e filozofi në Sorbonë dhe ia beh në zyrën e ministrit të mbretit, duke kërkuar punë si profesor. Një biografi e shkurtër (që gjendet pranë Autoritetit të Dosjeve) hartuar ngaurvejuesit e tij gjatë regjimit komunist, e përshkruan “*të gjatë rreth 1.80, me fytyrë të hequr brune, flokë të zes të shtruar, sytë të zes, vetullat të zeza e të përziëra në mes, mjekër të gjatë, di me të folur edhe me të shkruarë gjuhën frëngjishte e italishte, njeri shumë i sguarë, i dhënë mbas gjuhës dhe letërsisë, njeri kapriços, gjakë nxehtë, njeri me kredi e autoritet*”.

Më 1937 i emëruar profesor i frëngjishtes në Normalen e Elbasanit, nis të bjerë në sy në qarqet intelektuale, por edhe në ato të pushtetit. Nga Elbasani e heqin sepse nuk pranon t'i puthë dorën Shefqet Bej Verlacit. Emërohet profesor frëngjishteje në Liceun e Korçës, ku ritakon mikun e hershëm Enver Hoxha, me të cilin filozofi qe njohur në Paris.

Njëherësh boton përmbledhjen poetike “Rrëfime” dhe, pa shitur 100 kopjet e para, i konfiskohet. Në zyrën e një tjetër ministri, tashmë të Brendshmit, poeti i ri 24-vjeçar mëson se poezia e tij “Neroni” është kuptuar si aludim që, pas perandorit famëkeq romak Neroni, fshihet figura e mbretit Zog. Ai e mohon, por lirohet vetëm pas 49 ditësh.

Pushtimi fashist e gjen në profesor në Shkollën Tregtare të Vlorës, ku kërkon që bashkë me 120 nxënësit e tij të reagonin me armë, por mungesa e armëve dhe e organizimit e bën të pamundur. Pak muaj më vonë, më 28 nëntor, kur fashistët organizojnë festime për përvjetorin e

Pavarësisë së Shqipërisë, profesorë e nxënës në qytetet kryesore të vendit e kthejnë festën në protestë. Isuf Luzaj, tashmë 26 vjeç, është duke kënduar himnin e flamurit pa liktor, përkrah 1000 të rinjve. Pushtuesit shpallin menjëherë një listë arrestimesh e, mes emrave më në zë, është edhe Luzaj. Arrestohet me pretekstin e vrasjes së një polici italian dhe, pas disa muajsh në burgun e Vlorës e Durrësit, e çojnë në Brindizi, që më vonë do ta kujtonte si burgun më të keq në jetë, mandej në Gaeta dhe në kampin e Ventotenes. Drejtuesit e kampit mësojnë për poezitë e tij kundër Luftës së Vlorës (italo-shqiptare më 1920) dhe e izolojnë në kështjellë. Ky izolim e njeh me Ali Këlcyrën, i cili para arrestimit kishte themeluar Ballin Kombëtar bashkë me Mit'hat Frashërin, Lef Nosin, etj. Me lule në duar, si populli i zonës, për të mos rënë në sy të karabinierëve italianë, Këlcyra dhe Luzaj shkonin në varrezat e kështjellës çdo të diel, për të bërë statutin e partisë. *“Në atë vend shkruam Dekalogun e Ballit Kombëtar. Ali Këlcyra fliste, unë shkruaja. Propozova që në Dekalog të hynte pika e shtatë: Organizata e Ballit Kombëtar do të zbulojë vlerat e vërteta, do t'i edukojë njerëzit, pa marrë parasysh besimin, krahinën ose partinë politike”*.


Pas tre vjetësh, më 1942, me ndërhyrjen e ministrit të Arsimit, Ernest Koliqi, Isuf Luzaj lirohet nga internimi dhe kthehet në Shqipëri, ku gjen të themeluar edhe Partinë Komuniste, e cila kishte organizuar një front lufte antifashist të drejtuar prej saj.

Tashmë edhe Balli Kombëtar shpall ekzistencën e tij dhe organizon çetat e armatosura në luftë kundër italianëve. Krahas të majtëve komunistë me në krye Hysni Lepenicën, socialdemokratët Isuf Luzaj e Skënder Muço luftojnë në zonën e Vlorës, ku më e njohura mes 5 betejave që përmend Luzaj është ajo e Selenicës, në prill 1943, që zgjati tri orë dhe la dhjetëra të vrarë nga armiqtë e disa robër lufte.

Ilir Kalemaj, mbi studimin e të cilit bazohet ky artikull, gjen kontribut të shumëfishtë të Luzajt te Balli. Si organizator i rezistencës antifashiste, si ideolog i parimeve të socialdemokracisë në programin prej 10 pikash të Ballit Kombëtar, njohur si *Dekalogu*, si themelues e komandant i çetave të Ballit në Vlorë dhe si një nga ngjizësit e idesë pankombëtare te kjo parti, *“mund të themi pa hezitim që Luzaj qe një nga pionerët e “shartimit” të idesë nacionaliste të bashkimit kombëtar me idetë socialdemokrate dhe të arritjes së barazisë klasore përmes metodave demokratike, çka e bënte njëherazi të ndryshëm me komunistët që predikonin rrugën revolucionare dhe luftën e klasave, por edhe sinkretik e origjinal në idetë e tij”*, nënvizon Kalemaj.

Pak muaj më vonë, Mbledhja e Mukjes në 2 gushtin e vitit 1943, që synonte të bashkërendonte luftën e komunistëve dhe ballistëve, nxori në pah përplasje mes dy partive për Kosovën. Ballistët kërkonin të luftohej që ajo t'i bashkohej Shqipërisë, ndërsa komunistët e ndikuar nga delegatët jugosllavë, kundërshtuan. Vetë Luzaj në atë mbledhje këmbënguli për bashkimin e trojeve, ndërsa të majtët pikasën te profesori i filozofisë një antikomunist të rrezikshëm për ta. Në një letër konfidenciale ku Ymer Dishnica i raportonte Enver Hoxhës për mbledhjen, shkruan se: *“Tenorët e diskutimeve qenë Skënderi me Isufin, i pari konsiliator dhe i dyti akuzator (me helm në bark karshi nesh – gjoja antizogist e demokrat”*.

Vjeshta e të njëjtit vit sjell kapitullimin e fashistëve dhe ardhjen e nazistëve. Ndërsa përplasje mes komunistëve dhe ballistëve shënoi kulmin, nga luftë e përbashkët kundër pushtuesve në të debatueshmen luftë civile, me sa duket, pasiviteti i Ballit Kombëtar ndaj pushtuesve të rinj, nuk i pëlqeu shpirtit rebel dhe revolucionar të filozofit Isuf Luzaj. Ai do të shprehte zhgënjimin se drejtimin e Ballit Kombëtar e kishin marrë në dorë feudalët (për të cilët ruante antipati që prej Vërlacit), ndërsa me keqardhje shtonte se *“Mit'hati (Frashëri) ishte një njeri shumë i ndershëm. Atdhetar qind për qind e i sinqertë. Demokrat në teori, aristokrat në praktikë. Në teori e donte demokracinë, po në praktikë ishte me bejlerët e Toptanit, sepse i kishte farefis... Ata bejlerë ishin armiku i popullit, sepse ata e mbajtën në hu e litar 500 vjet popullin shqiptar nën sundimin turk”*. Mbase prej këtyre pakënaqësive, në tetor 1943, Isuf Luzaj me Musine Kokalarin, Skënder Muçon dhe intelektualë të tjerë themelojnë në një shtëpi në Tiranë Partinë Socialdemokrate. Programi i saj kishte qëllim *“të luftojë kundër çdo okupatori për independencën e një Shqipërie të ujnitur brenda kufijve të saj etnikë”*. Duke siguruar drejtësi shoqërore, ajo garantonte liritë themelore të njeriut, ku përfshihej pikësepari *“liria politike”*,




Karriera akademike e Isuf Luzajt në SHBA shënoi vetëm rritje, por ajo nuk e pengoi armiqësinë e regjimit totalitar në Shqipëri ndaj tij dhe familjes.

nisma private, vota e fshehtë, zgjedhjet periodike dhe shprehimisht përmendte opozitën parlamentare. Neni i parë fliste për “*parti evolucioniste përsa i përket kolektivizmit shoqëror*”, ndryshe nga koncepti bolshevik i revolucionit që kishin komunistët. Studiuesi Kalemaj thekson se kjo parti ishte pararendëse e liberalizmit politik dhe një hap jo i vogël për historikun e së majtës politike dhe ideologjike në realitetin shqiptar. Shpallja e statutit të Partisë Socialdemokrate shkaktoi shqetësim te drejtuesit e lartë të Partisë Komuniste, e cila nisi fushatë për defaktorizimin e kundërshtarëve politikë, me sulme propagandistike e armë. Enver Hoxha kërkoi që në “Zërin e Popullit” të denoncoheshin disa figura, mes të cilëve Luzaj, për të cilin thotë se në radhët e Ballit Kombëtar ka qëndruar i pakomprometuar. Në një promemorie të majit 1944 firmosur prej tij, Luzaj thotë se po të ikin gjermanët, komunizmi do të sundojë në jug “*me terrorin e kuq*”, ndërsa veriun “do ta bëjë gjah për etjen e vet”. Paralajmëron spastrimin e intelektualëve e borgjezisë, dhe “*çdo shenje tjetër të qytetërimit, prej thikës së kuqe nën censurën e drejtësisë së revolucionit proletar*”. Duke iu drejtuar disa palëve, ai thotë se “*me tërë modestinë e emrit që nënshkruan, (kjo) synon të jetë një vërejtje lajmëtare, një lutje*”. Kjo promemorie që ruhet pranë Autoritetit të Dosjeve, duhet të ketë qenë e njohur për PK-në që në atë kohë.

Luzaj kishte qenë i qartë kur kishte thënë se “*Komunizmi është një filozofi jete antinatyrale, kundër ligjeve të natyrës, e dënuar të falimentojë, sepse është false me premisat logjike, e gabuar dhe pa themel në arkitekturën e ideve dhe fision, imagjinatë të sëmurë*”. Ai e kishte ditur se “komunizmi, marksizmi, leninizmi janë të dënuar si një utopi nga të gjithë heronjtë e mendimit të shekujve XIX dhe XX”, ndaj këmbëngulte ai, socialdemokracia është forma më adekuate të evoluimit të së majtës natyrore që garanton shtetin social dhe rishpërndarjen ekonomike. Sipas studimit të Ilir Kalemajt, mbi të cilin bazohet ky artikull, filozofi Luzaj mund të cilësohet pa frikë si një nga eksponentët më të shquar të demokracisë sociale apo socialdemokracisë shqiptare.

Socialdemokratët u veçuan si politikë brenda organizatës së Ballit Kombëtar dhe Luzaj do të ishte në Vlorë muajt e fundit të pushtimit, duke rritur gjithnjë e më shumë armiqësinë e komunistëve ndaj



tij. Ndaj kur lufta mbaroi, as njohja e afërt me Hoxhën nga koha e Parisit dhe ajo e Liceut të Korçës, nuk do ta shpëtonin filozofin. Në një intervistë të vitit 1992, Luzaj do të shprehej se *“ishim shokë në Paris e shokë në atdhe... ishte dinak i madh”*. Në tetorin e 1944, 31 vjeç dhe baba i pesë fëmijëve, filozofi Isuf Luzaj ikën nga Shqipëria duke e lënë familjen e tij në Kaninë të Vlorës. Me të mbërritur në Itali u arrestua si atentator i gjeneral Zaninit. U dënua me burgim të përjetshëm dhe më pas u fal. Me rekomandim të mikut të tij, Sandro Pertini (më vonë president i Italisë), djali i hoxhës kaninjtë punoi 2 vjet në Bibliotekën e Vatikanit, më pas dha mësim latinisht në Breshia. Më 1948 shkon në Argjentinë, ku punon për 15 vjet përkthyes i disa gjuhëve e këshilltar pranë Ministrisë së Arsimit, pedagog në Universitetin e Buenos Airesit, që e dekoron me medalje ari. Boton një sërë librash, mes të cilëve *“Lumenjtë rrjedhin të kuq”* duke u kthyer në autoritet të mendimit (antikomunist) dhe filozofisë së majtë. Emri i tij merr peshë, boton poezi e filozofi, merr letra nga Borgesi, Neruda, Sartri, Alcide de Gasperi, Palmiro Toliati, Sandro Pertini dhe Charl de Goli. Pas vdekjes së Ali Këlcyrës (1963), e thërrasin në SHBA për të drejtuar Ballin Kombëtar në emigracion. Ai zhvendoset në Amerikë.

Ndërsa ai spikat në dy Amerikat, në Shqipëri ku ka lënë pesë fëmijët e mitur dhe gruan, Dritën, regjimi totalitar e ka vënë në listën e kriminelëve të luftës dhe e quan *“tradhtar me damkë”*. Askush nuk e përmend në atdhe, por për shkak të tij, familja persekutohet. Internohen dhe vajza e vogël 1-vjeçare vdes në kampin e Fushë-Krujës për mungesë të ilaçeve kundër tuberkulozit. Ndërkohë që ata përndiqen në Shqipëri, vetë Luzaj, mbase pa dijeninë e tij, survejohet në SHBA. Më 1979 ai është emëruar titullar katedre i 87 profesorëve në Universitetin e Illinoisit, merr titullin *“Profesor Emeritus”* dhe dekoratën e lartë *“Profesor i Amerikës”* që i dorëzohet nga Presidenti Ronald Regan, për hir të karrierës në universitetet prestigjioze, si Harvard, Kolumbia, Indiana, Illinois, etj. Por shkëlqimi i tij në vendin e lirive nuk mbërrin në Shqipëri. Këtu mbërrijnë vetëm detajet e operativëve për jetën e tij, ndërsa letrat që i dërgon vazhdimisht familjes, lexohen rregullisht. Biri i një hoxhe që punoi në bibliotekën e Vatikanit, njeriu që çmoi *lirinë frënge të 1789-s që ishte temperament i tij*, siç thoshte vetë, burri që i



Komunizmi është një filozofi jete antinatyrale, kundër ligjeve të natyrës, e dënuar të falimentojë, sepse është false me premisat logjike, e gabuar dhe pa themel në arkitekturën e ideve dhe fision, imagjimatë të sëmure”

Isuf Luzaj

ati e quajti Isuf, dhe që në Amerikë e njihnin si Jozef, në një prej letrave për Dritën, flet për vetminë 40-vjeçare, dëshpërimin, mallin dhe ëndrrën me të shoqen ku ajo është ende e re. I penduar për ikjen, ai mbeti me sytë nga dritarja duke pritur postierin për letrat e saj. *“Pendimi që të braktisa më rëndon në kokë duke më shtypur”*, shkruan ai më 1984. Në shumë prej letrave dukej se kishte ikur dje, ndaj pyeste se çfarë bëri me sytë, nëse e mati tensionin. Ndërsa në një prej tyre thotë: *“Gjithnjë të shoh të zemëruar me mua, sikur kërkon të gjeçë nëpër mendjen tënde përgjigjen e pyetjes së tmerrshme: qysh më la??? Këtë përgjigje nuk do ta gjeçë dot kurrë në jetën tënde, sepse as unë vetë nuk e di. Edhe jo vetëm që nuk e di, por as nuk e kuptoj dot se si kam qenë aq i lehtë nga mendja duke lënë vetën time ta përzinte tufani e furtuna”*.

Me familjen u takua vetëm pas 1990-s, kohë kur në shqip mbërritën edhe veprat e tij *“Gloria e çmendur”* (1995), *“Lamtumira e yjeve”* (1995), *“Ekzistenca dhe boshësia”* (1996), *“Sëmundjet e shekullit tonë”* (ese filozofike, 1999), *“Topografi labçe”* (2001), *“Përtej së mirës dhe së ligës”* (2003), *“Rindërtimi i fuqive shpirtërore”* (2005), *“Filozofia e bukurisë”*(2009), etj.

Në atdhe u kthye vetëm pas 50 vjetësh dhe vetëm i vdekur, që të prehej në vendlindje. Ai besonte se *“njeriu nuk mund të jetë disa herë i lirë dhe disa herë rob; ose ai është gjithmonë dhe krejtësisht i lirë, ose ai nuk është kurrë, kurrë dhe kurrë i lirë”*. Filozofi i lirisë, i mohuari i përjetshëm.

Duke i hasur rrënjët e traditës së majtë te Sami Frashëri, studiuesi Kalemaj gjen te dëshira e Luzajt për mirëqenie bazë të shqiptarëve, elementë të tjerë të rishpërndarjes, filozofinë e një të majte politike ku shquhet lehtë dualizmi mes së majtës socialdemokrate dhe asaj nacionaliste. Si themelues i Ballit Kombëtar dhe Partisë Socialdemokrate ai lë pas konsistencë në mendimin e tij filozofiko-politik, ku gërshetohet antikomunizmi sistemik me një qasje barazie sociale nëpërmjet një shteti ndërhyrës, pa hequr dorë nga prona private. Ai është opozita që humbëm, versioni që nuk patëm në politikën pesëdekadëshe këtë perdes së hekurt.

Skënder
Luarasi



Patrioti, demokrati dhe opozitari i përhershëm

Më 1937, kur “Spanja po e hante Spanjën” nën shenjën e luftës civile, në një qytezë mes Valencias dhe Barcelonës, brigadave ndërkombëtare të vullnetarëve iu bashkohet një burrë nga Shqipëria e largët. Idealist, atdhetar, profesor, publicist, përkthyes, dramaturg, kokëfortë dhe... komunist.

“Ky revolucion po mbaron, ashtu si të gjithë: larg qëllimeve të tij dhe me ndërtimin e një piramide të re pushteti. Në fillim të revolucionit, njerëzia këndonin, përqafoheshin, pinin; tani shahen dhe pushkatohen. Në krye, jeta u dukej e hapur; tani besojnë te shtrëngimi”. Përshkrimi i Baltasar Porcel të “Perandori ose syri i erërave”, dëshmon ndjesitë e përbotshme të atyre që besuan dhe u zhgënjyen nga revolucione e revolucionarë. Më 1937, kur diku pranë Majorkës vinte në jetë Porcel dhe vetë “Spanja po e hante Spanjën” nën shenjën e luftës civile, në një qytezë mes Valencias dhe Barcelonës, brigadave ndërkombëtare të vullnetarëve iu bashkohet një burrë nga Shqipëria e largët. Idealist, atdhetar, profesor, publicist, përkthyes, dramaturg, kokëfortë dhe... komunist. Brillantina e flokëve pis të zinj që pluhurosur nga rrugë e gjatë, por fryma e ëndrrës që e pat çuar aq larg, ndjehej ende në ajri. Muaj më parë, në vjeshtën e 1936-s, i ulur në kafë “Kursal”, 37-vjeçari Skënder Luarasi ishte sulmuar si bolshevik nga Adem Karapici. I burgosur tri herë për qëndrimet antimonarki e antif feudale, profesori i trembet një tjetër arrestimi. Sulmi në “Kursal”, veç duket se i paraprin. Ndaj kur ehoja e radios që fliste për situatën në Spanjë i mbërrin në vesh, ai griset dhe i rrëfen kumatit të tij planin për udhëtimin drejt Madridit. Me të marrë lejen nga ministri i Arsimit, me pretekstin e kryerjes së doktoraturës në Vjenë, Tiranën e la në të ftohtin e dhjetorit. Mbërriti në Lion, ku u takua me të majtët shqiptarë, Ymer Dishnica, Kolë Tromara, Kostë Çekrezi e Zai Fundo. Ndonëse ky i fundit u rrek ta ndalonte me arsyetimin, se “Zogun mund ta luftonte më mirë në Shqipëri”, fillimjanarin e 1937-s Luarasi udhëtonte si klandestin, nga Parisi drejt Barcelonës e Albacetës, ku që baza e brigadave ndërkombëtare. Ikanaku nga regjimi i Zogut, ëndërrimtari i një rendi ku drejtësia e barazia shoqërore siguronin dinjitetin e individit,



Kam kërkuar që të zhvilloj mësimin mbi Faik Konicën, sipas programit, më kanë thënë nuk ta japim. E kam gjetur Faik Konicën në bakalli në frytierët e Tiranës, të shitur me kuintal për të mbështjellë. Pse? Se e quajnë feudal”

Skënder Luarasi

asobote ishte i vetmi intelektual i paangazhuar në asnjë prej grupeve të majta në Shqipëri, që shkoi në Spanjë me “kokën” e tij. Ai besonte te revolucioni, barazia dhe antifashizmi e, deri në fund të jetës, do ta dëshmonte me krenari pjesëmarrjen në atë luftë.

Të 37 vitet e tij para kësaj lufte, që qe e nuk qe e tija, patën qenë jo të lehta. I biri i Petro Nini Luarasit, një nga veprimtarët më të njohur të nacionalizmit shqiptar, Skënderi mbeti jetim kur babai iu vra nga shovinistët grekë. Me ndihmën e familjes së të ëmës, që rridhte nga Sevot e “Vatrës”, dhe të të vëllait, Skënderi në moshë të njomë shkon nxënës në Robert College të Stambollit. Mandej e gjejmë të ndjekë shkollën në Easton Penna, SHBA më 1916, në American Internation College (Springfield Mass, më 1918). Më 1920, kthehet në Shqipëri dhe shërben pranë Kryqit të Kuq në Elbasan. Studimet e mesme dhe të larta i vijon me ndërprerje në Vjenë, në Gjimnazin Klasik Fraishtadt (1922-1926) dhe Fakultetin e Filologjisë, që e përfundon më 1930. Me vitet e jetuara mes SHBA-së dhe Vjenës, rioshi e formoi identitetin e tij politik mes parimeve të demokracisë amerikane, çka nxiste tek ai qytetarin e angazhuar dhe reagues. Sonila Boçi, mbi studimin e së cilës bazohet ky artikull, vë në dukje se, si mësues, Luarasi do t’u mësonte nxënësve të tij se “*skllavi më i keq është ai që dëshiron të jetë skllav*” dhe se “*një njeri është i lirë kur ai formon dhe shpreh lirshëm opinionet e veta*”.

Daljet e para në shtyp me artikuj të karakterit kombëtar, me forcimin e pushtetit të Ahmet Zogut në një anë dhe jehonën e ideve marksiste në tjetrën, riformulohen. Ai e cilësonte veten revolucionar, pa e përcaktuar se në cilin spektër të së majtës pozicionohej, por shumë prej ish-studentëve të tij e quanin marksist. Gjenezën e marksizmit të tij, si shumë kohanikë, Luarasi e lidhte me denoncimin që i bëri Lenini



Skënder Luarasi me familjen

Traktatit të Fshehtë të Londrës, që copëtonte Shqipërinë. Pos kësaj, asikohe, shumë patriotë shqiptarë e quanin veten “socialistë” a “bolshevikë”, ndonëse, siç pohon prof. Kristo Frashëri, ata i përkisnin rrymës së majtë jomarksiste. Sipas historianes Sonila Boçi, kjo vlen edhe për Skënder Luarasin, që mbështetet nga kujtimet e tij “*edhe unë, si amerikanët kërkoja reforma... dëshirën time për reforma e liri ma kanë quajtur, 'herezi', 'anarkizëm' e deri 'komunizëm'*”. “Përplasja” e tij me Zogun nis kur në artikujt e botuar te “Djalëria”, Luarasi mbështet Lëvizjen e Qershorit. Kjo do t'i kushtonte jo vetëm bursën në Vjenë, por edhe tre muaj burg pas dasmës së motrës më 1928. Në fillimvitet 1930, Luarasi është profesor i gjuhës shqipe, i anglishtes dhe i gjermanishtes në Shkollën Teknike në Tiranë, pa iu ndarë aktivitetit antizogjist. “*Më 12 janar, - shkruan Luarasi, - më burgosën për tre muaj në lidhje me letrat anonime në Tiranë dhe me ngritjen e afishave në Korçë*”. Një vit më pas transferohet në Institutin Tregtar të Vlorës. I etiketuar si profesor problematik, kthehet në Tiranë vetëm pas ndërhyrjes së mikut të vjetër të familjes, Mirash Ivanajt, ministër i Arsimit. Megjithatë, mban kontakte me revolucionarë, i cilëson dallkawkë mësuesit që i thërrasin nipërit e Zogollit me titullin *Naltësi* dhe përzë djem feudalësh. “*Ndihmova për demokratizimin e shkollës, duke rekomanduar për bursistë vetëm djem të varfër dhe revolucionarë nga shpirti*”, kujton vetë ai.

Në vitet 1934–1935, ministri Hilë Mosi i kërkon të japë mësim në Shkodër. Por, krahas ngritjes së sistemit arsimor dhe shuarjes së ndasive fetare, Luarasi pohon të ketë shpërndarë broshura dhe literaturë revolucionare e në programet mësimore fut edhe romanin “Nëna” të Gorkit, shqipëruar prej Zavalanit. Nxënësit e tij, Lazër Radi, Arshi Pipa, Ramiz Xhabija, Andrea Varfi, e kujtojnë me respekt mësuesin e letërsisë, siç kujtojnë se u fliste për të majtën dhe nevojën për ndryshime rrënjësore në organizimin shoqëror e politik të vendit.

“

Spastrimi nën petkun e kolaboracionistëve ndiqet nga spastrimi mes të majtëve të LANÇ. Është e vështirë të kuptosh mendimin politik të Luarasis të kësaj kohe. Shkrimet e tij rrallohen dhe burri ekspresiv hesht në seancat e Kuvendit Popullor

Skënder Luarasi

”



Hartimet e nxënësve mbi temën “*E vjetra shembet, kohët po ndryshojnë, një jetë e re po lulëzon gjermadhash*”, shkëputur nga drama “Vilhem Tel” e Friedrich Schillerit, që ai kishte shqipëruar, përcënonin idetë që mësuesi i letërsisë kishte dashur t’u edukonte. Nga të gjithë, Luarasi zgjodhi të lexojë para klase hartimin e nxënësit Qemal Stafa, që qe një lloj manifesti i së majtës komuniste. Leximi i një hartimi me përmbajtje “bolshevike” nuk kaloi pa rënë në sy të drejtuesve të shkollës e parisë së qytetit. Ishte e gjithë kjo “parantezë” që e çoi drejt Spanjës. Nga Madridi, ku i dukej se “një jetë e re po lulëzonte gjermadhash”, Luarasi shkruan më 1937 artikullin “Ahmet Zogu var shokët e vet”, pas ekzekutimit të Ismet Totos. Veçohet qasja që ka Luarasi ndaj një kundërshtari politik që, siç vëren Sonila Boçi, ndryshe nga komunistët stalinistë shqiptarë që nxitën kulturën e cilësimit të kundërshtarit si armik të betuar, Luarasi jo vetëm që nuk e denigron, por përkundrazi, nuk ngurron as të fshehtë simpatinë për intelektin e Totos. Në hulumtimin e dokumenteve, kujtimeve e artikujve, Boçi vëren se Spanja dhe kontakti me marksistët ka radikalizuar qëndrimet politike të Luarasis. Pa mbërritur në një fetish, te luftëtari i Spanjës shihen shenjat e një “daltonizmi” ideologjik. Nevoja për t’u çliruar nga sundimi e për të gjetur drejtësinë, si zgjidhja e vetme për barazi, bëri që shqiptarët të shihnin te bolshevizmi udhën e ndryshimit të sistemit politik e shoqëror. Por revolta me sisteme të caktuara, për shkak të padrejtësive, ka prodhuar shpesh sisteme më të ashpra politike. Koha do të dëshmojë të njëjtën gjë, edhe në rastin e Luarasis. Tek ai, Boçi gjen simbiozën e dy ideologjive, patriotin me majtistin antifashist. I majti i paangazhuar në Shqipëri do të largohet nga Spanja si anëtar i partisë komuniste vendase. Për pesë vjet, gjatë Luftës së Dytë Botërore, qëndron në kampet e Francës, ku “*tok me Mehmet Shehun kemi mbajtur lidhjet me botën jashtë kampit*”, kujton ai. Pasi refuzon propozimin e Kostë Çekrezit për të shkuar në SHBA, arratiset nga kampi dhe jep mësimë private, derisa riatdhesohet. Në 13 qershor 1945, Skënder Luarasi mbërrin në Shqipëri me entuziazmin e atij që ka realizuar ëndrrën e vet politike: fitoren kundër fashizmit dhe fitoren e një sistemi tek i cili besonte. Më 1945, kandidon në zgjedhje për zonën e Kolonjës dhe është nismëtar i krijimit të Lidhjes së Shkrimtarëve. Por thyerja nuk vonon të shfaqet. Si fjalimet publike, edhe shkrimet e botuara gjatë 1945-s, e bëjnë të qartë që ëndrrat e tij për vendin dallojnë nga politika e PKSH-së. Ndërsa Luarasi i cilëson mike shtetet që kishin njohur Shqipërinë në nëntor 1945, përfshirë aleatët perëndimorë dhe flet për unitetin politik të Shqipërisë, si një atdhe i përbashkët, si për luftëtarin e LANÇ, edhe për familjen e ballistit të dikurshëm, Byroja Politike shpall aleancë me Bashkimin Sovjetik e Jugosllavinë, nis sulmet ndaj SHBA-së e Britanisë dhe, në shkurt 1946, sanksionon luftën e klasave. Spastrimi nën petkun e kolaboracionistëve ndiqet nga spastrimi mes të majtëve të LANÇ. Është e vështirë të kuptosh mendimin politik të Luarasis të kësaj kohe. Shkrimet e tij rrallohen dhe burri ekspresiv hesht në seancat e Kuvendit Popullor. Qëndrimet kontradiktore të 1946-s duket se pohojnë pezullin e tij, aq sa ai del pro heqjes së mandatit të deputetit të Shkodrës, ish-nxënësit të vet, Kolë Prela. Heshtja pothuaj dyvjeçare i lë vendin Luarasis luftarak në prill 1948. Ai kritikon politikat arsimore të ministrisë dhe trajtimin diskriminues ndaj profesorëve. “*Drejtuesat tanë rrinë në kolltuqet e buta të ministrisë dhe na diktojnë urdhëra, ata kanë guxuar dhe të goditin në kokë dhe profesorët. Kam kërkuar që të zhvilloj mësimin mbi Faik Konicën, sipas programit, më kanë thënë nuk ta japim. E kam gjetur Faik Konicën në bakall në frytierët e Tiranës, të shitur me kuintal për të mbështjellë. Pse? Se e quajnë feudal*”.

Një vit më vonë, “rebelizmi” i Luarasis shfaqet në mbrojtje të Sejfulla Malëshovës, ndonëse më herët ishin përplasur. Si Luarasi, edhe Sejfullai është kundër ndarjes së shkrimtarëve në të rrymës përparimtare dhe të rrymës reaksionare, dhe kundërshtojnë që Fishta, Mjeda, Noli dhe Konica të vihen në dy kampe të kundërta, pse tek ata mbështetej letërsia shqiptare e Rilindjes. Si Malëshova, Luarasi kundërshton imponimin politik që e drejtonte letërsinë vetëm në tema aktualiteti a në ato historike mbi Luftën Nacionalçlirimtare. Pas këtij qëndrimi, e përjashtojnë nga Lidhja e Shkrimtarëve. Veçse, reagimet e profesorit dhe miqësia me deputetët e dënuar nga gjyqi i famshëm, bën që më 1951, Sigurimi i Shtetit të nisë survejimin ndaj tij. Mbi mendimin politik të Luarasis hedhin dritë bisedat me miqtë që, në fakt, ishin bashkëpunëtorë dhe e raportonin te Sigurimi. Ai flet për veten si komunist, në kohë të shkuar të foljes. Nga dokumentet e dosjes kuptohet zhgënjimi dhe pakënaqësia ndaj gjendjes së përgjithshme të

" Topar sekret "

À p r o v o z e t
 Shefi Seksionit të Veprave
 M a j o r
 (Formulari 2023-A)
 Tiranë, më 28.12.1956

V e r d i m
 (me transferimin e dosjes formulare 2/A.)
 të Skënder Luarasi.

Ura Funtori Operativ Major Qiriako Frokopi i Drejtorisë II-te, mbasi pasqyrohet materialin e përdorur nga formulari 2/A të Skënder Luarasi,

G e j t a

se Skënder Luarasi, për aktivitet kurçorë qashtë përdorur të agjitacionit e propagandës, është marrë rrethimisht në vitin 1951.

Më gjen se sektori Inteligjencës Lirisë (Uniti) i kalon si objekt Drejtorisë P. Mbrendëshme Tiranë beqar nga instruktori zbi mbajtjen evidencave operativ.

V e n d o r a

transferimin e dosjes formulare nr 2/A. nepezmjet kartë Drejtorisë P. Mbrendëshme Tiranë për të vazhduar me punimin e tij.-

Funtori Operativ
 Major (Qiriako Frokopi

u-shlyt 1 kop.
 kon. dsk. Q.P.

AIDSSH, Dosje Formulare nr.
2823-A, Skënder Luarasi

" Topar sekret "

Korre P. On. P. Sekret
 Thona K. P. "Kosovë"
 Në bazën "Mikrofilm"

P A P O R T


1) Në datën 22.12.1970 si e kësaj me Andreu Diktoria me Em. Konf. e Pene. Te dy tek shkruan në agjë e komandës mbasi si kishte nevojë për të lypë qashtë, në përgjigje të komandës maqzonte Andreu duke marrë shkas nga shprehja e ndonjësit, tha:

"Ja nuk ka rrezull, nuk ka në drejtësi, kom shkas dhe ditë me për Skënder Luarasi. Skënderi me the qashtë është diktatura e të pa pëseve, kështu-pëse vete rrethim qishtë pëse vete tek me oficer te sigurimit, civilin, që te marrin vesh se çfarë them une për këtë ose vete është qashtë. Pëse vete nuk ka qashtë dhe legjitet e botës se jashtë, radioje jone nuk ka me dhe kështu një njëri po te komenteja ndonjë njëri nga këto rrethim vete shkas qashtë. Në qashtë se do të lëshim gazetën e jashtë dhe radioja do të them shtë, shpreh edhe po të shprehim njëri nuk do të dilte nevojë që te ndiqet. Skënderi tha që kështu te shpreh vije e tyre, por te të lësh edhe legjitet e botës e huaq."

Kështu ishte punë prejardhje me nuk shkruaj, na që në bte ndonjë te shkruaj, na që te shkruaj duhet te shkruaj sig është jeta me te vete, se kështu se ten dot se kështu duhet shkruaj, na një drejtësi.-

Janëq Andreu tha se ishte këshilluar me Skënderin për të agjë me korrespondencë me shkruaj e tij (te Adresa) me SH. H. A. mbasi shpreh herë i ka shkruar në shtë adresë në New-York, por nuk kishte marrë përgjigje. Mëherë Skënderi i tha që Andreu të shkruante te vellejt te Skënderi i n'Amrikë (i dhe dhe adresë). Skënderi e këshilloi që me leter shkruante për ndonjësit për qashtë, që s'kishte marrë përgjigje dhe te ma i kërkonte qishtë, se nuk bente dhe sepe letrat për jashtë kontrollon një për një. Skënderi i kishte themë që te shkruante vete Andreu, se nuk bente që për këtë punë të shkruante vete Skënderi te vellejt te tij.-

vendit dhe qeverisjes së njerëzve mediokër e pa vizion, që shpesh merr edhe tiparet e inateve personale. Nga raportet e bashkëpunëtorëve dalin kritika për nepotizmin, trajtimin e intelektualëve dhe imponimin e modelit letrar. Duke besuar se shkrimtari duhet të jetë i lirë të zgjedhë tematikat, qasjen filozofike dhe metodën, ai kritikon linçimet që u bëhen, si në rastin e dënimit të Kasëm Trebeshinës, kur Luarasi shprehet se “*kjo nuk është letërsi e realizmit socialist, por e hipokrizisë socialiste*”. Profesori kokëfortë nuk pyeste për luftën e klasave, sepse për të, individit duhej vlerësuar nga aftësitë, jo nga bindja politike. Ndaj kur më 1956, Arshi Pipa, i sapoliruar nga burgu trokiti në derën e ndërmarrjes së botimeve në Tiranë, Skënder Luarasi ndërhyri për të punësuar ish-nxënësin që e vlerësonte si përkthyes. Kritikat e tij i drejtoheshin edhe vetë Enver Hoxhës, si më 1957-n, kur Luarasi nuk hezitoi të bënte një paralelizëm mes Enverit dhe Stalinit: “*Tani dhe neve duhet t’i themi shokut Enver se edhe ay duhet të jetë më i lidhur me masat*”. “*Dragoi*”, një prej bashkëpunëtorëve të Sigurimit raporton se Luarasi i pohon Nasho Jorgaqit se “*desha të mos diskutoja, por kur mendova se historia është tempulli i një kombi shkova dhe fola... Në qoftë se nuk do të më linin të flisja do të shkoja drejt tek Enver Hoxha dhe do të kërkoja të drejtën time*”. Në fakt, ishte Enver Hoxha që qe treguar i ashpër ndaj ndërhyrjes së Luarasi, duke iu referuar si “*historian borgjez*”, me arsyetim “*antishkencor dhe antishqiptar*”. Në mes të viteve '50, ai pranohet sërish në Lidhje dhe në vitet 1960-1961 arrin të hapë katedrën e anglishtes në Universitetin e Tiranës. Humbja e së shoqes, Ollgës, e bën të kalojë një kohë të vështirë. Pas qetësisë në jetën profesionale, më 26 tetor 1964, kur në Lidhjen e Shkrimtarëve kritikohet romani “*Gjenerali i ushtrisë së vdekur*” i Ismail Kadaresë për probleme ideologjike, Luarasi flet me superlativa për veprën dhe e krahason Kadarenë me Heminguejin, çka e bën të konfrontohet ashpër me të dërguarin e KQ të PPSH. Ai përjashtohet sërish nga Lidhja e Shkrimtarëve e i përshkallëzohet survejimi, edhe prej martesës me profesoreshën sovjetike, Maja Poljakova.



Tri herë i burgosur nga Zogu, 30 vjet i ndjekur nga komunistët, ithtari i ideve marksiste që në rini shpjegonte Gorkin, e mbylli jetën si përkthyes i Uitmanit. Në fund, Spanja e hëngri Spanjën, për një kohë të gjatë. Shqipëria, po ashtu.

Në vijim, Skënder Luarasi e jetoi totalitarizmin stalinist shqiptar duke u strehuar në studime për patriotët e Rilindjes Kombëtare dhe duke bërë të flasin shqip Shekspiri, Gëtja, Bajroni, Longfellou, Uitmani. Ai jetoi si revolucionar i zhgënjyer, duke e ngritur zërin sa mundej. Për oficerët e Sigurimit të Shtetit ishte “i pakënaqur dhe kurrë nuk kishte për të ndryshuar”, ndërsa vetë ai rrekej të edukonte njeriun e lirë, në vend të “njeriut të ri”. Karakteri i tij i fortë, i shprehur në opinione shpesh pa qetësi, në kushtet e një jete pa hapësira lirie, mund ta ketë detyruar të bëjë kompromise me veten, por ai pati bindjen se kultura është rruga e vetme drejt përparimit. Jetoi duke besuar te liria, ndonëse provoi frustrimin eurvejimit, deri sa vdiq më 27 prill 1982. Mbeti, siç Lasgush Pogradeci e cilësonte “mik i shtrenjtë, patriot i madh, demokrat i madh, ‘sherrchi’ i madh”. Tri herë i burgosur nga Zogu, 30 vjet i ndjekur nga komunistët, ithtari i ideve marksiste që në rini shpjegonte Gorkin, e mbylli jetën si përkthyes i Uitmanit. Në fund, Spanja e hëngri Spanjën, për një kohë të gjatë. Shqipëria, po ashtu. Ndërsa Porceli dhe Luarasi do të dëshmonin në kohë e vende të ndryshme, nevojën e individit për dinjitet e liri.

“Kam dashur që në këtë atdhe populli të bënte një jetë të njerëzishme, me drejtësi dhe me barazi shoqërore, që secili të gëzonte frytet e punës së vet, të nderohej si qytetar i plotë, e të mos rronte njëri në kurriiz të tjetrit. E them kështu për të mos përdorur fjalën socializëm, për të cilën nuk janë bërë më pak spekulime” - Skënder Luarasi.

Petro Marko



Një vullnetar jashtë radhëve

Deri në fund të shënimeve autobiografike, ai nuk i braktis idealet rinore që i lidh me komunizmin, duke vënë një fill ndarës mes përjetimit të hershëm të ideologjisë dhe kalvarit që kaloi përgjatë regjimit. Ngul këmbë te papërputhshmëria që pati dalluar mes komunizmit dhe condominium-it shqiptaro-jugosllav të viteve 1944-1948.

“Rroftë jeta! Jeta mbi gurë, jeta në dallgët e detit, jeta kur ishte zor të jetoje, zor të dashuroje, zor të ëndërroje dhe zor të vdisje”. Një fjali e shkëputur nga romani i “nëmur” gjatë regjimit komunist, “Një emër në katër rrugë” i Petro Markos, përbënte shkurtimisht metaforën e jetës së tij. Kur e shkroi, ishte viti 1972. Kishte jetuar arratisjen dhe gjyqin në monarki, opozitarizmin e bazuar në besimin te republikanizmi, Luftën e Spanjës, internimin në Italinë fashiste, kishte qenë ithtar i hershëm i komunizmit dhe ishte hidhëruar prej tij me ta parë në pushtet, kishte njohur qelitë e ftohta të burgut shqiptar, ishte martuar e bërë baba, kishte vuajtur presionet. Si fatthënëse, fraza i parapriu përjashtimit të tij nga Lidhja e Shkrimtarëve, dërgimit të librit për karton e arrestimit të birit të vetëm, ndaj ai do ta dinte deri në dhimbje se ishte “zor të jetoje e zor të vdisje”. Dhe ai jetoi deri në grahmat e fundit të komunizmit qeverisës, mbase pa e humbur besimin tek idealizmi i ideologjisë. Dhe jetoi shumëçka.

Një burrë me flokë kaçurrelë të thinjur, me një cigare në cep të buzës, me shikimin hedhur përdhe. Kur imazhi është fiksuar në fotografi, atij i ishin vrarë ëndrrat, një e nga një, pandalur. Me babanë që e humbi shpejt, fëmijëria e tij prej jetimi, në Dhërmi të Himarës, shkoi nën kujdesin e gjyshes. Pas fillores, ndoqi mësimet në Shkollën Tregtare të Vlorës, ku njohu Kolë Kamsin e Ernest Koliqin, por edhe literaturat e para komuniste. Më 1932, mbërrin në Tiranë dhe merr emërimin si mësues në Dhërmi e mandej në Dropull. Edon Qesari, mbi studimin e të cilit bazohet ky artikull, vëren se më shumë se brenda një suaze marksiste, Marko linte përshtypjen se po i qasej një rryme të mbështetur


mbi baza mjaft klasike republikanizmi radikal. Në Dropull u fliste banorëve për padrejtësitë, duke iu vënë në dukje se kryeplaku zgjidhej çdo vit, ndërsa mbreti që i njëjti. Nganjëherë, u lexonte shkrime të organit të rinisë komuniste greke *“I protoporis”*. Kryengritja e Fierit ndryshon gjithçka dhe Marko ikën në Greqi. Është e paqartë nëse ikja nxitet nga miku i tij Asim Vokshi që, si pjesë e ushtrisë shqiptare, e paralajmëron për rrezikun që i kanoset, pasi ka rënë në sy të autoriteteve si propagandues komunist, apo, siç tregon më vonë, për të vazhduar studimet universitare në Athinë. Tirana zyrtare e paraqet kryengritjen si përbetim bolshevik, ndaj antizogizmi merr trajta të së majtës, ndërsa vetë Marko kujton se kryengritja “ishite për shpëtimin e popullit nga tirania dhe nga rreziku i pushtimit italian”. Kundërshtitë dhe pakënaqësitë e tij ndaj monarkisë në Shqipëri nisin të njëjtësohen me njëfarë majtizmi militant në Greqi, ku ai është përfshirë me emra si Spiro Koleka, po nga Himara, dhe Omer Nishani. Për Edon Qesarin, opozitarizmi i mesit të viteve ’30 nuk vinte si pasojë e një formimi të caktuar intelektual, sepse vetë Marko dëshmonte më vonë në kujtimet e veta që *“të gjithë ne e deshëm komunizmin, pa e njohur se ç’ishite komunizmi”*.

Më 1935, është kthyer nga Greqia dhe ka nisur të shkruajë në revistën “Illyria”, me pseudonimin DEMO-KOTI (Demokrat Komunisti). Me qeverinë e Mehdi Frashërit, në fundvitin 1935 fryn një puhizë lirie për median. I thirrur nga Vangjel Koça dhe Branko Merxhani, Marko vjen në Tiranë. Ky çast shenjon në mënyrë të pakthyeshme identifikimin e tij, nga një intelektual me qëndrime mospërfillëse ndaj zhvillimeve politike, në të tillë që i ndrijnë mendimet opozitariste, tashmë në media. Për më tej, zhvillimet e ardhshme, janë të asisojta, sa vetëm e çojnë në skaj prirjen opozitare që Marko e ndan me të tjera grupe në Tiranë. Në prill të 1936-s ai bashkëthemelon revistën jetëshkurtër “ABC”, ku gjenden emra të rëndësishëm të politikave kulturore të periudhës socialiste, si Dhimitër Shuteriqi dhe Shevqet Musaraj. Qesari shënon se toni i artikujve mbetet i ngjashëm me atë të një deklamimi nga maja e një tribune popullore e ku, qasja klasore parashihte «kryengritje të shpirtit dhe të barkut». Teprimi i një qasjeje editoriale të atillë, në të cilën kritikohet ashpër gjendja sociale në vend, ku Ferri i Dantes që hiçgjë në krahasim, apo politikat tregtare mes Shqipërisë dhe Italisë, sipas Qesarit, i bëri përshtypje, si Branko Merxhanit, edhe Migjenit.

Pas vetëm një muaji, pa dalë ende numri i dytë, “ABC”-ja u mbyll. Ethem Toto, ministër i Brendshëm i qeverisë “Frashëri” e cilëson organ “bolshevik”, por materiali i saj qarkullon ilegalisht. Marko do të takonte për t’iu ankuar deri vetë kryeministrin, por kjo nuk e shpëton nga gjyqi ku dënohet me gjashtë muaj internim. Kjo nuk e mban larg Tiranës, ku gëlonin polemikat, ngase zbatimi i urdhrit për internim nuk ndiqet nga autoritetet. Në fund të verës ai merr rolin e administratorit të revistës “Përpjekja shqiptare”, themeluar nga Branko Merxhani.

Me rënien e qeverisë së Mehdi Frashërit, puhiza e lirisë nuk ndjehet më. “Përpjekjes shqiptare” i kërkohet të deklarohet publikisht si revistë jokomuniste. Merxhani, që nuk kishte prirje të majta, i përshtatet udhëzimit të autoriteteve dhe Marko zhvendoset në Korçë, ku iu bashkohet organeve të tjera, si “Vatra”, “Arbëria”, “Shtypi” e “Bota e re”. Me vete ka marrë mërinë që lë gjurmë te një artikull studimor mbi letërsinë e kohës, ku sipas Aurel Plasarit, Marko i kundërvihet Ernest Koliqit dhe Vangjo Nirvanës, duke denoncuar politiko-futurizmin e “shkrimtarëve demagogë”. Kjo shënon një paralajmërim politizimi të mëtejshëm të penës së Markos. As revista “Bota e Re”, me qendër në Korçë, që mund të ketë shërbyer si tribunë për lëvrimin e ideve të celulës së atëhershme komuniste të qytetit, nuk do të zgjasë më shumë se disa muaj, nga prilli 1936 deri në shkurt të 1937-s. Ndonëse kontributi intelektual i Markos në faqet e saj mbetet modest, për Qesarin, ajo që vlen të theksohet është ndikimi që atmosfera tërësore pati në formimin e tij si militant i një të majte që nuk shkëlqente në lëmin e përpunimit teorik.

Ende në të njëzetat, në organet ku kish punuar, Marko e kishte shfaqur qartë ngjyresën e majtë ideologjike të tij, megjithëse ai e dinte mirë se, si e majta edhe e djathta e kohës kishin dritëhijet



Në prill të vitit 1936, ndërsa atmosfera intelektuale e Tiranës vazhdonte të ishte nën ndikimin e rrezatimeve “liberale”, Petro Marko bashkëthemelon revistën jetëshkurtër “ABC”, në një kohë kur rrethanat politike të krijuara po nxisnin hapjen e disa organeve të karakterit demokratik.

e veta. Nëse për antizogistët shqiptarë në Paris, si Ali Këlcyra, Beqir Valteri, Rexhep Mitrovica, Marko thoshte se “këta politikanë ëndërronin që Zogun ta hiqnin Fuqitë e Mëdha... pastaj këta të ktheheshin... e të ishin në krye të qeverisë, të pushtetit”, komunistët e kohës në vend, kishin të tjera ndërdyshje brenda vetes.

Emra në zë si Lllazar Fundo, Sejfulla Malëshova, Ali Kelmendi e sidomos Tajar Zavalani, të cilin Marko e shihte si veprimtar energjik, ndikuan drejtpërdrejt në pjekurinë e tij politike. Kthimi i tyre nga Moska, ku kishin qëndruar, u jepte në sytë e të rinjve breroren e shenjtë të komunizmit, shënon Qesari, por ndryshe nga ç’dukej, mes militancës politike dhe përshtypjeve të tyre për BS-në, kishte hendek. Petro Marko në kujtimet e veta thotë se ata kishin njohur një Bashkim Sovjetik shumë të varfër në vitet ‘20, por nuk e thoshin. “Nuk ishin entuziastë, ishin të lumtur që kishin lënë atë vend dhe kishin ardhur këtu... Ata, duke na parë në plot entuziazëm dhe besim ndaj komunizmit, nuk mund të shpreheshin kundër, se do të quheshin tradhtarë dhe renegatë”. Kjo heshtje mbi komunizmin e jetuar, ndryshe prej atij ideal nëpër tekste, do të kishte pasoja për vetë ata e për vendin më tej.

Koha e kaluar në Korçë i dha mundësinë Markos të kishte marrëdhënie të drejtpërdrejta me elementin e majtë shqiptar, mbledhur rreth grupit “Puna”, – pararendës i celulës komuniste të Korçës. Grupi komunist i Korçës mbante lidhje organike me Përfaqësinë Komuniste Shqiptare në Paris, e cila vepronte si zyrë *plénipotenciaire* e Kominternit për rekrutimin e vullnetarëve shqiptarë në Luftën e Spanjës. Qesari beson se qëndrimi në Korçë ka pasur fryte për konvertimin përfundimtar të Petro Markos nën aureolën komuniste dhe do të ishte po ky *habitat* që do ta çojë drejt Luftës civile të Spanjës. Në kujtesën e Lllazar Fundos, pas Asim Vokshit e Skënder Luarasis, në verën e vitit 1937, Petro Marko merr rrugën drejt Spanjës. Dalja nga Shqipëria nuk kishte qenë e lehtë, ngase Tirana, zyrtarisht, kishte shpallur asnjëherë përballë një konflikti të brendshëm që po merrte përmasa ndërkombëtare të paprecedenta. Në kujtimet e veta, Marko dëshmon se para nisjes, Omer Nishani e porosit t’i



(nga e majta në të djathtë) Petro Marko, Sejfulla Malëshova dhe Safo Marko

“

Ti ke milituar në partinë spanjolle, në partinë franceze, në partinë italiane... Kjo parti këtu nuk është si ato. Kjo është një parti e krijuar nga dy serbë dhe është parti terroristësh

Sejfulla Malëshova paralajmëron Petro Markon

”

dorëzohet Lllazar Fundos në Paris një raport ilustrues mbi gjendjen në Shqipëri. Në dinamikat politike që synonin bashkimin e elementëve antizogistë dhe komunistë nën suazën e Moskës, Marko shfaqet si element ndërlidhës. Përplasja mes trockistëve dhe filosovjetikëve do të bëhej gjithnjë e më fatale në botë, ndërsa majtazmi shqiptar do të orientohej tragjikisht kah Moska, në çka dallim bënte vetëm Fundo. Në mesin e kësaj lufte të madhe grupimesh, Petro Marko do të jetë vetëm një ushtar, pavarësisht se vullnetar, duke përfutur kësaj dhe anëtarësinë në Partinë Komuniste për herë të parë.

Mes shumë shqiptarëve të tjerë, si Asim Vokshi a Mehmet Shehu, - Marko në Spanjë bëhet pjesë e brigadës “Garibaldi”, komanduar nga socialistë e komunistë italianë, ku gjejmë emrat e Randolfo Paciardi-t dhe Luigi Longo-s. Ky i fundit do t'i japë lejen për botimin në gjuhën shqipe të revistës informative të brigadave ndërkombëtare, me titull “Vullnetari i lirisë”, ku del emri i Petro Markos. Për këtë revistë himnizuese ndaj Bashkimit Sovjetik, Ali Kelmendi i shkruante Longos nga Parisi se, nuk e kemi çuar “*aty Petro Markon të merret me vjersha, po e kemi dërguar për në front*”. Në kujtimet e veta, Petro Marko dëshmon se grupi i komunistëve të Parisit ishte përcarë, Lllazar Fundo do të shpallej heretik nga Kominterni dhe filostalinistët shqiptarë. Ali Kelmendi që vetë kish humbur mbështetjen, do ta cilësonte Fundon trockist, ai do të përjashtohet bashkë me Tajar Zavalanin. Për Qesarin, rrethanat apo ndonjë fije konsiderate vetjake bëjnë që Marko të jetë i tërhequr ndaj këtyre sherrnajave, heshtje që më vonë pothuaj merr përmasat e një zgjedhjeje politike. Por ai i mbetet besnik linjës zyrtare të Kominternit dhe, si komisar batalioni, shpall përkatësinë e vet staliniste, çka shkakton ftohje përfundimtare mes tij dhe Kelmendit. Fati i Markos si vullnetar ndërkombëtarist në luftën civile spanjolle ndjek atë të brigadave antifashiste në përfundim të konfliktit, me tërheqje.

Marko mbërrin në qytezën franceze të Grenoblit ku, si anëtar i Partisë Komuniste Franceze, regjistrohet në universitet. Kelmendi e quante “aventurier”, ndërsa Marko dëshmon se asnjë prej komunistëve nuk i vizitoi shqiptarët e kampeve a të mbeturit rrugëve pa përkrahje, çka përndryshe e bënë nacionalistët. Ndonëse këtë e thotë në kujtimet e 1970-s, për Qesarin, kjo shpreh më së miri një ndasi; themelimi i një subjekti politik unitar të komunistëve shqiptarë – kishte marrë trajtë të qenësishme, mes veprimtarësh të lidhur krejtësisht pas vullnetit të Kominternit dhe të tjerësh që, në kushte të shthurura organizative, vërtiteshin pa një vendndodhje të saktë politike. Duket se Petro Marko, që nuk kishte qenë kurrë pjesëtar i ndonjërit prej atyre pak grupeve gjysmë të organizuara të së majtës shqiptare (pos lidhjeve me emra të caktuar), i përket kësaj galaksie militantësh që nuk renditeshin pas një qendre. Kominterni porositi ish-pjesëmarrësit e Luftës së Spanjës të kthehen në atdhetë e tyre dhe Marko mbërrin në Shqipëri, në prill të 1940-s. Në pak kohë emri i tij del në listën e të akuzuarve për agitacion kundër autoriteteve në Shqipërinë e pushtuar. Mes majit 1940 e marsit 1942, ai është në burg pa iu bërë gjyq. Me t'u liruar, kallëzohet sërish për shkak të trazirave në Himarë, ndaj anëtarit i Partisë Komuniste Franceze që vinte nga Lufta e Spanjës, pa arritur të ketë me komunistët e sapobashkuar të Tiranës një marrëdhënie të konsoliduar, pos një gjysmë takimi me Koço Tashkon dhe Koçi Xoxen, dërgohet për internim në Itali, deri më 1943. Atje u bashkohet partizanëve komunistë italianë dhe pas arrestimit nga fashistët, jeta i shpëtohet nga Ernest Koliqi. Siç del nga dokumentet e Autoritetit të Dosjeve, ai riatdhesohet në tetor 1944.

Që Petro Marko ishte një militant që zor se mund të renditej brenda rrymave dhe zhvillimeve të së majtës komuniste shqiptare, kishte qenë e qartë që përpara lufte, kur profili i tij politik dhe intelektual nuk u lidh kurrë përfundimisht me asnjë nga grupimet e kalcifikuara para themelimit të PKS-së, thotë Qesari. Nga 1939-a e më pas, Marko njohu disa përvoja partiake si satelitë të Kominternit, ku janë të qarta mospërputhjet ideore e mendësitë që mbretëronin mes drejtuesve të lartë komunistë. Marko kujton Sejfulla Malëshovën ta ketë paralajmëruar: “*Dëgjomë mirë! Ti ke milituar në partinë spanjolle, në partinë franceze, në partinë italiane... Kjo parti këtu nuk është si ato. Kjo është një parti e krijuar nga dy serbë dhe është parti terroristësh. Ndaj më dëgjo mirë: nuk duhet të hapësh gojën të paktën për një vit për ato që sheh dhe dëgjon. Përndryshe, do ta pësosh...*”, citohet t'i ketë thënë Markos Malëshova.




Petro Marko dhe
Fatos Arapi



Petro Marko me
të bijën

Kjo dëshmi që gjendet në kujtimet e shkrimtarit, tregon shumë për raportin e tij me regjimin e ri. Marko caktohet në drejtim të gazetës “Bashkimi” ku, ndonëse që kritik ndaj raportit shqiptaro-jugosllav, e paraqet atë idilik. Por miqësia me Sejfula Malëshovën që bie, notat nacionaliste dhe përvoja militante e Petro Markos paralajmëronin përkeqësimin e marrëdhënieve të tij me regjimin.

Në pranverën e 1947-s ai kallëzohet për “faje penale kundër popullit dhe shtetit” e arrestohet përmes një letër-ndalimi të përhershëm, pa asnjë hollësi tjetër, siç del nga dosja pranë Autoritetit. Vetë ai mendonte se kjo i erdhi prej atyre që mbrojnë interesat jugosllave, ndërsa në vjeshtë akuzat qenë disa. Sipas një deklarate ku pranon të zbërthejë «aktivitetin t’im në shërbim t’Amerikanvet», nënshkruar pas muajsh dhune të ushtruar në ambientet e paraburgimit, Marko pranonte se i kishte dhënë amerikanëve, “informata mbi biografin e personave të ndryshëm të Pushtetit dhe në se ishin në Partinë Komuniste, gjë që ka qenë kryesorja për Amerikanët, p. sh., Për Komandantin, Sejfulla Malëshovën, Ymer Dishnicën, Ymer Nishanin, Nako Spiron, Spiro Kolekën”. Më pas del të ketë bërë biseda politike me grupin e deputetëve në Hotel “Dajti” e në shtëpitë e tyre, të ketë pasur lidhje me Harry Fultz-in, deklarohet po ashtu «një nga agjentët aktiv të spiunazhit amerikan në Shqipëri» dhe bashkëpunëtor i kuislingëve në vitet ‘43-‘44 në Itali. Ai nuk i pranon akuzat, pohon lidhjen e hershme me komunistët, por shpallet fajtor dhe dënohet me tre vjet burg nga Gjykata e Lartë Ushtarake. Jeta në burg nuk duket se tronditi bindjet ideologjike të Markos, që vetëdijësohet për sistemin e instaluar. Ai që kishte qenë aq aktiv para lufte, bëhet apolitik, hesht dhe tërhiqet. Ruan njëfarë raporti me ata që kish njohur para 1945-s, si me Mehmet Shehun (që e kish takuar në Spanjë), që e quan shpëtimtarin e vet, ndonëse shkruan që «nuk ishte më ai Mehmet që njihja unë». Edon Qesari arrin në përfundimin se të qenët një *protégé* i njeriut të dytë më të fortë të Republikës Popullore të Shqipërisë, e lejoi Markon që për një




Petro Marko tenton vetëvrasjen

kohë të gjatë të mund të ishte shkrimtar e të botohej. Libra si “Qyteti i fundit” dalin pa cungime censure. Por jo gjithnjë. Edhe miqësia mes Markos e Shehut do të zhbëhej, si librat e shkrimtarit për karton. Kur kryeministri ngriti supet si për të dorëzuar Markon para “xhelatëve”, Marko përjashtohet nga Lidhja e Shkrimtarëve. Gjithë ç’kishte parë e ndër e bëjnë Markon të gjejë një udhë të re. «Atherë e gjeta çelësin dhe zgjedha temat e dashura për mua, luftërat e trimave, të popullit tim për liri, pavarësi dhe çlirim». Si pasojë e këtyre botimeve jashtë ëndrrave të tij, ai merr çmimin e Republikës.

Është interesante të lexosh Markon të ketë shkruar për veten, pothuaj atë që anglezi Julian Barnes shkruan për Shostakoviçin në Bashkimin Sovjetik se, duke e lënë të jetonte, e kishin vrarë. “Unë shkrova si poet, si gazetar e si shkrimtar... u kritikova ashpër, u dënova me heqjen e së drejtës së botimit....Më keq se të kisha vdekur: unë vërtet isha gjallë, por... isha eliminuar si krijues” kujtonte Marko. Deri në fund të shënimeve autobiografike, ai nuk i braktis idealet rinore që i lidh me komunizmin, duke vënë një fill ndarës mes përjetimit të hershëm të ideologjisë dhe kalvarit që kaloi përgjatë regjimit. Ngul këmbë te papërputhshmëria që pati dalluar mes komunizmit dhe *condominium*-it shqiptaro-jugosllav të viteve 1944-1948. Deri në fund Marko sheh një vijimësi të pacenuar mes militantizmit të tij majtist dhe një lloj romantizmi patriotik që e pat karakterizuar si veprimtar dhe shkrimtar.

Petro Marko ndërron jetë më 23 dhjetor 1991. Nuk e mbërrin prapun e Krishtlindjes që do sillte lirinë. Nëse do të pyesnim si jetoi, mund të citonim vetë atë, nga romani “Hasta la vista”, “Futuni për një çast në shpirtin e një njeriu që mbeti vetëm, pa ndjenja, i mbuluar në dhe...Dhe shokët e tij janë vrarë të gjithë ose dhe ata të pakë që mbetën të gjallë të jenë tërhequr dhe armiku i tërbuar të ketë shkelur edhe tokën e Katalonjës! Kështu mbeta unë...”

Zef Mala



Leninisti i penduar që nuk diti të heshtë

Mala thoshte se udhëheqja nuk jep udhë, por shtyp. Në narrativën e një jete të shkuar nën shtypje e burgje, ai bartte peshën e vet të fajit dhe nuk kishte drojë nga “mea culpa”. Sipas një përgjimi më 1964, ai shprehej se “ky sistem është totalitar, policor, që terrorin e ka për parim, por unë nuk duhet të ankojem, se vetë e desha këtë sistem”

“Kur e prune në Kamp të Ballshit, ai ishte gati qorr në të dy sytë; dritë shifte, por nuk mund të dallonte njerëzit, as objektet. Shokët e vet i rrinin gadi për çdo gjë”. Te memuari i tij “Rrno për me tregue”, mes portreteve të të burgosurve që ka njohur në venddënime, Atë Zef Pllumi e shpërfaq Zef Malën, si “nji ndër emnat ma të njoftun në Shqipninë e kohës së re, sepse ishte i pari që kishte organizue në të gjithë vendin nji ‘parti komuniste’, aso here ‘sëmundje rinie’”. Shkodrani i fisëm që e pat nisur shkollimin te Kolegji Saverian i etërve jezuitë, atëbotë do të bënte shaka me fratin, ngase e kishin përjashtuar nga shkolla, ndaj dhe frati do thoshte me të qeshur se mbase duhej të kishin përdorur metodat klasike të inkuizicionit për ta shpëtuar vendin nga komunizmi. E për këtë të fundit, Zefi i fesë e ai i politikës ranë dakord, ndërsa vuanin dënimin të dy, si kundërshtarë të regjimit.

Pak muaj para se të shuhej në spitalin e burgut, Zef Mala, që edhe ashtu kishte zënë shtratin nga pafuqia, do t’i linte amanet fratit shënimet e tij, ku leninisti i rinisë ishte zhbërë për t’u shndërruar në një socialdemokrat klasik. Frati nuk mundi ta çonte në vend amanetin, ato shënime, që përngjasojnë sot me “ungjijtë apokrifë” nuk u gjetën kurrë, duke zhdukur me to një traktat të mundshëm lirie prej një ish-komunisti. Porse i njëjti komunizëm që pat zhdukur mendimet e strukturuara të Zef Malës, “i zbardh” ato përmes dosjes së tij të përndjekjes që ruhet pranë Autoritetit. Një prej informatorëve raporton Malën të ketë thënë, se “kam hequr dorë nga marksizmi. Socializmi ka dështuar, s’ka as një gram socializme e komunizme, ka vetëm llafë bosh, kamb zbathur e bark bosh”. Si për të hedhur më tepër dritë mbi këtë shndërrim, në një bisedë me shkrimtarin Kasëm Trebeshina, i dënuar edhe ai, teksa flisnin me zë të ulët dhe kontrollonin kush kalonte atypari, informatori e dëgjon Malën të thotë: “Nuk shkruaj asgjë, lexoj pak dhe rrij mendoj... njerëzimi do të zhvillohet nëpërmjet ideve të mëdha: 1) të

filozofisë greke, 2) Të moralit të krishterë, 3) të ideve mbi shtetin dhe të drejtat e Anglo-saksonëve. Revolucion ishte ai francez që i dha... vlera njerëzimit, ndërsa ai në Rusi ishte grusht shteti, i aftë për të shkatërruar çdo gjë...". Por është tepër vonë, ai e ka kaluar të shumtën e jetës në burgjet e monarkisë, fashistëve e komunistëve të vet; nga 60 vjet dënime, ka kryer 25 të tilla. Tek i afrohej jetës së pasosur, ai veçse dëshmon sistemin e papërsosur politik për të cilin pat vënë peng rininë.

Ka amulli për të kuptuar kohën e saktë kur pinjollit i një familjeje shkodrane, i formuar në një shkollë të krishterë, ra në kontakt me ideologjinë komuniste. Edon Qesari, mbi studimin e të cilit bazohet ky artikull, përmend nga "Promemoria" e Zef Malës, shkruar në burg (1948) njohjen me disa italianë në Shkodrën e viteve '29-'30. "*Unë mësova pse shtypja e jetesës ishte vetëm një nga trajtat e shtypjes shoqërore dhe se përveç kësaj, ekzistonte një ma e madhe, shtypja e klasave... Mora së pari dhe lexova librat dhe broshurat mbi socializmin, mbi komunizmin, mbi lëvizjen sindikale t'Italisë dhe mbi revolucionin Rus... faktorët e sipër përmendun caktuan udhën time dhe më shtynë në rrugën e Komunizmit, por akoma nuk njihshim asgjë mbi Marksizmin e vërtetë".* Atë kohë, ai ishte vetëm 15 vjeç.

Katër vjet më pas ai qe zhvendosur në Tiranë e, prej aty, me një bursë të financuar nga qeveria shqiptare, nis Fakultetin e Filozofisë në Universitetin e Vjenës. Njëkohshëm, Mala shfaqet në shtypin e kryeqytetit me artikuj kryesisht mbi letërsinë. Në dy vitet e qëndrimit në Vjenë, 1934-1936, ecejaket e shkurtra të Malës në atdhe do të ndaheshin mes kryeqytetit e Shkodrës, dhe është kjo koha kur mund të ketë rënë në kontakt me radikalët shqiptarë. Megjithëkëtë, Qesari shënon se ka mendime që afrimi i Malës me idetë e majta lidhet me qëndrimin e tij në Vjenë ku, asokohe, socialdemokratët me frymëzim marksist, numëronin më se dy dekada në pushtet, aq sa kryeqyteti austriak njihej si "Vjena e kuqe".

Autoritetet e monarkisë shqiptare do t'i ndërprisnin bursën, ngase kishte shfaqur ide marksiste në ambientet universitare vjeneze. Me studimet e lëna në mes, më 1937 Malën e gjejmë në Tiranë, pjesë e gazetës "Arbënia" dhe të afruar me një celulë ndjekësish të ideve të majta, ku kishte emra që do të spikatnin në zhvillimet e mëvonshme politike, si Tuk Jakova, Vasil Shanto dhe Qemal Stafa. Ata qenë bërë të njohur në mesvitet '30, mes shkollarëve të Shkodrës, për propagandimin e librave radikalë. Nis në këtë kohë udhëtimi politik i Malës që, vetëm një vit më pas, është në krye të grupit komunist në Shkodër. Ishte vetëm 22-vjeçar dhe nis të përkthejë broshura nga autorët "klasikë" të literaturës marksiste, që prej vetë Marksit, te Lenini, Stalini, Dimitrovi, – çka dëshmon se i riu që 7 vjet më parë ish njohur vetëm me konceptin e shtypjes së klasave, tani e kishte të qartë kuadrin e plotë ideologjik. Në korrikun e 1937-s, Koço Tashko, prej të paktëve shqiptarë me lidhje direkte me Moskën, kthehet me qëllim unifikimin e grupeve "anarkike" të komunistëve vendas. Është ky udhëtim që, njëfarësoj, hedh hapat e parë të tatëpjetës së mëvonshme të Malës.

Prej luftës spanjolle, Kominterni nga orientoheshin, e përkrahte mundësinë e një paqeje të përkohshme mes komunistëve dhe nacionalistëve në Shqipëri. Kjo linjë e re taktike, që zbuste qëndrimin ndaj kundërshtarëve, u refuzua nga Mala. Meqë nismën e pat marrë përsipër Koço Tashko, ajo u cilësua si e diktuar nga interesat e Grupit komunist të Korçës duke sjellë armiqësim me Grupin e Shkodrës. Zef Mala kishte bërë të qartë se lidhja e komunistëve shkodranë me Kominternin nuk do të kalonte përmes "korçarëve", por përmes Partisë Komuniste Jugosllave. Përplasja mes grupeve bëhet publike përmes botimeve të dy grupimeve - "Buletini jeshil" i Shkodrës është kundër "Buletinit të bardhë" të Korçës. Duke u pajtuar për bashkimin e komunistëve, buletini jeshil i hakërrehet të bardhit me terma mbi pastërtinë doktrinale dhe metodën leniniste, ku shquhen fraza, si "*Brenda lëvizjes komuniste kanë depërtue elementë të pakontrolluar, bile shkatërrues (...) kjo lëvizje shkatërrimtare po spekulon emnin komunistë dhe besimin e shokëve të pastërvitun mirë në punë marksiste".* Për Edon Qesarin, nëse merret e mirëqenë se Zef Mala, si kreu i Grupit komunist të Shkodrës, ka peshë në autorësinë e dokumentit, del më qartë botëkuptimi i tij politik dhe ku ndahet Grupi i Korçës me atë të Shkodrës, në fakt ndjekës të dy shkollave të ndryshme të mendimit. Ndërsa Grupi i Korçës kishte adaptuar tërësisht linjën e shpallur nga Dimitrovi, shefi i




Në vitin 1937, Zef Mala, asokohe 22-vjeçar, gjendej mes një grushti themeluesish vërsnikë të një organizatë politike të majtë në qytetin e tij të lindjes, e cila do të njihet më vonë si Grupi Komunist i Shkodrës.

Kominternit, për bashkëpunim me parti të tjera socialdemokrate, liberale e deri nacionaliste, pasuesit e Malës përdornin një retorikë tjetër, duke i mbetur besnikë asaj që kishte qenë politika zyrtare e Kominternit, deri në neoformulën e Dimitrovit. Ndasitë nisnin prej leksikut, te nocioni i “diktaturës së proletariatit”, i papërshtatshëm për kushtet shqiptare, e deri te një qasje me teorinë e “social-fashizmit”, sipas akuzave korçare. Për Qesarin, fort të dallueshme janë gjithashtu dozat e një puritanizmi leninist që bën thirrje për përpjekje në drejtim të ndërgjegjësimit klasor për shtresat e ulta të shoqërisë, disiplinën partiake e bashkërendimin ndërkombëtarist. Qesari e gjen problematik pohimin e Malës që komunistët e Shkodrës kishin zgjedhur të lidheshin me Partinë Komuniste Jugosllave, ngase fraksioni të cilit Mala i referohet, do të humbte përballë Titos, me bekimin sovjetik.

Në janar të 1939-s, krerët e Grupit të Shkodrës, përfshi Zef Malën dhe disa të Korçës, do të arrestohen. Gjyqi i posaçëm pothuaj asgjëson veprimtarinë e shkodranëve. Hulumtimet e Qesarit tregojnë se procesi u përqendrua te këta të fundit, ngase grupi i Korçës kishte prirje më të moderuara. Vija puritane e ndjekur nga Grupi i Shkodrës ua vështirësoi pozitën. Për më tepër, në prag pushtimi, monarku kërkonte qetësi në vend, që nuk do ta gjente me qasjen radikale të pasuesve të Malës që, pos të tjerash, e shihnin pushtimin si përshpejtues të kushteve socio-ekonomike dhe të volitshëm për shpërthimin e një revolucioni socialist. Zogu duket se u tregua bashkëpunues me “komunistët” korçarë, pasi jo vetëm ua kurseu dënimet, por edhe ua pastroi terrenin politik prej “sivëllezërve” të pabindur dhe “sektarë”. Zef Mala dënohet me 12 vjet heqje lirie dhe, bashkë me Qemal Stafën e Vasil Shanton, çohet në një kamp pune. Pushtimi bëri që më 6 prill të hapeshin burgjet. I shoqëruar nga Vasil Shanto, Zef Mala do të arratiset drejt Jugosllavisë, ku i dëbuan dhe i detyruan të kthehen në Shqipëri.

Prej këtij çasti, fati politik i Zef Malës distancohet nga ai i Grupit Komunist të Shkodrës, ndonëse mbetet njëfarë pike referimi. I arrestuar si antifashist, Mala përfundon në internim në Ventotene të Italisë, ku njihet me personalitete antifashiste dhe antistalinistë të deklaruar, si Llazar Fundo. Deri në



Dosje hetimore-gjyqesore nr. 370, Zef Mala.



Dosje formulare nr. 2505 e Sigurimit për Zef Malën

verën e vitit 1943, kur u kthye në atdhe, veprimtaria politike e Malës mbeti pezull dhe, vetë ai, krejtësisht i izoluar prej zhvillimeve politike në Shqipëri. Kur kthehet pas kapitullimit italian, Mala gjen në vend një Parti Komuniste me hierarki të hekurt, krejt të afërt me jugosllavët që janë filli lidhës mes komunistëve shqiptarë dhe Moskës. “Ç’është më e rëndësishmja, Mala ndodhet përballë një formacioni që ishte shprehur e drejtpërdrejtë e vullnetit stalinist për të përjashtuar çfarëdolloj shtypte opozitare brenda saj”, shënon Qesari. Ndërsa ai mungonte, grupet ishin bashkuar dhe ai kishte mbetur jashtë loje, madje emri i tij përmendej me përçmim nën damkën e mosmarrëveshjeve me Grupin e Korçës. Periudha e përplasjes mes grupeve parapartiake, pas çlirimit do ta stigmatizojë Malën, si “me tendenca antiparti, edhe pas formimit të Partisë”, siç del nga dosja. Duket se, në mungesë, barra e krejt fajeve “sektare” i ishte lënë atij, ose kështu do të besonte më vonë. Ai duhet të jetë vënë në dijeni, ndaj nga burgu ku ndodhej më 1943, i shkruan një autokritikë Komitetit Qendror. “Gjatë kohës së shkueme kisha ba punë, por edhe gabime, kishem krijue shumë miq, por dhe armiq...” rikujton në “Promemorie”. Përgjigjja e Enver Hoxhës për të duket parathënëse për të ardhmen. Ai që do të ishte dora e hekurt e Partisë, me një buzëqeshje vrastare, lëkundet mes një fryme pajtuese e akuzuese, kur i thotë se “Gabimet e bamuna prej ish grupevet të ndryshme komuniste, i kanë bamë dëm të madh lëvizjes s’onë... konsequencat e punës së vjetër me grupazhe... ndihen... (por) sikundër që e di çdo dënim që jep Partija ka një karakter edukativ dhe ajo ndihmon të ngrihen, të gjejnë rrugën e drejtë, të gjithë ata që kanë gabuar dhe që i njohin gabimet e tyre”. Por rruga e tij e drejtë kryqëzohej rishtas me dredhat e Partisë. Dhe pabesinë e fjalëve. I kthyer në atdhe më 1943, ai vendoset në Pezë. Duke e ndier mënjanimin nga qendra politike, – nuk është as i anëtarësuar në Parti, – punon si shef seksioni në Bibliotekën Kombëtare. Përçmimi i Hoxhës kur thotë se ka ndonjë “që e quan teoricien të madh” do të dilte qartë në pah. Raportet e mëvonshme tregojnë se as puna e Malës, edhe si drejtor i bibliotekës, nuk

qe e lehtë e, jo vetëm se kishte të bënte me koleksionet e konfiskuara prej kundërshtarëve të regjimit, por edhe se “mospastrimi” i librave të dëmshëm për kohën do të bëhej një prej akuzave para arrestimit. Në maj 1947 ai është me pranga në duar. Me ndërhyrjen e Tuk Jakovës lirohet dy vjet më pas. Po më 1949, emërohet për çudi, drejtor i Arkivit të Shtetit. Por më 1952, Mala vrojtohet ngultas. Nën nivelin më të lartë të përgjimit, del se ai është kthyer në kundërshtar të hapur të regjimit dhe vetë Enver Hoxhës, për të cilin thotë, jo pa përçmim, se “*ishite në Bruksel, kur të tjerët punonin me komunizmin*”.

Mund të ketë besuar se i kishte shpëtuar burgut, ndaj është krejt i çlirët në biseda. Me gjasë, as nuk e di që përgjohet e, veç kësaj shpjegohet të kumtuarit lirshëm i mendimeve të veta të rrezikshme. Raportet flasin për komente të tijat mbi çështje ndërkombëtare, shqiptare dhe shoqërimin e tij me personazhe kundërshtarë të regjimit, ndërsa procesverbalet e pyetjeve që i bëheshin, dëshmojnë për një njeri fort të matur në përgjigje. “*Ndofta i lodhur nga braktisja në të cilën gjendesha, pësova një çthurje shpirtërore dhe fillova të kem dhe manifestoj mendime që më përpara as i kisha manifestuar. Këto konsistojnë në komentimin e ngjarjeve të mëdhaja dhe problemeve të përditëshme të Pushtetit*”, thoshte ai më 1955.

Për hetuesinë, rrezikshmëria e Zef Malës qëndron në faktin se ai mbjell panik për pasigurinë e vendit. Ai e pranon akuzën, por thotë se “*në kohën që kam zhvilluar këtë aktivitet kundërshtar në agitation dhe propagandë, nuk kam mendue se ka qënë e tillë*”. Në tetor 1955 e dënojnë 5 vjet në Burrel. Vëzhgohet gjithnjë dhe, sipas informatorëve, flet për grupet komuniste para Partisë, mbështet socialistët e Perëndimit dhe nuk është pënduar. Lirohet më 1959, por është në vrojtim. Edon Qesari thekson se raportimet e kësaj kohe, që lipsen vëzhguar me lupë kritike për sa i përket vërtetësisë së tyre, na japin gjithashtu një ide mbi evolucionin e mendimit marksist të Malës. E ky, afërmendsh, thotë Qesari, e shpreh atë në prizmin ndikues të realitetit politik shqiptar. Qartazi del prej raporteve se ai ka pësuar një reflektim ideologjik që, nga leninisti i kahershëm, e çon drejt një qasjeje më të afërt me socialdemokracinë klasike.

“*Ne social demokratët kemi pasqyrën e vërtetë të drejtësisë dhe të një demokracije reale Marksiste... Masa duhet të ngrihet me evolucion dhe të jepet e drejta e plotë e lirisë, të mos ketë frikën e automatikut, siç veprohet sot*”, e raporton një informator. Ai e di se emri i tij ka falimentuar. Qarqet miqësore janë zhdukur a burgosur. I sëmure, me shikimin që shkonte drejt verbërisë, të parit së paku mund t’ia ketë bërë më të lehtë humbjen e marrëdhënieve shoqërore, çka del nga vrojtimi. Nga Tirana e çojnë në Shkodër, në internim në Zvërnec dhe e rikthejnë në Tiranë. Mbetet interesante që në tërë vetminë ku ishte lënë, sërishmi, ka vend për ndonjë kontakt të gjithë ç’degjon e raporton. Mala thoshte se udhëheqja nuk jep udhë, por shtyp, sidomos kur ai e krahason me evolucionizmin hrushovian që po shembte fanatikët. Në narrativën e një jete të shkuar nën shtypje e burgje, ai bartte peshën e vet të fajit dhe nuk kishte drojë nga ‘*mea culpa*’. Sipas një përgjimi më 1964, ai shprehej se “*Ky sistem është totalitar, policor, që terrorin e ka për parim, por unë nuk duhet të ankojem, se vetë e desha këtë sistem*”. Tërë pohimet e tij politike mendohet të jenë pjesë e një libri që nuk mbërriti kurrë në duart tona. Ashtu si vetë ai nuk kish mbërritur të shihte me sytë e tij ëndrrën e rinisë për një sistem politik që do të qe, së paku, më pak shtypës se monarkia. Për komunistët ai thoshte se “*kryesisht janë njerëz që udhëhiqen nga inadi, jo nga arsyeja, dhe në vend që ta ngrajnë popullin në nivelin e aristokracisë, kanë ul dhe aristokracinë në mjerimin e popullit fukara dhe këtë e quajnë barazi e zhdukje klasash*”. Ditirambet për komunizmin rinor qenë shuar, tashmë qe kelku perëndimor që e ndillte. Dhe shtypja e klasave vazhdonte.

Më 1968, në moshën 53-vjeçare, Zef Mala martohet me një vajzë himariote nga një familje e persekutuar nga regjimi. Për tre a katër vjet duket se jeta e tij gjen njëfarë prehjeje, ndonëse përgjohet dhe nxitet të flasë. Zef Mala nuk heq dorë nga çiltërsia kundër politikave të regjimit. Por çiltërsia përjashtohet nga realizmi socialist. Më 1971, prej izolimit, sëmundjes së syve dhe braktisjes prej të gjithëve, ai mendonte se nuk i duhej “*më as drejt*”. Liria e shprehjes, aq e ndaluar atë kohë, ishte kaq e çmuar për të. Verën e 1978-s, Zef Mala internohet familjarisht në Labovë të Madhe të Gjirokastrës, ku arrestohet pas letrës që i dërgon Mehmet Shehut. Kishte shkruar testamentin e tij politik. Ai e gjykonte linjën e Partisë Komuniste, të papajtuësme “*me idealin e asaj lirie që pat inspirue veprën time e mendimin tim të dikurshëm*”. Dënohet me 10 vjet heqje lirie. Vendos ta kundërshtojë regjimin për të fundmen herë. Pak muaj më vonë, më 26 dhjetor, Zef Mala do të ndahet nga jeta, duke “*refuzuar*” të kryejë dënimin.

Isuf Keçi



Komunisti i Grupit të të Rinjve nën regjimin totalitar

Vëllezërit Isuf e Hamit Keçi, ndonëse mes anëtarëve të parë të Grupit të të Rinjve, nuk morën pjesë në mbledhjen themeluese, por dhanë mbështetje të pamatë në organizimin e PKSH-së dhe luftës guerile në Tiranë. Njohjet, lidhjet, pasuria dhe shtëpia e familjes së tyre u vunë në dispozicion të lëvizjes, për mbledhje, demonstrata e aksione.

Më 1917, në një familje të kamur që merrej me tregti në Tiranë, një prej konakëve që pat kontribuar deri në themelimin e qytetit në shekullin XVII, lindi Isuf Keçi. Ishte djali i dytë i Ibrahimit e Hafsasë, të njohur si patriotë e mikpritës. Në Tiranën që shijonte kohët e fundit të lirisë, mes ideve të progresit, rioshi ndien në shkollë përhapjen e ideve komuniste. Qarkullimi i kësaj rryme dokumentohet nga qarkoret e Ministrisë së Brendshme në vitet '30 drejtuar Ministrisë së Arsimit, ku vihet në dukje se rreziku i ideve socialiste dëmtonte ndjenjën e nacionalizmit.

Raportet sekrete të Xhandarmërisë së Mbretit vërejnë se ideologjia komuniste synon shkollat dhe organizimet sindikaliste. Komandi i përgjithshëm, Shefki Shatku, më 5 korrik 1936 i drejtonte Zogut një raport ku e ndante “djalërinë” në komunistë të vërtetë, në të rinj që spekulojnë si komunistë për interesa materiale dhe në djem që thonë se janë komunistë vetëm për modernizim dhe për t’u dukur intelektualë (reklamistë). Në grupimin e fundit e sheh Isuf Keçin Dorian Koçi, mbi studimin e të cilit bazohet ky artikull.

Vite më vonë, Keçi, tashmë para bankës së akuzës, do të rrëfente se “qëkur isha nxënësi në gjimnaz më kanë rënë në duar dhe kam lexuar studime me përmbajtje socialiste. Këto m’i kanë dhënë Faik Miraku... dhe rrallë Qemal Stafë”. Pohimi i tij pasqyron përhapjen e ideve të ekstremit të majtë të moshat e reja. Veçse, nxitja kryesore që i çoi të rinjtë të përfaqësonin këto ide, pasi i kishte përqaftuar një pjesë e elitës intelektuale, ishte denoncimi që i kishte bërë Lenini më 1917 “Traktatit të Fshehtë të

Londrës” që copëtonte trojet shqiptare. Pos të tjerash, dëshira e madhe për modernizim të shpejtë shihej e lidhur me një lëvizje revolucionare të tipit bolshevik. Udhëzimet e Kongresit të Internacionales Komuniste (1935) kishin mbërritur në Shqipëri nga Koço Tashko më 1937 dhe patën filluar të propagandoheshin nga Grupi Komunist i Korçës.

Isuf Keçi po mbaronte gjimnazin e Tiranës, kur 73 komunistë u arrestuan, pjesa më e madhe e Grupit të Shkodrës. Gjyqi i janarit 1939 dhe dënimet deri në 10 vjet burg, përhapën panik mes të rinjve. Vetë Isufi, në procesvarbalin e marrjes në pyetje në hetuesi shumë vite më pas, deklaronte se dy muajt para pushtimit që frikësuar dhe nuk lexoi e as shpërndau më literaturë komuniste që fliste për fundin e klasës borgjeze, proletariatin, gjyqet e Moskës, sukseset sovjetike në jetë e shoqëri, shkaqet e luftës së klasave, etj. Pas pushtimit, Keçi nis studimet në Fakultetin Politeknik të Torinos. Ai e lë shkollën vetëm një vit më pas, në fundin e 1940-s, sepse nuk donte të shkonte më në Itali. Ndonëse në Torino studionin shumë shqiptarë, mes të cilëve edhe Qemal Stafa, nuk ka të dhëna që Isuf Keçi të ketë zhvilluar aktivitete komuniste atje.

Jeta dhe shumë prej vendimeve të tij janë të lidhura ngushtë me të vëllanë, Hamitin, dy vjet më i madh, ish-student i shkollës ushtarake të Napolit, që kishte refuzuar diplomën dhe shërbimin në ushtrinë italiane, çka e çoi në internim nga fashistët. Në fundin e 1939-s dhe fillimin e 1940-s, e majta shqiptare shpërfaqej në formën e vet më radikale, ndërsa grupet e Korçës dhe Shkodrës përbëheshin nga “të rinjtë” që pikëtakonin gjithë ngjyrimet komuniste, staliniste a trockiste qofshin. Isufi bashkë me të vëllanë, Hamitin, ishin anëtarë të hershëm të Grupit Komunist të të Rinjve, fillesat e të cilit gjendeshin më 1935, në drejtimin e Sadik Premtes e Anastas Lulës. Veç vëllezërve Keçi, aty gjeje emra si Sadik Stavaleci, Kristo Frashëri, Jusuf Kambo, Agron Çorati, Hysni Kapo, Ramadan Çitaku. Nëse deri në pushtim veprimtaria që përqendruar te përkthimet e përhapja e ideologëve komunistë, më 1940, grupimet bënë përpjekjen e parë për t’u bashkuar.

Në nëntorin e këtij viti, Isufi shkon në Itali me dy qëllime, të takonte të vëllanë në internim dhe të kryente porosinë e Anastas Lulës, që përmes Hamitit të takonte “ndonjë shok të Partisë Komuniste Italiane”. I vëllai e vuri në kontakt me një syresh, të cilit Isufi i paraqiti udhëzimet për t’u lidhur me Partinë Komuniste Italiane, por italianët nuk e panë të nevojshme. Isufi u kthye pas gjashtë ditësh në Shqipëri dhe refuzimi nga Partia Komuniste Italiane i hapi udhën asaj Jugosllave. Grupi Komunist i të Rinjve etiketohej si i “njerëzve të aksionit”, fanatikë dhe të gatshëm për aksione të rrezikshme. Në përpjekje për të fituar supremacinë mes grupeve marrin përsipër lirin nga kampi i Peqinit të komunistit jugosllav, Miladin Popoviçi, që më pas do të bëhej armiku i tyre. Megjithëkëtë, zhvillimet e luftës bëjnë që të lihen mënjatë përçarjet e më 8 nëntor 1941 të themelohet Partia Komuniste Shqiptare.

Vëllezërit Keçi, ndonëse mes anëtarëve të parë të Grupit të të Rinjve, nuk do të marrin pjesë në mbledhjen themeluese, por do të japin mbështetje të pamatë në organizimin e PKS-së dhe luftës guerile në Tiranë. Njohjet, lidhjet, pasuria dhe shtëpia e familjes së tyre, u vu në dispozicion të lëvizjes, për mbledhje, demonstrata e aksione. Isufi e Hamiti, me pozicione drejtuese në njësitet guerile, ishin vetëm dy nga katër anëtarët e familjes që gjatë luftës ishin ilegalë. Megjithë angazhimin, ata dhe të tjerë nga Grupi Komunist i të Rinjve shiheshin me dyshim, sidomos nga të dërguarit jugosllavë, ngase Të Rinjtë nuk zbatonin disiplinën e partisë, quheshin anarkistë, të vetëkënaqur dhe flisnin në mënyrë libeske.

Më 1942, Popoviçi e cilëson Grupin Komunist të të Rinjve, trockist. Madje në një letër drejtuar Titos, e njofton se ka nisur spastrimi nga të padëshirueshmit. Kontradiktat mes udhëheqjes së PKS-së dhe drejtuesve të Grupit të të Rinjve dalin qartë pas dy muajsh, në Konferencën e Jashtëzakonshme të PKS-së në Tiranë. Të rinjtë anatemohehen si grup fraksionist, për çka merren vendime dhe spastrime të ashpra që cilësohen si shfaqja e parë e stalinizmit në lëvizjen komuniste e majtiste shqiptare. Sidomos për emisarët jugosllavë, bindja e verbër ndaj partisë ishte e qenësishme. U dëbuan për një afat të pacaktuar nga partia: Anastas Lula, Sadik Premtja, Halit Petrela, Sandër Jorgoni, Mërkur Çela dhe Shaban Jegeni. U dëbuan për



Isuf Keçi lindi në Tiranë më 1917 në një familje qytetare dhe patriote tiranase. Ai ishte djali i dytë i Ibrahimit dhe Hafsasë. Të parët e familjes Keçi u vendosën në territorin që sot mban emrin Tiranë rreth vitit 1600 (Arkivi Marubi)


tre muaj Isuf Keçi, me pseudonimin Biveriku, Shyrete Turkeshi dhe Kristo Frashëri, historiani i ardhshëm shqiptar.

Të rinjtë, – sipas Dorian Koçit, mbi studimin e të cilit bazohet ky artikull, – panë se po zhdukeshin gjurmët e organizatave para partisë, që për ta ishte njëlloj “*sikur të bashkoje miellin me krundet*” – domethënë të kualifikuarit e Të Rinjve me anëtarët e thjeshtë që nuk dinin se çfarë ishte marksizëm-leninizmi. Dëshmi të shkruara, si kjo e jugosllavit tjetër, Dushan Mugosha, tregojnë jo vetëm karakterin e Isufit, por edhe format e dhunës që iu përçuan lëvizjes komuniste shqiptare. Mugosha shkruan për vëllezërit Keçi se “*ata përpiqeshin, të shkatërronin mbledhjen dhe rezolutën e Konferencës së Partisë. Më kokëfortë ishte Jusufi [Isufi]. Pasi mungonin argumentet, duke mos ditur ç’të bënte, pyeti: D.m.th Partia është për luftë, për vrasjen e spiunëve... A më lejon kjo Parti për të cilën bëhet fjalë këtu, të vras Mustafa Krujën, kryeministrin e qeverisë kuislinge? Unë iu përgjigja menjëherë: Ky do të ishte një aksion i rëndësishëm ...*”

Ndonëse Isufit i besohej ndonjë detyrë, si demonstrata e 7 prillit 1942, ai ishte i padëshirueshëm nga partia dhe figura që po e dominonte atë. Historiani Kristo Frashëri, atëkohë i ri, do të kujtonte më pas se në një takim, Enver Hoxha e pyeste nëse mbante kontakte me anëtarë të Grupit Komunist të Të Rinjve dhe në veçanti, me Isufin. Kur Kristo Frashëri do t’i pohonte marrëdhënien me Isufin, diktatori i ardhshëm do të shprehej i zhgënjyer. Pas dëbimit të parë, në shtator të vitit 1942, Isuf Keçi përjashtohet nga Partia. Shkaku që se ai kishte dashur të rrëmbente vajzën e komandantit të xhandarmërisë, për ta shkëmbyer me një militant komunist të arrestuar. Për Koçin, më shumë se dënimi i një akti terrorist, përjashtimi ka të ngjarë që u ndërmor sepse po shprehej solidaritet me ish-anëtarin e Grupit Komunist të Të Rinjve, Shyqyri Ishmi, me të cilin do të shkëmbehej e rrëmbyera. Emri i Isufit përmendet edhe në një letër që Hoxha dhe Popoviçi i dërgojnë Nako Spiros në mars 1944 për çështjen e grupazheve. “*Isuf*



Letër rreshtimi... te behet Fletë-arresti për Isuf Keçi



Aktakuzë për Isuf Keçi

Keçi kish qenë atje dhe Kristo Frashëri i kishte thënë të piqej me Xhaxha Nezin dhe Xhepin (Sadik Premten). Unë kam bindje se... janë pjekur dhe gjithë plehrat që s'janë në Parti dhe që janë në Parti". Pavarësisht kësaj, Isuf Keçi, më 8 prill 1944, ripranohet në PKSH dhe i ngarkohen detyra të larta deri në komandant brigade dhe komisar divizioni. Në 28 nëntor 1944 emërohet komandant i Brigadës XI sulmuese, në mars 1945 komandant i Zonës III të prapavijës së Shkodrës, në prill komisar i Divizionit VI në Vuçiternë. Pas çlirimit, tensioni në marrëdhëniet mes Keçit dhe PKSH-së vijon, por më 1946, qeveria komuniste i jep detyrën e drejtorit të grumbullimit në Ministrinë e Tregtisë.

Isuf Keçi do të besonte më vonë se persekutimi dhe përndjekja e tij nga Sigurimi i Shtetit nisën që gjatë viteve të afrimit shqiptaro-jugosllav, 1944-1948. Në një letër që do t'i dërgonte nga burgu prokurorit Josif Pashko, Isufi e lidhte përndjekjen e tij me emrin e ministrit të Brendshëm, Koçi Xoxe. Historiani Koçi gjen të dhëna të besojë se përndjekja ishte demonstrim i përçmimit ndaj Grupit Komunist të Korçës, si nga jugosllavët, edhe nga Hoxha. Njëherit vlen të përmendet se pas çlirimit, institucionet kryesore të shtetit ishin nën diktatin dhe këshillimin jugosllav. Që nga Kryeministria e deri te Drejtoria e Sigurimit të Shtetit raportonin në Beograd, duke vazhduar traditën e nisur në luftë, çka kishte krijuar *de facto* tiparet e një shteti në protektorat. Pas ndërprerjes së marrëdhënieve me Jugosllavinë, Shqipëria nisi operacionet e spastrimit nga "mbështetësit" e Titos. Isuf dhe Hamit Keçi e mbështetën kursin e ri prosovjetik të PKSH-së. Më 13 dhjetor 1948, Isuf Keçi emërohet kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Tiranës. Por vetëm dy vite më pas, më 1950, marrëdhëniet e Isuf Keçit me drejtuesit e regjimit totalitar u përkeqësuan sërish.

Vëllai i tij Hamiti, pas studimeve në Akademinë e Lartë Ushtarake “Voroshilov” në Moskë, u emërua drejtor i Drejtorisë Politike të Zbulimit në Ministrinë e Mbrojtjes dhe mori gradën “Kolonel”. Më 1 gusht 1949 Hamiti përplaset me sovjetikët, shefin e Shtabit të Ushtrisë, Beqir Ballukun dhe Hysni Kapon, shef i Drejtorisë Politike të Ushtrisë Shqiptare. Ai besonte se planet e stërvitjes së ushtrisë ishin të dëmshme dhe të hartuara nga tradhtarë të popullit. Më 2 gusht të vitit 1949, Hamit Keçi arrestohet, çka shënon nisjen e gjuetisë për grupe armiqësore mes të afërmeve të tij. Hija e Grupit Komunist të të Rinjve u rishfaq 8 vjet pas themelimit të PKS-së. Vetë Enver Hoxha, në një bisedë me ambasadorin sovjetik Dimitri Çuhavin, shprehet se grupi “*në periudhën e pasqirimit u përpoq dhe përpiqet të futet në udhëheqjen e partisë...*” Si anëtarë të grupit ai përmend Hamit e Isuf Keçin, Njazi Islamin, Abedin Shehun (ministër i Punëve Publike), Shukri Këllezin (zëvendësministër e më pas drejtor i Kombinatit të Naftës në Kuçovë).

Në dokumente që gjenden në arkivat e Moskës, Hamit Keçi i referohen si i çmendur, por me këtë rast “zbulohet” e dënohet edhe “veprimtaria e grupit antiparti”, ku veç dy vëllezërve Keçi është edhe kunati i tyre, Njazi Islami. Më 29 shkurt 1950, siç kuptohet nga dosja e tij, gjashtë muaj pas të vëllait, Isufi është arrestuar dhe vuan paraburgimin në hetuesinë e Tiranës.

Komunikata e KQ të PPSH-së përmend të kaluarën komuniste të të arrestuarve, lidhjen me *trockistët* Anastas Lula e Sadik Premte, por vëren se kjo pjesë e grupit të Të Rinjve, “*që kishte të njëjtat koncepte antiparti, ishte gjithmonë në pritje të evenimenteve dhe të krizave në Parti për të përfutur nga situatat*”. Flitet për grupazh, krijimin e një organizimi paralel a dekonspirime. Për PKS-së, nga lidhjet “miqësore” të ruajtura nga grupi i Të Rinjve, ata përfunduan në krijimin e një grupi antiparti në radhët e Partisë me tipare organizative, politike dhe morale të grupit të vjetër të Të Rinjve, duke kaluar në luftë ndaj Partisë Komuniste.

Dosja hetimore e Isuf Keçit thotë se “*ai kishte pasur disa takime, të cilat kishin nisur në fillim si dreka qejfi për t’u kthyer dalëngadalë në një grup, të cilit iu shtua edhe Hamit Keçi, (kunati) Njazi Islami e disa të tjerë*”. Nga dëshmitë e Isufit para hetuesve, ai del të ketë pranuar se bisedat mes tyre sillleshin rreth gjithçkaje që ndodhte, nga sigurimi i bukës, tek orientimi, Europa e Ushtria e Kuqe, kulakët, hekurudhat, minierat, etj. “Grupi antiparti” kishte diskutuar madje, edhe pamundësinë e vendit për të ndërtuar tri fabrika, një rafineri e një hidrocentral në 5 vjet. Paaftësia e kuadrove është një tjetër temë e diskutimeve të tyre, që nga ministrat, tek ata më të thjeshtët. Tematika e bisedave shpreh shqetësim dhe perceptim të ndryshëm nga çfarë propagandonte shteti komunist për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. Grupi Komunist i të Rinjve ishte kritikuar për intelektualizëm dhe Enver Hoxha e ndoqi si parim deri në fund të jetës promovimin e bashkëlufëtareve gjysmë të shkolluar, por që kishin si virtut besnikërinë ndaj tij.

Pleniumi V i Komitetit Qendror të PPSH mori vendime të rënda ndaj të atij që u quajt grupazh anti-Parti. U përjashtuan nga KQ Abedin Shehu, Njazi Islami dhe kandidati i KQ Shyqyri Këllezi. Kur Njazi Islami vrau veten, ngjarja u dënua si tjetër akt armiqësor nga komunistët në pushtet, ndaj ai u përjashtua nga Partia pas vdekjes. Dy vëllezërit Keçi po ashtu u përjashtuan nga Partia, ndërsa u miratua arrestimi i tyre “*për faje kundër popullit dhe shtetit*”.

Për Koçin, trashëgimia politike në Grupin Komunist të të Rinjve kishte lënë gjurmët e veta në trajtimin e problematikës së zhvillimeve të vendit. Pas dënimit me burg si elementë antiparti më 1951, Isuf Keçi nuk u rehabilitua më kurrë, as nuk ia doli të ishte më aktiv në jetën e së majtës komuniste shqiptare. Fjalët e mikut të tij të rinisë, profesor Kristo Frashërit, një nga anëtarët aktivë të Grupit Komunist të të Rinjve shpjegojnë shumëçka. Frashëri do të kujtonte se shpëtoi pa u goditur sërish “vetëm me 25 lekë, sa kushtonte një çelës tutius” duke nënkuptuar mbajtjen mbyllur të gojës, sjellje që karakterizoi të gjithë anëtarët e mbetur gjallë të Grupit Komunist të të Rinjve. Isuf Keçi vdiq më 1984. Mendimi dhe aktiviteti i tij politik gjeti vëmendje vetëm pas ’90-s, nga nxitja e të vëllait, Hamit Keçi. Hamiti do të ishte një nga themeluesit e Organizaës së Veteranëve të Luftës, që përbëhej nga veteranë jodogmatikë që dëshirojnë rishikimin e historisë së LANÇ dhe të së majtës shqiptare.

*Xhavid
Qesja*

10

Ky sfidant tragjik

Të gjitha të dhënat për Xhavid Qesen nxjerrin në pah dy cilësi, që vështirë t'i ndash dhe po aq vështirë t'i kuptosh pa njëra-tjetrën. Njëra është veçori karakteri, veçori morale, tjetra është veçori formimi intelektual. Me të parën kuptojmë rezistencën përkundër depersonalizimit, çka për të ka qenë një luftë e gjatë dhe sfidë e ashpër me pushtetin.

“Ta kam thënë edhe njëherë, - iu shpreh Xhavid Kiço Ngjelës në burgun e Burrelit, - unë nuk jam bërë komunist duke lexuar “Nënë” e Gorkit, por “Kapitalin” e Marksit, qysh kur isha student në gjimnaz.”

45-vjeçari Xhavid Qesja, hollak, me një fytyrë të prerë, me mollëza të dala e të rëna, një baba i lënë pa fëmijë prej 9 vitesh e një bashkëshort pa grua po aq, i lodhur e i nëmitur, i ka lëshuar shpresat matanë telave me gjemba tashmë, por në vetëdijen e tij të pamposhtshme, Marksit e ruan ende aureolën e ndritshme të krijimit të një ideologjie që qe fort e bukur në letra, sa kish marrosur një gjysmë bote, e fort e frikshme në jetët njerëzore, sa po zhyste në mjerim e diktaturë po atë gjysmë. Me një frazë të thjeshtë, ai bën dallimin mes bindjes së tij sipërore dhe atyre që zbatonin një “komunizëm’ romanesk” (që për të, as që e kishin kuptuar), larg doktrinës që pat magjepsur vetë Xhavidin në moshë të re. Si perandori “prej letre” që ishte, sekush kishte shënuar në të modalitetet e veta, duke shformuar ëndrrat ideale në realitete deformuese të vetë individit. Kur shkoi 50 vjeç, kur trupi veçse kërrusej, por mendja veçse hapej, ai ishte i vetëdijshëm se ideali shpresëplotë i rinisë së hershme qe kthyer në makthin e gjysmës së botës. Nga raportet e përndjekjes së tij në burg, që gjenden në fondet e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe që së fundi i janë dhënë në administrim Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH), ai citohet të ketë thënë se *“këtë komunizëm që ekziston sot në botë, në të gjitha vendet pa përjashtim, do ta urrente edhe Marksit, Engelsin e Lenini. Ky komunizëm është më i keq se fashizmi dhe nazizmi, se ata, edhe në kohë lufte nuk i kanë terrorizuar popujt e tyre si këta.”* Gjithë jeta e tij, e “dokumentuar” për ironi nga ata që e përndiqnin, mes tyre edhe “shokët” me të cilët kalonte vitet e burgut, është tregues i një force të madhe morale, i një karakteri të pacenuar dhe të papërkulur, i tronditur nga deformimi aq keq i doktrinës. Letrat që ka shkruar dhe dërguar, bisedat e ruajtura në

përgjime, raportet e agjentëve a “të penduarve”, e shpërfaqin të plotë portretin e rrallë të një burri që në 30 vjet burgje e internime humbi gjithçka, duke nisur nga familja, por jo dinjitetin e autoritetin. Ky udhëtim i tij, pat nisur në rrugicat e kalldrëmta të Krujës, në një familje të pasur me toka e dyqane, ku lindi më 1922. Ai do t’i kthente shpinën familjes, e familja e fafisi atij, pikërisht për shkak të bindjeve të tij komuniste, kur regjimi, përmes tatimit të jashtëzakonshëm, iu mori shumëçka.

Djaloshi krutan 19-vjeçar e nisi lidhjen me komunizmin më 1941. Për historianen Ana Lalaj, mbi studimin e të cilës bazohet ky artikull, Qesja është sfidanti i rrallë e tragjik që e çoi jetën çuditshëm midis dy skajesh, ekzaltimit për doktrinën dhe urrejtjes për pushtetin, për atë pushtet që u ngrit mbi dhe sipas vetë doktrinës. Pas shkollimit në vendlindje, mandej në Durrës, Shkodër e Tiranë, ishte qyteti verior vendi ku ai për herë të parë kishte mësuar për një lëvizje komuniste në qytet, por pa rënë në kontakt me të. Me ideologjinë komuniste u njoh përmes librave, sa ishte në Gjimnazin e Tiranës, ndërsa kontakti i parë me komunistët ndodhi në verën e vitit 1941, kur sapo kishte mbaruar vitin e fundit të gjimnazit. Ai u ftua në njërën nga celulat komuniste të qytetit dhe pas dy a tri mbledhjesh, në nëntor të atij viti, u pranua në Partinë Komuniste të sapoformuar. Që prej kësaj kohe mori pjesë në demonstrata kundër pushtimit dhe ilegalisht u mor me propagandë komuniste. Dy vite më vonë, është pjesë e njësitit partizan të Krujës, mandej komisar i batalionit ku Beqir Balluku ishte komandant.

Udhëtimi i tij komunist qe shtënë në hulli serioze. E gjejmë komisar brigade më 1944 dhe të punësuar në Komitetin Qendror të Partisë Komuniste Shqiptare/Partisë së Punës së Shqipërisë, më 1945 deri më 1951, mandej mbërriti të bëhet edhe deputet deri më 1954. Udhë e tij dukej premtuese për një karrierë si të singjashmit e vet që po konsolidonin pushtetin shtypës. Por kthesa e tij nuk vonoi të shfaqet. Dhe ishte viti 1956. Shqipëria ishte krisur me jugosllavët, ndërsa blloku komunist kishte nisur përçarjen dhe rrëzimin e idhujve me Stalinin. Protesta e Poznanit të qershorit e mandej tetori polak u zhvillua njëherit me revolucionin hungarez, në të dyja shtetet kundër qeverive komuniste. Shumë komunistë deri atëherë idealistë, i panë idealet e tyre të shtypeshin nga tanket sovjetike në sheshet e Budapestit. Dhe kërkuan komunizëm më të mirë. Mes tyre, edhe Xhavid Qesja. Atë kohë ai ishte në Moskë, në Shkollën e Lartë të Partisë. Dilemat e Tiranës për kursin e ri sovjetik shoqërohen me shqetësimin e udhëheqjes për çfarë mendonin studentët shqiptarë rreth zhvillimeve në Bllokun Lindor. 10 vjet më vonë, në një prej letrave që i drejtonte Byrosë Politike, Qesja shkruante se atyre ngjarjeve “do t’u jem mirënjohës përjetë, sepse më zgjuan nga letargjia e naivitetit dhe më banë të mendoj si komunist seriozisht dhe në mënyrë kritike. Këto ngjarje kanë bërë që shumëkush të nxjerrë konkluzione. Edhe unë kam nxjerrë dhe si pasojë u shkëputa prej jush. E për këtë e ndjej veten të qetë dhe të lumtur.”

Shkëputja e Xhavid Qeses nga udhëheqja e partisë së tij, nuk ishte as e bujshme, as e papritur. Ajo që mbetet e paqartë është se kur ka ndodhur ky “zgjim”, njëkohshëm me ngjarjet a pas tyre dhe po ashtu mbetet me pikëpyetje nëse shkëputja nga Partia, për Qesen është produkt i zhvillimeve politike brenda “kampit”, apo pasojë e ndëshkimit. Për studiuesen Ana Lalaj, irritimi i Partisë me Qesjen nis në bisedat e tij të lira me bashkëstudentët lidhur me zhvillimet brenda kampit. Komentet e tij janë mbajtur shënim, derisa të gjitha bashkë janë zbratur në organizatën e Partisë në Moskë më 1957, në dy mbledhje ku Qesja ka qenë i kryqëzuar. Sul Baholli, anëtar i Komitetit Qendror të PPSH ka sinjalizuar për mendimet e Qeses, ndaj këtij të fundit iu kërkua llogari për shumëçka, duke nisur nga pohimi se “partitë bolshevike nuk kanë liri mendimi, siç nuk kishin në kohën e Stalinit.” Pati prej studentëve që e mbrojtën dhe të tjerë që heshtën, duke mos iu bashkuar korit të kritikëve. Ndarja më dysh e organizatës në Moskë, pos lëkundjes së Qeses që ishte një prej funksionarëve të Partisë, për udhëheqjen e PPSH ishte alarmuese. Qesja u thirr nga Moska në Tiranë për shpjegime. Dy sekretarë të Komitetit Qendror e bënë me dije për lëkundjet ideologjike që ai kishte shfaqur dhe i kërkuan arsyet e lëkundjeve. E njëjta gjë iu kërkua edhe më 23 mars, kur u thirr në Sekretariatit e Komitetit Qendror. Hysni Kapo, i cili e drejtonte atë mbledhje, i tha me dinakëri Qeses se situatat e 1956-s, kishin qenë delikate, si marrëdhëniet me Jugosllavinë, edhe ngjarjet në Poloni e Hungari. Meqë për të tria këto ai kishte shfaqur lëkundje, iu ofrua “ndihmë”, me kushtin “që të të ndihmojmë, duhet të gjejmë tek ti arsyet e lëkundjes.” Qesja nuk pranoi asgjë nga kritikantët. Atij



Xhavid Qesja u lind në Krujë më 25 maj 1922, në një familje të pasur. Mësimet e para i mori në Krujë dhe më pas kreu shkollën tregtare në Durrës. Gjymnazin e filloi një vit në Shkodër dhe e përfundoi në Tiranë. (foto nga arkivi i familjes)

iu la një javë kohë të reflektonte dhe t'i shkruante Partisë. Pas tri ditësh ai ktheu një përgjigje telegrafike se nuk kishte asgjë tjetër për të thënë. Si kundërpërgjigje, Qesja u ndërpreu studimet. Enver Hoxha i dërgoi letër organizatës së Partisë të studentëve shqiptarë në Moskë, me të cilën konfirmoi se qëndrimet e Qesja kishin qenë në kundërshtim me vijën e Partisë, dhe u tërhoqi vëmendjen të tjerëve, të cilët me fjalën ose me heshtjen e tyre i dolën në krah. Hoxha i këshilloi organizatës jetë të rregullt partie, frymë kritike dhe autokritike, si dhe vigjilencë në mbrojtje të vijës së Partisë.

Me damkën mbi shpinë, si fillim e emëruan në Komitetin Ekzekutiv në Elbasan. Megjithatë anëtar partie dhe deputet në Kuvendin Popullor ndaj tij kishte nisur përndjekja nga Sigurimi i Shtetit për "veprimtari armiqësor." Raportohej për çdo gjë, nga bisedat që bënte, te radiot që dëgjonte. Aty zë fill dosja 30-vjeçare nr.1820 prej qindra faqesh. Ai e kishte kuptuar se vëzhgohej ngado që shkonte, gjë që ia kishte pohuar agjentit "*Parashtruesi*". Kur ai e pyeti Qesen nëse e kishte takuar Hysni Kapon, Qesja mohoi e mandej kur e pyeti se çfarë do t'i thoshte, Qesja u shpreh se do ta falënderonte që e kishte vënë në survejimin e Shim Kollit. Fundi i mbramë duket qartë kur hiqet nga puna në Komitet dhe dërgohet në komunale. Në këtë të tatëpjetë të furishme drejt së ardhmes në ngujim, i vetmi shqetësim i tij ishte të shpëtonte familjen, por duke ruajtur dinjitetin. Të njëjtën gjë ua këshillonte edhe miqve përreth, madje dhe atyre që e spiunonin. "*Ti e sheh se tek ne fshihet e vërteta,*" i thoshte atij që e përndiqte. "*... edhe ty ka plot gjëra që nuk të duken të drejta, por ti nuk flet ... Nuk flet se ke frikë, e pëson si Tuk Jakova e Bedri Spahiu. Njeriu duhet të flasë, të jetë principial, të ketë guxim.*"

Më 1 korrik 1958, Xhavid Qesja u dërgua në ishullin e Zvërnecit. Sapo mbërriti, i dërgoi telegram familjes: "*Jam në rrethin e Vlorës.*" Vetëm 4 fjalë, asgjë tjetër. Sipas raportimeve në dosje, të internuarit që e kanë parë tekstin e kanë komentuar si telegram të koduar. Duke mos vënë adresën, ai "*ka dhënë të kuptojë se e shoqja nuk duhej të interesohet për të, por të shikonte fëmijët dhe veten.*" Tridhjetë vjet, Meriban Najdeni preu çdo lidhje me



Viti 1955, Xhavid Qesja, Meribani, e shoqja dhe dy fëmijët, Shpëtimi e Mira, para arrestimit të Xhavidit

të shoqin dhe fëmijët “harruan” se kishin baba. Kur ata mbërritën moshën madhore, lanë llagapin e babait e morën atë të nënës, Najdeni. Lalaj arrin në përfundimin se mbase për të shpëtuar familjen nga persekucioni, vetë Qesja e ka pranuar, a ndoshta e ka kërkuar, këtë ndarje ekstreme. Kur e hodhën në Zvërnec, Xhavid Qesja sa i kishte mbushur 36 vjet. Që prej asaj dite, do të bëheshin edhe 36 vite të tjerë. Në atë ishull, tek ai manastir, thotë studiuesja Lalaj, Qesja do të varroste gjysmën e vetvetes, për të jetuar terrin e gjysmës tjetër.

Të gjitha të dhënat për Xhavid Qesen nxjerrin në pah dy cilësi, që vështirë t'i ndash dhe po aq vështirë t'i kuptosh pa njëra-tjetrën. Njëra është veçori karakteri, veçori morale, tjetra është veçori formimi intelektual. Me të parën kuptojmë rezistencën përkundër depersonalizimit, çka për të ka qenë një luftë e gjatë dhe sfidë e ashpër me pushtetin. Siç raportojnë agjentët, ai “qëndron gjakftohtë dhe i matur”, “nuk flet, rri e më tepër dëgjon.” Veçanërisht njëri prej tyre përshkruan gjithë ”protokollin” e tij të mbijetesës në ishullin e Zvërnecit: “Një ditë Xhavid po hapte sytë për një fije tel. E për çfarë të duhet?- i tha njëri nga shokët. Për të qepur buzët, ia ktheu.”

Cilësia e dytë është ajo e formimit politik, kulturor e përgjithësisht intelektual. Lexoi dhe mbushi me nënvizime 37 vëllime të veprave të plota të Marksit e Engelsit. Aq sa nënvizimet i hapën telashe, pasi tërhoqën vëmendjen e kontrollorëve dhe të ekspertëve për të gjetur në to mesazhe të koduara, që gjoja Qesja dërgonte nga vendi i vuajtjes së dënimit (!). Po me të njëjtin pasion ai ndiqte edhe letërsinë artistike, sidomos klasikët më të përmendur në letërsi. Por Zvërneci nuk ishte qendër studimore, as bibliotekë shkencore. Ai ishte vend izolimi për armiqtë e Partisë dhe në psikologjinë e drejtuesve të kohës, armiqtë nuk duhen lënë të fjetur. Ata duhen mbajtur të provokuar. Qesja u provokua në pikat

OFFEN Agjenti "Soni"
 NOVI P. Op. ESAT LATA
 Burrel, më 10/4/1973
 Nr. 172

X A P O R I D E T I C 4 / 1 9 7 3 .

... Ai reagon në Xhavit Qesja thotë
 në mënyrë të qartë, se do të bëjë që të rritet re-
 akti e intelektualit dhe do të shprehë detyrë
 të reagojë në mënyrë aktive ndaj diktaturës

" D E T J "

Vlerësim i të dhënave
 - E dhëna të vlerësuesit ky i dënuar i çmimi
 në mënyrë të qartë do të shprehë detyrë
 ndër dikurshme të proletarietit.

Shprehja e gjendjes ju dhe si detyrë të
 reakti reagojë që të marrë Partia dhe e rritet
 klasat e larta.

MASAT OPERATIVE
 Më mirë shpreh në rritje të vlerësuesit
 të njëjtit për Xhavit Qesja.

PUNEN / E

SHENIM:
 E dhëna e kësaj rëndësishme
 dhe përgjegjësi të detyrës se ma-
 terialeve të O.G.
 E rritjes së detyrës në rritje
 kryesore për 200 leke shprehim.
 E rritjes së reaktit reagojë që të
 bëjë Xhavit dhe Benit.

11/4/1973. Shënim i Seksionalit
 / R. Hoxha /

U P A nga Sr. Kuvendi
 / L. Masha /
 11/4/1973.

Khavit Qesja parashikon reagimin e rinisë kundër diktaturës, 1973

Kare nga Puntori Operative
 Kapiten (Avni Memeti)

Dhane nga M.F.
 Khavit Qesja
 Binasan më 19/6/1973 --

43. 44
 42

R E S P O R T

Burimi njofton se gjatë këtyre ditëve mbi Xhavit Qesen kam konstatuar këto gjera: Në Xhavit Qesja shoh që të vete dia persona që neve nuk i njohim dhe as kemi mundur të shpallim deri tani. Kam keni pyetur në mënyrë indirekte thuhet se ka qenë i kumati. Në fillim i viteve një goce që pa të vete në zyretë disa here, gjoja se ajo vinte nga shkollat dhe i binte lajmet prej shoqeve që ky ishte në shkollat. Deri tani nuk kam mundur të gjeja gjeneralitetet e sajë. Këtu nga Binasan shoh që të vij shumë Shënim i planit Kom. Ekze. Rrethi Angji Fabri, Hyrdalja me detyrë të mbylljes në zyrë të vet ban me Selman Beden, Myrvyer Zaisin; Tamas Keshan, Xher Daklin dhe Dhimiter Haxhinikolion, me gjithë se me ditë nga këtu të fundit ka dhe lidhje je punë mbase janë përgjegjës sektorsh dhe ai vete i ka në patro mashe, është që mehet detyrë të shpërthimit shumë dhe i bane rrugë këtu me duket se të mbase agrullat se të, por kushedi se qifre mendon ai. Eripet për të nxjerrë punë vete për të shpërthimit dhe durës. Nuk shihet shumë rrugëve ditë, i pelqen të shpërthimit në mëngjes dhe natën qëndron shumë këtu në zyrë për të lexuar gjoja, por si mbase men ditë time ky hap radjen që ka në zyrë dhe shikon stacione të jashtëme--

X h a t e R e M e d i a

D E T J R A :

SHENIM : Detyra nuk ju dhane--

Puntori Operative
 Kapiten (Avni Memeti)

Khavit Qesja, raport që informon se lexon dhe dëgjon radio

e tij të dobëta. Pika e parë e dobët ishte nëna, nanë Bija, e vetmja që e mbështeti gjatë luftës, e vetmja që do ta ndiqte pas në vitet e internimit e të burgut. Por nanë Bijen e penguan sistematikisht të shihte të birin. E po ashtu, i biri protestoi ku mundi. Pika tjetër ekstremisht e ndjeshme për Xhavidin ishin librat. Aq e ndjeshme, sa për shkak të pengesave që i sollën me librat, ai hyri dy herë në grevë urie. Në këto pika “të dobëta” Xhavidin u provokua rregullisht. Por strategjia e provokimit që ai të thyhej nuk funksionoi. Ajo që ndodhi ishte reagimi i tij ndaj teknikave të provokimit. Ai reagoi, si rrallëkush, fort dhe pandërprerë. Ai shpërtheu kundër autoriteteve, duke denoncuar shkeljen e të drejtave. “Kini parasysh se për mua, librat e mi janë të lidhura me vetë jetën time”, shkruante në njërin nga letrat, duke paralajmëruar një grevë tjetër urie. I revoltuar kërkonte që në përfundim të dënimit të ikte nga vendi, sepse “unë Atdheun tim si qorr, si memec e si shurdh nuk e due.” Pas këtyre episodeve u gjet *casus*-i për ta marrë Qesen të pandehur, me akuzën për veprimtari armiqësore.

Në shtator 1967, Qesja u vu nën arrest. I vunë përpara një tufë letrash që ia dërgonte Byrosë Politike. Ai refuzoi komunikimet me hetues e gjyqtarë, duke njoftuar Byronë Politike: “Unë si komunist kam të baj vetëm e vetëm me ju, se çështjet e mija janë vetëm çështje partie. Asht ma se e vërtetë se unë kam pikëpamje që në një seri çështjesh bijnë në kundërshtim me atë vijë që ndiqni ju sot ... Nga mendimet e mija ... nuk tërhiqem.” Më 23 tetor 1967 u dënua me dhjetë vjet heqje lirie. Pas disa muajve në Tiranë, më të shumtën e kohës në spital, Qesja u dërgua në Burrel. U mbajt nën vëzhgim me qëllim që ta gjykonin përsëri. Ai i ndiente provokimet dhe i dinte arsyet. Iu kërkoi autoriteteve të mbyllej i vetëm në qeli, çka bëri që ta marrin në pyetje. Më 7 prill 1970, Qesja i shkroi të vetmit njeri përgjegjës, Enver Hoxhës: “Po të pyes ty, se s’kam cilin të pyes tjetër. Kush asht ai që hala nuk asht ngjijë me Xhavid Qesen ...” Nuk mori përgjigje, ndaj i dërgoi letrën tjetër, më 7 maj: “Ti nuk ke fare të drejtë që e ban veshin e shurdhët. Këtu nuk asht fjala për

“

Unë si komunist kam të baj vetëm e vetëm me ju, se çështjet e mija janë vetëm çështje partie. Asht ma se e vërtetë se unë kam pikëpamje që në një seri çështjesh bijnë në kundërshtim me atë vijë që ndiqni ju sot ... Nga mendimet e mija ... nuk tërhiqem

Xhavid Qesja

”



Ora e Xhavid Qeses, dhuratë e një ushtari britanik për të. Ruhet nga i biri, Shpëtim Qesja

Xhavid Qesen si person privat ... asht fjala për Xhavid Qesen si qytetar i RPSH, asht fjala direkt për Kushtetutën e RPSH. Pra, tue ba veshin e shurdhët, nuk e ban kundrejt meje si person privat, por direkt kundër qytetarit, kundrejt Kushtetutës.” Përgjigja që mori qe e tjetërsojtë. Në mesqershor u mor në hetim dhe 7 ditë, më pas iu shtuan edhe 10 vite burg. I bëri të gjitha! 30 vjet e disa muaj mbyllur brenda muresh, ndarë nga të gjithë, i provokuar gjithnjë. Armik sepse mendoi ndryshe. Mund të kishte zgjedhur jetë tjetër, fundja të kishte kërkuar falje, siç e thotë ai vetë, *“duke u tërheqë zvarrë si kërmilli rreth karrigeve tuaja.”* Nuk e bëri, se e kish pranuar që mendimet e tija ishin jeta e tij dhe se do të ishte fundi i tij mroal. *“Shileri na mësonte”,* thoshte Qesja se *“asht ma mirë të hiqesh zvarrë në pluhun, se të hiqesh zvarrë rreth fronit.”*

Provokimet që iu bënë Xhavid Qeses, sidomos kur ishte i internuar në ishull, por dhe më tej, në 21 vite burgim, mund të konsiderohen si pjesë e një “protokolli” standard që ndërtohej mbi bazën e të dhënave për “rezikshmërinë” e personit, duke zgjedhur pikat e “dobëta” të tij. E veçanta është se kundërpërgjigja e Qeses është aq e pasur në episode, sa përbën një manual të vërtetë qëndrese. Ajo është e mirëmenduar në përmbajtje dhe interesante si taktikë. Ai iu mbajti gjithnjë arsyetimit se me partinë e tij, që prej vitit 1956 e në vijim kishte mospajtime mendimesh. Duke qenë çështje mendimesh, kjo sipas tij, ishte edhe çështje ku askush tjetër, organ ose individ qoftë, nuk mund të hynte midis tij dhe Partisë. Prandaj ai, të gjitha letrat, ankesat, protestat ia drejtoi Byrosë Politike. Dhe kur pikërisht mbi këto letra dhe mbi asgjë tjetër u ngritën edhe akuzat kundër tij, në asnjë rast nuk pranoi t’i jepte shpjegime, asnjë hetuesi, prokurori apo gjyqtari. Prandaj ai i ka quajtur të pambështetura në ligj të gjitha vendimet penale kundër tij, dy vendime me internim me nga pesë vjet dhe tre vendime me burgim me nga dhjetë vjet secili. Këto vendime i denoncoi politikisht, por jo me rrugë gjyqësore, pasi ai nuk e njohu të drejtën e gjykatës për t’u marrë me debate të brendshme të Partisë dhe që i përkisnin vetëm asaj. Kjo duhet të jetë arsyeja që ai nuk kërkoi asnjëherë rishikim të vendimeve gjyqësore ose zbutje të masave penale. Kur Qesja u arrestua në Zvërnec, grupi hetimor shënoi se kishte marrë në dorëzim edhe 74 fletore me shënime nga librat. Në tetë vjet e gjysmë kishte studiuar veprat e plota të Marksit dhe të Engelsit. *“I kam studiue njiherit, - thotë ai, - tue pa me sy kritik gjithë zhvillimin e ngjarjeve që kam jetue.”* I ka studiuar duke u rrekur të gjente veten, të krahasonte sistemin që Marksi e ndërtoi në libra, me atë që marksistët thoshin se po e ndërtonin në jetë. Duket se për Qesen e gjithë kjo ka qenë një hulumentim i mundimshëm, çka e thotë hapur: *“Gjatë studimit, ndërgjegjja ime ka qenë nën presion të vazhdueshëm. Dhe çfarë presioni!. Kur mbarova të 39 volumet, thashë me vete: oh, sa i qetë jam, sa mirë kam veprue, që u shkëputa prej jush!”* Letrat e disa regjistrime bisedash ndihmojnë për të krijuar një mendim rreth bindjeve të tij për komunizmin si teori, dhe njëherësh për abuzimet, sipas tij, me doktrinën.

Për studiuesen Ana Lalaj, deri në fund Qesja nuk e humbi besimin në komunizëm. Për komunistët në pushtet, Qesja ishte “antikomunist i tërbuar”, ndërsa ai vetë përsëriste pa u lodhur se ishte “komunist i bindur.” Të parët, me antikomunizmin e Qeses nënkuptonin të qenët “antiparti”, ndërsa ai vetë nënkuptonte jo raportet me partinë, por me doktrinën. Ky moment shënoi edhe ndarjen me partinë e tij, duke u rreshtuar ndër disidentët e parë dhe të pakët.

★ ★ ★

Më 20 janar 1987 pak muaj pa bërë 30 vjet dënim, Xhavid Qesja la burgun e Burrelit dhe mbërriti në Shijak i internuar. I kishin caktuar një dhomë për banim, ndërsa Sigurimi kishte bërë gati teknikën e përgjimit. Një njësit vëzhgimi ishte vënë në kryqëzim të rrugës dhe ndiqte objektin me emrin e koduar “Gorilla”, midis orës 7 të mëngjesit e 21 të darkës. Raportet thonë se e vizitonin njerëz të afërm, me të cilët ai nuk ishte parë prej tridhjetë vjetësh. Në shtator ai i dërgoi një letër tjetër udhëheqjes dhe për këtë shkak, më 9 tetor 1987, u arrestua dhe u dënua për herë të tretë me tetë vjet heqje lirie. U dërgua në Spaç, por në më pak se një vit, iu fal dënimi dhe doli i lirë në nëntor 1988, për t’u bashkuar me fëmijët e Meribanin pas tri dekadash, tashmë 66 vjeç. Protestat e studentëve e gjetën të lirë. Më 1973 kishte bërë një profeci. *“Do të rritet rezistenca në radhët e rinisë ... kjo do të shpejtojë ditën kur rinia do të reagojë në mënyrë aktive kundër diktaturës së proletariatit”* thuhet në njërin nga raportet. Për studiuesen Ana Lalaj, Xhavid Qesja mbetet një personazh krejt i veçantë në historinë e persekucionit komunist shqiptar. I tharë i pashoq i doktrinës së Marksit e njëherësh, antikomunist i pakompromis.

Shqiptarët duket se i përçafuan herët, shumë prej parimeve të së majtës, qoftë marksiste, qoftë asaj socialdemokrate. Studimet e këtij botimi tregojnë se historia e së majtës shqiptare shkoi më herët në histori dhe pa dyshim, e tejkalon të majtën komuniste, ndonëse në 47 vitet e jetuara nën një regjim totalitar të tipit stalinist, u injektua ideja se e majta nisi me themelimin e PKSH-së.

E majta në Shqipëri, ashtu si në botë, ka qenë pluraliste dhe jo monolite. Qysh herët u shquan të paktën pesë kategori të së majtës. E majta romantike: individë me ideologji të majtë që ushtruan veprimtarinë e tyre deri në fillim të Luftës së Parë Botërore. E majta utopike (komuniste): me përfaqësues që qenë pjesë e Luftës Nacionalçlirimtare, por nuk jetuan ta shihnin të instaluar diktaturën e proletariatit. E majta trockiste: ithtarët e së cilës u etiketuan të tillë për t'u goditur si kundërshtarë politikë. E majta socialiste: me distancë të shëndoshë ideologjike nga leninizmi, si mbivendosje e marksizmit tradicional. E majta socialdemokrate: që përfaqësohej nga ideologë të spikatur me ide, si drejtësia sociale, rishpërndarja e të ardhurave, luftimi i pabarazive shoqërore, liberalizmi politik, etj. E majta nacionaliste: me Tajar Zavalanin, Kostë Çekrezin, Fan Nolin, Skënder Luarasin, etj., që bashkonin idetë e një programi ekonomik të majtë me idetë kombëtariste të një Shqipërie të bashkuar me Kosovën dhe viset e tjera amtare.

Pas instalimit të sistemit, ngjyrat u shuan. Cila ishte e majta jostaliniste në kushtet e një regjimi totalitar? Është e vështirë të flasësh për mendimin politik të së majtës në totalitarizëm që, në kuadër të procesit të unifikimit ideologjik, luftoi pa mëshirë çdo individ apo grupim që guxonte të shfaqte tendenca jostaliniste. Emra të njohur të së majtës, që u ndërgjegjësuam për atë që kishin brohoritur për të sjellë në vend, u heshtën përgjithnjë...